

PREVALENCA DHE ARSYET E BULIZMIT NË SHKOLLAT 9 - VJEÇARE NË BASHKINË E ELBASANIT

Fitnet HASEKIU

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve tëprogramit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Psikologji, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Edmond DRAGOTI

Numri i fjalëve: 50,688

Tiranë, 24, GUSHT , 2018

© DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjësinë time deklaroj se ky punim, me titull “Prevalenca dhe arsyet e bulizmit në shkollat 9 – vjeçare në Bashkinë Elbasan”, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve kur është atribuar autorësia nëpërmjet referencave të cituara.

Tiranë, 24, GUSHT, 2018

Fitnet HASEKIU

ABSTRAKTI

Bulizmi është kthyer në një fenomen mjaft shqetësues në të gjitha shkollat kudo në botë. Nga studimet e kryera në vende të ndryshme të botës rezulton se pasojat psikosociale, të cilat janë si afatshkurtra dhe afatgjata, kanë ndikim negativ jo vetëm mbi të gjithë individët e përfshirë në bulizëm, por dhe në mbarë shoqërinë. Duke qenë një fenomen kaq shqetësues ndërkombëtar, për parandalimin dhe trajtimin e tij janë hartuar dhe zbatuar programe të ndryshme parandalues, ku ndër më të sukseshmit mund të përmendet programi i parandalimit të bulizmit i Olweus –it.

Ky studim synon të analizojë përhapjen, format si dhe vendet ku kryhen më së shumti aktet buliste në shkollat 9 – vjeçare të bashkisë së Elbasanit. Studimi synon të analizojë nëse ekziston një marrëdhënie midis numrit të miqve që mund të ketë një nxënës dhe mundësisë për të rënë pre e akteve buliste, si dhe nëse ekziston një marrëdhënie midis të qenit viktimë e akteve buliste dhe kënaqësisë që ndjen një viktimë e bulizmit në shkollë. Gjithashtu në fokus të këtij studimi është dhe evidentimi i informacionit që zotërojnë, i qëndrimeve dhe i reagimeve që shfaqin bashkënxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi fenomenin e bulizmit si dhe evidentimi i nevojës për ofrimin e trajnimeve të ndryshme rreth fenomenit të bulizmit.

Nga analiza sasiore e të dhënave të siguruara nga anketimi i kryer mbi 727 nxënës të shkollave 9 – vjeçare u konstatua se 15.2 % e nxënësve të anketuar janë autorë të akteve buliste dhe 9.9 % janë viktima të tyre. Në krahasim me vajzat, rezulton se djemtë përshihen më shumë në akte buliste, si në rolin e viktimës (6.6 %), ashtu dhe në rolin e autorit të bulizmit (10 %). Gjatë ushtrimit të bulizmit, nxënësit ushtrojnë njëkohësisht forma të ndryshme të bulizmit, por si format më të përhapura të tij rezulton ai kibernetik dhe fizik. Gjithashtu u dol në përfundimin se sa më shumë miq të ketë një nxënës, aq më e ulët është mundësia që ai të bie pre e akteve buliste dhe anasjelltas dhe që sa më shumë që një nxënës të bie pre e akteve buliste, aq më pak kënaqësi ndjen ai në shkollë.

Analiza cilësore e të dhënave të siguruara nga grupi i fokusit tregon se ndër aktorët kyç të cilët mund të trajtojnë dhe parandalojnë bulizmin, ka mungesë të

informacioneve të detajuara rreth fenomenit të bulizmit, gjë që pengon dhe parandalimin dhe trajtimin e tij.

Fjalë kyçe: *bulizëm, autorë, viktima, pasoja psikosociale, program parandalues.*

ABSTRACT

Bullying is a phenomenon that has become a significantly disturbing issue in all schools throughout the world. Relevant studies in various areas of the world show that long-term and short-term psychosocial effects have negative impacts not only on all the individuals involved, but even within society. Considering that it is an international phenomenon of such significant concern, a variety of prevention and treatment programs have been developed and implemented, with the Olweus bullying prevention program being among the most successful.

This study aims to analyze the distribution, forms, and areas with greatest bullying prevalence within elementary schools of the municipality of Elbasan. The study aims to analyse if it exists a relationship between the number of friends that a student can have and the possibility to be a victim of bullying. In addition, this study focuses on evidence from information we possess, the views and reactions of classmates, parents and teachers on bullying, and evidence that various types of training on the phenomenon of bullying are required.

Quantitative analysis of data provided through surveys of 727 elementary school students found that 15.2% of students surveyed are perpetrators of bullying, while 9.9% are their victims. In comparison to girls, results indicate that boys are more involved in acts of bullying, both as victims (6.6%) and as perpetrators (10%). Throughout the course of bullying, students simultaneously exercise various different forms of bullying. Results indicate that the most common forms are cyber bullying and physical bullying. It came also to the conclusion that the more friends a student has, the lower is the possibility that he is going to be a victim of bullying (and vice versa).

Qualitative analysis of data provided through focus group shows that among those key actors who are able to treat and prevent bullying, there is a lack of detailed information surrounding the phenomenon, impeding on their ability to treat and prevent it.

Keywords: *bullying, perpetrator, victims, psychosocial effects, preventative programs*

DEDIKIMI

*Ky punim i dedikohet **familjes time**, veçanërisht **nënës** e cila më ka nxitur dhe mbështetur në çdo hap të jetës.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI 1: HYRJE	1
1.1. Konteksti i studimit	1
1.2. Nevoja për këtë studim	4
1.3. Korniza teorike	6
1.3.1. Arsytet përse nxënësit përfshihen në akte buliste	7
1.3.2. Format e bulizmit	8
1.3.3. Ndarja e roleve në bulizëm	9
1.3.4. Pasojat e bulizmit	9
1.3.5. Programi i parandalimit të bulizmit i Olweus	10
1.4. Qëllimi i studimit	11
1.5. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	12
1.6. Epërsitë dhe kufizimet	13
1.7. Përkufizimi i termave	14
1.8. Struktura e punimit	15
KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS	17
2.1. Përkufizimi i bulizmit	17
2.2. Fakte rreth bulizmit	18
2.2.1 Fakte rreth bulizmit në Gjermani/Mynih	23
2.3. Bulizmi si formë e veçantë e sjelljes agresive	25
2.3.1. Sjellja agresive	25
2.3.2. Lindja e sjelljeve agresive	27
2.3.3. Kufizimet nga sjelljet e tjera të dhunës	31
2.4. Kuadri ligjor në lidhje me të drejtat e fëmijëve	32
2.4.1. Akte ndërkombëtare	32
2.4.2. Legjislacioni i brendshëm	35
2.4.3. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ..	36
2.5. Ndarja e roleve në bulizëm	42

2.5.1. Autorë	42
2.5.2. Viktima	44
2.5.3. Autorë – viktima	45
2.6. Format e shfaqjes së bulizmit	46
2.6.1. Format e drejtpërdrejta të bulizmit	47
2.6.2. Format jo të drejtpërdrejta të bulizmit	48
2.6.3. Format e bulizmit bazuar në pyetësin e bulizmit të Olweus –it	48
2.7. Karakteristikat e episodeve të bulizmit	52
2.8. Dallimet gjinore në bulizëm në moshën shkollore	55
2.9. Ndryshimet moshore në bulizëm në moshën shkollore	58
2.10. Faktorët riskues dhe faktorët mbrojtës të bulizmit	61
2.10.1. Faktorët riskues të bulizmit	62
2.10.2 Faktorët mbrojtës të bulizmit	67
2.11. Pasojat e bulizmit	69
2.11.1. Pasojat afatshkurtra	70
2.11.2. Pasojat afatgjata	71
2.12. Impakti i bulizmit mbi shëndetin mendor	72
2.13. Bulizmi dhe vetëbesimi	79
2.14. Shenjat paralajmëruese të përfshirjes në akte buliste	74
2.14.1. Shenja se fëmija pëson akte buliste	82
2.14.2. Shenja se fëmija kryen akte buliste	84
2.15. Programet e parandalimit të bulizmit	81
2.15.1. Programi i parandalimit të bulizmit i Olweus – it	82
2.15.2. Strategji për zhvillimin e programit parandalues të bulizmit	84
2.16. Masat parandaluese dhe trajtimi i rasteve të bulizmit	95
2.16.1. Masat parandaluese të ndërmarra në Bashkinë e Elbasan –it	95
2.16.2. Masat parandaluese të ndërmarra në disa shtete të Europës	96
KAPITULLI III: METODOLOGJIA	100
3.1. Metoda dhe plani i studimit	100
3.2 Popullata e kërkimit shkencor	102

3.3. Kampionimi	105
3.4. Instrumenti matës: Pyetësi antibulizëm dhe karakteristikat e tij	106
3.4.1. Informacione të përgjithshme	106
3.4.2 Dobitë e përdorimit të PABO – it	107
3.4.3. Cilësitë psikometrike të PABO – it	107
3.5. Fokus - grupi	108
3.5.1. Përbërja e fokus - grupit	109
3.5.2. Proçedura e ndjekur në zhvillimin dhe analizën e grupit të fokusit.	111
3.5.3. Pyetjet kërkimore kryesore të shtruara në fokus - grup	113
3.6. Intervistat individuale	113
3.6.1. Proçedura e ndjekur në zhvillimin dhe analizën e intervistave individuale	113
3.6.2 Pyetjet kërkimore kryesore të shtruara në intervistat individuale	115
3.6.3 Testimi i hipotezave	115
KAPITULLI IV: ANALIZA E TË DHËNAVE	117
4.1 Përshkrimi i kampionimit.....	117
4.2 Analiza statistikore e të dhënave sasiore	118
4.2.1. Përfshirja në bulizëm	118
4.2.1.1 Përfshirja në bulizëm në rolin e viktimës duke marrë në konsideratë gjininë e nxënësve të anketuar.....	118
4.2.1.2 Përfshirja në bulizëm në rolin e autorit duke marrë në konsideratë gjininë e nxënësve të anketuar	119
4.2.1.3. Përfshirja në bulizëm në rolin e viktimës duke marrë në konsideratë klasën që frekuentojnë nxënësit e anketuar.	120
4.2.1.4 Përfshirja në bulizëm në rolin e autorit duke marrë në konsideratë klasën që frekuentojnë nxënësit e anketuar	121
4.2.2 Ambjentet ku kanë ndodhur më shpesh aktet buliste, duke marrë në konsideratë dhe gjininë	121
4.2.3 Mënyrat si kryhen më së shumti aktet buliste: në grup apo në mënyrë individuale, duke marrë në konsideratë dhe gjininë	122

4.2.4	Format e bulizmit të kryera më së shumti në shkollë	123
4.2.4.1	Format e akteve buliste të kryera duke marrë në konsideratë klasën dhe gjininë	125
4.3	Hipoteza e studimit: Numrit të miqve që ka një nxënës në shkollë ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste.....	130
4.3.1	Testimi i hipotezës nëpërmjet koeficientit të Pearson –it	147
4.3.2	Testimi i hipotezës nëpërmjet tabelave të kryqëzuara	148
4.3.3	Analiza cilësore e intervistave individuale	151
KAPITULLI V: GJETJE DHE KONKLUSIONE		155
KAPITULLI IV: REKOMANDIME		160
BIBLIOGRAFIA		163
SHTOJCA I Popullata e përgjithshme e marrë në studim, në Bashkinë e Elbasanit		180
SHTOJCA II Popullata e shkollave të anketuara		181
SHTOJCA III Pyetësi i bulizmit i Olweus – it		182
SHTOJCA IV Analiza sasiore e pyetësit të bulizmit të Olweus – it		194
SHTOJCA V: Miratimi i pjesëmarrjes në grupin e fokusit		209
SHTOJCA VI: Miratimi për intervistat individuale		210
SHTOJCA VII: Miratimi për plotësimin e pyetësorëve		211

LISTA E ILUSTRIMEVE

Grafiku 1. Numri i nxënësve (vajza) që kanë kryer forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë	126
Grafiku 2. Numri i nxënësve (djem) që kanë rënë pre e akteve buliste sipas klasave	127
Grafiku 3 Numri i nxënësve (vajza) që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë.....	129
Grafiku 4. Numri i nxënësve (djem) që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë.....	129
Grafiku 5. Raportimi i akteve buliste	139
Grafiku 6. Personave të cilëve u tregojnë viktimat e bulizmit	140
Grafiku 7. Personave të cilëve u tregojnë viktimat e bulizmit rreth tij, duke marrë në konsideratë dhe gjininë	141
Grafiku 8. Përpjekjet e mësuesve ose anëtarëve të tjerë të stafit psiko - pedagogjik për të ndaluar vazhdimin e bulizmit mbi viktimat	142
Grafiku 9. Mendimet e nxënësve rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë	143
Grafiku 10. Mendimet e nxënësve autorë të bulizmit rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë	144
Grafiku 11. Mendimet e nxënësve viktimat të bulizmit rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë	145
Grafiku 12. Shpeshhtësia e kontakteve të prindërve me shkollën për t'i kërkuar marrjen e masave kundër bulizmit të pësuar nga fëmijët e tyre	146
Grafiku 13. Numri i nxënësve dhe shpeshhtësia e bashkëbisedimeve të autorëve të bulizmit me të cilët familjarët kanë folur rreth akteve buliste të kryera prej tyre	138
Grafiku 14. Numri i nxënësve dhe shpeshhtësia e bashkëbisedimeve të autorë të bulizmit me të cilët mësuesit kanë folur rreth akteve buliste të kryera prej tyre.....	140
Grafiku 15. Numri i shokëve të ngushtë që kanë nxënësit në shkollë, duke marrë në konsideratë gjininë	149

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri dhe përqindja e djemve të përfshirë në bulizëm në shtete të ndryshme.....	22
Tabela 2. Numri dhe përqindja e vajzave të përfshira në bulizëm në shtete të ndryshme.....	23
Tabela 3. Dikotimia e sjelljes agresive (Vitiello dhe Stoff, 1997)	26
Tabela 4. Popullata e përgjithshme e marrë në studim.....	104
Tabela 5. Popullata e shkollave të anketuara	104
Tabela 6. Shpërndarja e kampionit bazuar në gjininë e nxënësve të anketuar	117
Tabela 7. Shpërndarja e kampionit bazuar në klasat që ndjekin nxënësit e anketuar	117
Tabela 8. Shpërndarja e kampionit bazuar në origjinën e nxënësve të anketuar	118
Tabela 9. Numri i nxënësve, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste	119
Tabela 10. Numri i nxënësve, të cilët kanë kryer akte buliste	120
Tabela 11. Numri dhe përqindja e nxënësve të rënë pre e akteve buliste muajt e fundit sipas klasave	120
Tabela 12. Përqindja dhe numri i nxënësve të cilët kanë kryer në intervale të ndryshme kohore akte buliste duke marrë në konsideratë klasën që ato ndjekin	117
Tabela 13. Vendet, përqindja dhe numri i nxënësve të cilët kanë pësuar akte buliste duke marrë në konsideratë gjininë.....	122
Tabela 14. Madhësia e grupeve të nxënësve, prej të cilëve nxënësit kanë rënë pre e akteve buliste.....	123
Tabela 15. Numri dhe përqindja e nxënësve që kanë kryer forma të ndryshme bulizmi duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën.....	125
Tabela 16. Numri dhe përqindja e nxënësve që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën.....	128
Tabela 17. Shkalla e marrëdhënies statistikore midis numrit të miqve dhe mundësisë për të rënë pre e akteve buliste	148
Tabela 18. Numri i miqve të ngushtë që kanë nxënësit, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste, duke marrë në konsideratë gjininë	152

LISTA E SHKURTIMEVE

DDSHBA	Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës
LREN	Laboratori Rajonal i Edukimit të Northwest – it
PPBO	Programi parandalues i bulizmit i Olweus –it
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
KKMDF	Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
ASHMDF	Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJDF	Njesia për të Drejtat e Fëmijëve në Këshillin e Qarkut
DAR	Drejtoria Rajonale Arsimore

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Konteksti i studimit

Bulizmi është një formë e sjelljes agresive, i cili ka si qëllim të shkaktojë distres ose dëm dhe është i karakterizuar nga një çekuilibër i pushtetit ose i forcës midis autorit dhe viktimës dhe që zakonisht ndodh në mënyrë të përsëritur herë pas here. (Limber, 2002; Olweus, 1993a; Nansel dhe të tjerë, 2001). Bulizmi është një sjellje agresive e qëllimshme, dhe viktimat e ka të pamundur ose shumë të vështirë të mbrojnë veten e tij nga aktet buliste. Viktima është/ose perceptohet më i dobët në aspektin fizik apo social – psikologjik në krahasim me autorët e akteve buliste. Kur aktet buliste përsëriten, çekuilibri i pushtetit ose i forcës midis autorit dhe viktimës bëhet dhe më i fortë. Autorit të akteve buliste i rritet forca apo pushteti, ndërsa viktimat humbet forcë apo pushtet. Viktimat vazhdimisht bëhen gjithnjë e më tepër i pafuqishëm për t'u vetëmbrojtur (Olweus, 1999).

Bulizmi është një formë e viktimizimit nga bashkëmoshatarët dhe kjo e dallon atë nga format e tjera të agresionit midis fëmijëve (p.sh. konfliktet midis fëmijëve) (Espelage, Holt, dhe Henkel, 2003; Olweus, 1993a, 2001; Olweus, Limber dhe Mihalic, 1999; Pellegrini, 2002). Bulizmi mund të dallohet nga konfliktet e zakonshme midis fëmijëve për faktin se sjelljet buliste janë një kombinim i agresionit dhe i raportit të fuqisë midis autorit dhe viktimës. Bulizmi nuk është aksidental, ai është i qëllimshëm dhe i paramenduar.

Bulizmi mund të shfaqet në forma të ndryshme. Ai mund të jetë i drejtpërdrejtë, jo i drejtpërdrejtë, fizik, verbal, dhe/ose elektronik. Sjelljet buliste ndodhin më së shumti për shkak të racës, kombësisë, fesë, paaftësive të ndryshme fizike apo psikologjike, orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Kërkimet shkencore kanë treguar se bulizmi përfshin një numër të madh fëmijësh dhe të rinjsh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga të gjitha shtresat social – ekonomike, nga të gjitha grupet racore dhe nga zona të ndryshme të popullsisë (urbane, periferike dhe rurale) (Nansel dhe të tjerë, 2001).

Ekzistojnë dallime gjinore në format e bulizmit që përjetojnë djemtë dhe vajzat. Djemtë raportojnë se ato më së shumti bien pre e akteve buliste fizike (Harris, Petrie, dhe Willoughby, 2002; Nansel dhe të tjerë, 2001). Vajzat ndërkohë raportojnë se ato më së

shumti bien pre e akteve buliste verbale si p.sh.: përhapja e fjalëve negative, manipulimi social dhe komente seksuale rreth viktimave të bulizmit. (Nansel dhe të tjerë, 2001). Vajzat raportojnë se ato bien pre e akteve buliste të shkaktuara nga djemtë dhe vajzat, ndërkohë që djemtë raportojnë se ato bien pre e akteve buliste të shkaktuara kryesisht nga djemtë (Melton dhe të tjerë, 1998; Olweus, 1993).

Sjellja agresive është aktualisht arsyeja më e shpeshtë pse fëmijët dhe të rinjtë u nënshtrohen shërbimeve psikologjike dhe psikiatrike (Griffin dhe Gross, 2004).

Kërkimet kanë treguar se bulizmi shkakton funksionim negativ psiko – social si tek autorët, ashtu edhe tek viktimat e akteve buliste. Ato vuajnë nga pasoja të menjëhershme ose afatgjata psikologjike. Ato shfaqin probleme emocionale, sjellore dhe sociale, duke përfshirë këtu vetëvlerësim të ulët (Hodges & Perry, 1996; Olweus, 1993a; Rigby & Slee, 1993), shkallë të lartë të depresionit (Craig, 1998; Hodges dhe Perry, 1996; Olweus, 1993a; Salmon 2000; Slee, 1995), ankth (Craig, 1998; Hodges dhe Perry, 1996; Olweus, 1993a; Rigby dhe Slee, 1993), ndjenja të vetmisë (Kochenderfer & Ladd, 1996; Nansel dhe të tjerë, 2001), ide vetëvrasëse (Rigby, 1996), performancë të ulët në shkollë dhe përqindje të lartë të braktisjes së shkollës (Rigby, 1996).

Fëmijët dhe të rinjtë me paaftësi fizike ose çrregullime psikologjike, si dhe të rinjtë të cilët janë lezbike, gej apo transgjinnor, ose të cilët perceptohen si të tillë, mund të jenë veçanërisht në risk të madh për të rënë pre e akteve buliste nga bashkëmoshatarët e tyre (Dawkins, 1996; Hersberger dhe D’Augelli, 1995; Hunter, 1990; Nabuzka dhe Smith, 1993; Pilkington dhe D’Augelli, 1995; Rigby, 2002; Yude, Goodman, dhe McConachie, 1998; Whitney, Smith, dhe Thompson, 1994).

Fëmijët dhe të rinjtë të cilët kryejnë akte buliste kanë më shumë besime mbështetëse të dhunës sesa bashkëmoshatarët e tyre dhe kanë më shumë gjasa për të ndikuar tek bashkëmoshatarët e tyre për t’u përfshirë dhe për të kryer edhe ato akte buliste me kalimin e kohës (Bosworth, Espelage, dhe Simon, 1999). Autorët e akteve buliste dëmtojnë ato fëmijë të cilët nuk janë të aftë të vetëmbrohen apo të mbrohen nga të tjerët rreth tij. Kryerja e akteve buliste ndaj viktimave u jep autorëve ndjesinë e të qenit të fortë dhe të rëndësishëm, ndjesi të cilat ato nuk mund t’i fitojnë nëpërmjet sjelljeve prosociale. Autorët

kërkojnë dominim dhe status social, ato shpesh herë shpërblehen dhe mbështeten edhe nga fëmijët e tjerë (Espelage dhe të tjerë, 2003).

Hulumtimet tregojnë se nuk ekziston një arsye e vetme për të kryer akte buliste. Përkundrazi, faktorët individual, familjar, shoqëror, shkollorë dhe ato të komunitetit mund të ndërveprojnë dhe ndikojnë njëkohësisht që një fëmijë apo një i ri të jetë në risk për të kryer akte buliste ndaj bashkëmoshatarëve të tij ose të saj (Olweus, Limber dhe Mihalić, 1999).

Kryerja e akteve buliste është e lidhur dhe me sjellje të tjera problematike, duke përfshirë vandalizmin (Solberg & Olweus, 2003), përleshjet (Nansel dhe të tjerë, 2001; Nansel, Overpeck, Haynie, Ruan, dhe Scheidt, 2003), konsumimin e alkoolit (Nansel dhe të tjerë, 2001), konsumimin e duhanit (Nansel dhe të tjerë., 2001), mungesat pa arsye (Byrne, 1994), braktisjen e shkollës (Byrne, 1994), mbajtjen e armëve (Nansel dhe të tjerë., 2003), pronësinë e armëve me rrezik të lartë (p.sh.: pronësi e armëve, jo për arsye sportive), (Cunningham, Henggeler, Melton, dhe Nation, 2000), si dhe sjellje të tjera antisociale (Solberg dhe Olweus, 2003).

Vlerësimi i bulizmit është i komplikuar për faktin sepse si stafi psiko – pedagogjik, po ashtu edhe prindërit janë shpesh të pandërgjegjësuar rreth bulizmit dhe viktimizimit. Në të shumtën e rasteve, stafi psiko – social dhe ai pedagogjik nuk janë në dijeni të akteve buliste që ndodhin në ambjentet shkollore. Kjo mund të ndodhë për faktin se shumica e akteve buliste janë verbalë, të shkurtër në kohë dhe ndodhin kur monitorimi është i pakët dhe gjithashtu dhe për faktin se shumica e nxënësve nuk i raportojnë aktet buliste tek stafi psiko – social dhe tek ai pedagogjik. Gjithashtu dhe prindërit përgjithësisht nuk janë të ndërgjegjësuar për ekzistencën e akteve buliste në shkollat, të cilat frekuentojnë fëmijët e tyre. Kjo ndodh pasi shumica e fëmijëve nuk raportojnë apo nuk flasin me prindërit e tyre për episodet buliste dhe nga ana tjetër as prindërit nuk fillojnë biseda rreth temës së bulizmit me fëmijët e tyre. Për më tepër prindërit e autorëve të akteve buliste në mënyrë të paqëllimshme dhe jo të drejpërdrejtë mbështesin format e sjelljeve buliste, veçanërisht nëse ato japin modelin e ushtrimit të forcës dhe agresionit për të zgjidhur konfliktet apo problemet e ndryshme në ambjentet familjare apo në komunitet.

Duke marrë në konsideratë përhapjen dhe pasojat e rënda të bulizmit në shoqëri në vitet e fundit në vende të ndryshme të botës për parandalimin e bulizmit janë hartuar programe të shumta, kurrikula, dhe strategji për t'u zbatuar nëpër shkolla (Beane, 1999; Committee for Children, 2001; Froschl, Spring dhe Mullin-Rindler, 1998; Garrity, Jens, Porter, Sager dhe Short-Camilli, 1994; Newman, Horne dhe Bartalumucci, 2000; Olweus, 1993a; Stein dhe Sjostrom, 1996).

Psikologët kanë luajtur një rol vendimtar në kryerjen e studimeve për bulizmin dhe në hartimin dhe zhvillimin e ndërhyrjeve parandaluese të bulizmit. (Olweus, 1993a; Nansel dhe të tjerë, 2001; Rigby, 1996; Smith dhe Sharp, 1994).

Hulumtimet ekzistuese kanë treguar se bulizmi në shkolla mund të reduktohet në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet zbatimit të programeve gjithëpërfshirëse shkollore që janë projektuar për të ndryshuar normat e sjelljeve (Olweus, 1993a; Olweus, 1993b; Olweus, Limber dhe Mihalic, 1999; Whitney, Rivers, Smith dhe Sharp, 1994).

Zbatimi i programeve parandaluese të bulizmit janë efektive jo vetëm në rrafshin individual, por edhe në mirëqenien fizike dhe psikologjike të të gjithë komunitetit shkollor dhe më gjerë. Ato përfshijnë nxënësit, stafin psiko – social dhe atë pedagogjik, prindërit dhe mbarë komunitetin (Olweus, 1993a) .

1.2. Nevoja për këtë studim

Të dhënat e studimeve të kryera në vende të ndryshme të botës si në Suedi (Olweus 1986), Finlandë (Lagerspetz etj. 1982), Angli (Smith 1991; Whitney dhe Smith 1993), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Perry etj., 1988), Kanada (Ziegler dhe Rosenstein – Manner 1991), Hollandë (Haeselager dhe van Lieshaut 1992), Japoni (Hirano 1992), Irlandë (O'Moore dhe Brendan 1989), Spanjë (Ruiz 1992) dhe Australi (Rigby dhe Slee 1991) tregojnë se bulizmi midis nxënësve në shkolla ka qenë një fenomen i hershëm, për të cilin jo vetëm në vendet e lartpërmendura, por dhe në shumë vende të tjera të botës është rritur shumë vëmendja vitet e fundit.

Studiues nga këto vende, por edhe më gjerë, janë përfshirë aktivisht në hulumtimin e shkaqeve që ndikojnë në kryerjen e sjelljeve buliste, në evidentimin e formave më të shpeshta të akteve buliste, në zbulimin e pasojave afatshkurtra dhe afatgjata të bulizmit, si

dhe në hartimin dhe zbatimin e programeve dhe strategjive ndërhyrëse dhe parandaluese antibulizëm.

Bulizmi ndodh në të gjitha shkollat dhe ai nuk është i kufizuar prej racës, gjinisë, klasës apo dallimeve të tjera natyrore. (Sullivan, Cleary dhe Sullivan, 2004, fq. 2). Si i tillë, bulizmi nuk është një fenomen i izoluar, por një fenomen, i cili mund të jetë i pranishëm kudo në shkollë dhe jashtë saj.

Bulizmi mund të ketë pasoja negative afatshkurtra dhe afatgjata akademike, fizike dhe emocionale mbi autorët, viktimat dhe spektatorët e akteve buliste. Kryerja e akteve buliste në shkolla ka një ndikim negativ mbi mundësinë dhe aftësinë e nxënësve për të mësuar në një ambjent të sigurt dhe të parrezikshëm, ku ato trajtohen me respekt (Shellard dhe Turner, 2004; Lumsted, 2002).

Përhapja e bulizmit në shkolla është më e madhe sesa raportohet nga nxënësit, punonjësit arsimor, psikologët, punonjësit social dhe prindërit, pasi aktet buliste shpesh nuk perceptohen si të tilla dhe gjithashtu edhe për faktin sepse ato ndodhin shpesh jashtë syrit të personave të lartpërmendur dhe shpesh nuk raportohet si të tilla.

Në shkollat shqiptare fenomeni i bulizmit është prezent, por shumica e nxënësve, e mësuesve, psikologëve, punonjësve social dhe e prindërve për shkak të mos paturit informacion rreth fenomenit të bulizmit, nuk janë të aftë të evidentojnë sjelljet buliste. Duke mos qenë të aftë t'i evidentojnë këto sjellje, ato nëpërmjet mosndërhyjes ndaj atyre, në mënyrë të pavetëdijshme i përforcojnë sjelljet buliste.

Për të marrë masat e duhura ndaj fenomenit të bulizmit është e nevojshme që fillimisht të kihen informacione rreth formave të bulizmit, rreth vendeve ku bulizmi ndodh, rreth gjinisë dhe klasës që frekuentojnë autorët dhe viktimat e bulizmit si dhe rreth përfshirjes apo jo në zbutjen e bulizmit të bashkënxënësve të tjerë apo të më të rriturve.

Arsyet kryesore për kryerjen e këtij studimi janë:

- Mosekzistenca e asnjë studimi rreth bulizmit në bashkinë e Elbasanit. Deri më tani në shkollat 9 vjeçare të Bashkisë së Elbasanit nuk është realizuar asnjë studim në lidhje me fenomenin e bulizmit.

- Mospasja e informacionit të detajuar rreth fenomenit të bulizmit nga ana e institucioneve kryesore të Bashkisë së Elbasanit, të cilët mund të kontribuojnë në parandalimin, zbutjen dhe trajtimin e rasteve të përfshirjes në bulizëm.
- Kërkimi dhe rekomandimi i praktikave më të mira për shkollat për të mbështetur hartimin e strategjive dhe politikave në lidhje me ndërhyrjen dhe parandalimin e sjelljeve buliste, duke marrë në konsideratë dhe praktikatat e ndërmarra në bashkinë e Mynih -ut.
- Rekomandimi i zbatimit të programeve ndërgjegjëse, të ndërhyrjeve dhe të parandalimit antibulizëm.

Duke u bazuar në pasojat serioze afatshkurtra dhe afatgjata të bulizmit mbi shëndetin mendor dhe fizik (Ttofi dhe Farrington, 2008), kuptohet pse bulizmi në shkolla është një shqetësim publik gjithnjë e në rritje dhe si rrjedhojë dhe kërkimet shkencore në lidhje me këtë fenomen janë shtuar gjithnjë e më tepër.

Kërkimet shkencore mbi bulizmin janë zgjeruar mjaft në tërë botën (Smith, Morita, Junger – Tas, Olweus, Catalano dhe Slee, 1999) dhe në mjaft vende zbatohen programe të ndryshme ndërhyrëse (Smith, Pepler dhe Rigby, 2004). Në disa shtete të Amerikës janë shtruar kërkesa për të aplikuar ligjërisht politika antibulizëm nëpër shkolla (Ananiadow dhe Smith, 2002).

Pasojat e bulizmit në shkolla janë të konsiderueshme (Hawker dhe Boulton, 2000) dhe strategjitë ndërhyrëse për ndalimin e bulizmit në shkolla dhe për promovimin e një komuniteti shkollor më të sigurt duhet të jetë një detyrim moral i politikave qeverisëse (Smith, Ananiadow dhe Cowie, 2003).

1.3. Korniza teorike

Bulizmi midis nxënësve është padyshim një fenomen mjaft i hershëm. Fakti që disa fëmijë janë ngacmuar dhe sulmuar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike nga fëmijët e tjerë është përshkruar në shumë vepra letrare dhe shumë të rritur kanë eksperiencë personale të bulizmit nga vetë periudha e tyre shkollore. Është shumë e rrallë që një person të mos e kujtojë, apo të mos e dijë se ai gjatë fëmijërisë apo adoleshencës së tij mund të ketë qenë autor, viktimë apo spektator i akteve buliste (Hoover, 2000).

Megjithatë studimet e mirëfillta dhe sistematike rreth bulizmit janë kryer në fillimet viteve 1970 (Olweus, 1973 dhe 1978). Për shumë vite këto studime ishin të kufizuara në shtetet Skandinave. Në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990 bulizmi në shkolla filloi të studiohej dhe në shtete të tjera si Japoni, Angli, Hollandë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Australi. (Olweus, 1993). John Hoover - i (Xhon Huvër) në studimin e tij të vitit 1992, zbuloi se rreth 14% e të gjithë nxënësve në Midwestern – in rural të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë qenë të traumatizuar nga mënyra të moderuara deri në mënyra më të rënda nga një autor i akteve buliste në një moment të caktuar të jetës së tyre shkollore (Hoover, 2000). Bulizmi në ditët e sotme është një fenomen shqetësues social në mbarë botën dhe si rrjedhojë ai ka tërhequr gjithnjë e më tepër vëmendjen e studiuesve dhe kërkuesve shkencore.

Zëri më prominent dhe pionieri i studimeve dhe kërkimeve shkencore rreth bulizmit është Dan Olweus, i cili filloi kërkimet e tij gjithëpërfshirëse rreth shkaqeve dhe pasojave të bulizmit që në vitin 1970 në shkollat skandinave.

Sipas Olweus - it, (Olweus - it) një nxënës është viktimë e bulizmit, nëse ai është ekspozuar në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme ndaj abuzimeve dhe ngacmimeve të kryera nga një ose disa nxënës. (Olweus, 1996). Qëllimi i autorit të akteve buliste është fitimi i pushtetit dhe dominimi mbi viktimën.

Përcaktimet më të shumta të bulizmit përfshijnë sjellje agresive, të cilat karakterizohen nga tre tiparet e mëposhtme:

- Qëllim për t'i shkaktuar dëm viktimës;
- Përsëritje e vazhdueshme e sjelljeve agresive;
- Çekulibër pushteti midis autorit dhe viktimës së akteve buliste.

(Barboza etj., 2009; Craig; Liu dhe Graves, 2011).

1.3.1 Arsyet përse nxënësit përfshihen në akte buliste:

Nxënësit në shkolla krahas nevojave bazë fizike, kanë gjithashtu dhe nevoja bazë emocionale dhe psikologjike. Që nxënësit të mund të zhvillojnë tërë potencialin e tyre duhet të plotësohen nevojat e mëposhtme fizike, emocionale dhe psikologjike:

- Nevoja për t'u ndjerë i sigurt fizikisht dhe emocionalisht;

- Nevoja për t'i përkitur grupit të nxënësve, në të cilin ato e ndjejnë se mund të bëjnë pjesë;
- Nevoja për t'u pranuar nga bashkënxënësit, të cilët ato i vlerësojnë dhe i duan më shumë;
- Nevoja për t'u ndjerë i respektuar dhe i vlerësuar nga bashkënxënësit.

Kur këto nevoja plotësohen nxënësit janë individë me vetërespekt të lartë dhe japin kontribute pozitive në komunitetin e tyre. Por nëse këto nevoja nuk plotësohen, atëherë nxënësit kanë tendencën të kryejnë apo të lejojnë pësimin e akteve buliste për të plotësuar nevojat e lartpërmendura. Nxënësit, të cilët sillen në mënyrë agresive apo të cilët nuk i respektojnë bashkënxënësit apo mësuesit e tyre, mund të sillen në mënyrë të tillë pasi nuk ndjehen të pranuar nga ata. Për arsye të ndryshme ato mund të ndjehen të riskuar dhe të pasigurt në klasë dhe si reagim i këtyre ndjenjave ato përpiqen ta shfaqin veten trima dhe të pushtetshëm përballë bashkënxënësve të tyre.

Kryerja apo pësimi i akteve buliste mund të influencohen gjithashtu edhe nga rolet gjinore të imponuara nga komuniteti apo nga statusi social i nxënësve dhe familjeve prej të cilave ato rrjedhin në komunitet. Nga nxënëset ekziston pritshmëria që ato të jenë më të nënshtruara sesa nxënësit. Gjithashtu, edhe nxënësit të cilët vijnë nga familje me status social – ekonomik dhe social – kulturor të ulët, si dhe nxënësit të cilët janë të stigmatizuar për shkak të një paaftësie fizike apo një çrregullimi psikologjik, kanë më shumë probabilitet dhe tendencë të përfshihen në akte buliste, si në rolin e autorit, ashtu edhe në rolin e viktimës.

1.3.2 Format e bulizmit

Bulizmi mund të shfaqet në shumë forma. Nëntë format më të përhapura dhe për të cilat nxënësit pyeten në pyetësit e bulizmit të Olweus - it (Olweus –it) janë si më poshtë vijojnë:

1. Bulizmi verbal duke përfshirë komentet poshtëruese ose nofkat keqdashëse;
2. Bulizmi nëpërmjet përjashtimit social ose izolimit;
3. Bulizmi fizik i tillë si goditjet, shtyrjet, përleshje, goditjet dhe pështyrjet;
4. Bulizmi nëpërmjet gënjeshtreve dhe përhapja e thashethemeve;

5. Dëmtimi apo përvetësimi i parave apo i sendeve të tjera personale të viktimës;
6. Kërcënimi apo detyrimi me forcë i kryerjes së sjelljeve të ndryshme nga ana e viktimës;
7. Bulizmi rracor;
8. Bulizmi seksual;
9. Bulizmi kibernetik (nëpërmjet celularit apo internetit).

1.3.3 Ndarja e roleve në bulizëm

Fëmijët që përfshihen në bulizëm kanë role të ndryshme dhe ndahen në tre grupe kryesore (Alsaker, 2003):

- Autorët janë nxënësit të cilët kryesisht ngacmojnë dhe torturojnë të tjerët, dhe rrallë herë mund të përjetojnë ngacmim apo eksperiencë viktimizuese vetë;
- Viktimat janë nxënësit të cilët kryesisht ngacmohen dhe torturohen, por nuk kryejnë asnjë veprim ngacmues apo torturues vetë;
- Spektatorët janë ato nxënës, të cilët nuk janë viktima të bulizmit, dhe as pjesëmarrës aktiv në bulizëm, por ato janë dëshmitarë të bulizmit.
- Grupi autorë – viktima janë nxënësit, të cilët dhe ngacmojnë e torturojnë të tjerët, por njëkohësisht dhe ngacmohen apo torturohen nga nxënësit e tjerë.

http://www.violencepreventionworks.org/public/recognizing_bullying.page

1.3.4 Pasojat e bulizmit

Sjelljet buliste, të kryera qoftë edhe nga një autor i vetëm, mund të kenë pasoja të shumta mbi viktimat, spektatorët dhe madje dhe në tërë klimën e shkollës dhe në mbarë komunitetin.

Viktimat e akteve buliste përgjithësisht vuajnë nga pasoja të tilla si:

- Depresion;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Probleme shëndetësore;
- Nota të ulëta;
- Mendime vetëvrasëse.

Autorët e akteve buliste përgjithësisht vuajnë nga pasoja të tilla si:

- Përfshirje në grindje të vazhdueshme;
- Dëmtim dhe përvetësim i pronave të tjerëve;
- Abuzim me substancat;
- Nota të ulëta;
- Perceptim i një klimë negative në shkollë;
- Mbajtje armësh.

Spektatorët e akteve buliste përgjithësisht vuajnë nga pasoja të tilla si:

- Frikë dhe ankth;
- Pafuqi për të vepruar;
- Ndjenja faji për mosveprim;
- Tundim për të marrë pjesë.

Kur nuk ndërmerren masa për ndalimin dhe parandalimin e akteve buliste, e gjithë klima e shkollës mund të ndikohet negativisht në mënyrat e mëposhtme:

- Shkolla zhvillon një ambjent ku zotëron frika dhe mosrespekti;
- Nxënësit kanë vështirësi në përqëndrim dhe në procesin e të nxënit;
- Nxënësit ndjehen të pasigurt;
- Nxënësit nuk e pëlqejnë shkollën;
- Nxënësit perceptojnë se mësuesit dhe stafi psiko - social kanë pak kontroll mbi to dhe nuk u intereson çfarë ndodh me ato.

http://www.violencepreventionworks.org/public/recognizing_bullying.page

1.3.5 Programi i parandalimit të bulizmit i Olweus - it

Bazuar në pasojat serioze që ka bulizmi mbi të gjithë grupet e përfshirë në të, lind nevoja emergjente që të ndërmerren masa për zbutjen, ndalimin dhe parandalimin e tij. Bazuar dhe në meta - analizën e kryer vitet e fundit nga Ttofi (Tofi) dhe Farrington - i (Fehringtun –i) rezulton se në botë aplikohen programe të ndryshme parandalimi dhe antibulizëm dhe këto programe janë efektive në reduktimin e bulizmit. Gjithashtu ato theksojnë se programet e parandalimit e bazuar në veprën e Dan Olweus - it (Den Olweus – it) janë më efektive (Ttofi etj., 2008, faqe 69).

Programi i parandalimit të bulizmit i Olweus - it është një program i përbërë nga shumë komponentë dhe nivele dhe ka si qëllim kryesor pakësimin dhe parandalimin e bulizmit në shkolla. Si qëllim dytësor ai ka rritjen e ndërgjegjësimit dhe të njohurive rreth bulizmit, përfshirjen e mësuesve dhe të prindërve në parandalimin e bulizmit, hartimin e rregullave të qarta kundër bulizmit si dhe ofrimin dhe sigurimin e ndihmës ndaj viktimave dhe autorëve të akteve buliste. Ky program përmban komponente të nivelit të shkollës, klasës dhe të atij individual.

- Komponentët e nivelit të shkollës konsistojnë në vlerësimin e natyrës dhe përhapjes së bulizmit në shkollë, krijimin e një komuniteti për të koordinuar programin parandalues dhe zhvillimin e një sistemi i cili siguron mbikëqyrjen e nxënësve jashtë klasës.
- Komponentët e nivelit të klasës konsistojnë në përcaktimin dhe fuqizimin e rregullave kundër bulizmit, diskutimet dhe aktivitetet për përforcimin e vlerave dhe normave antibulizëm si dhe përfshirjen aktive të prindërve në program.
- Komponentët e nivelit individual konsistojnë në mbështetjen dhe ndihmesën ndaj nxënësve me histori të përfshirjes në akte buliste, qoftë autor apo / dhe viktimë.

Pasojat negative të bulizmit nëpër shkolla janë të konsiderueshme (Hawker dhe Boulton, 2000) dhe strategjitë ndërhyrëse për ndalimin e bulizmit në shkolla dhe për promovimin e komuniteteve shkollore më të sigurta duhet të jetë një detyrim moral (Smith, Ananiadow dhe Cowie, 2003).

1.4 Qëllimi i studimit

Kohët e fundit, fokusi i kërkimeve është zhvendosur nga studime rreth natyrës dhe formave të bulizmit tek kërkimi dhe zbulimi i arsyeve dhe pasojave të bulizmit (Hodges dhe Perry, 1996). Ndaj në këtë kërkim krahas evidentimit së formave më të përhapura të bulizmit, vendeve ku ushtrohet apo pësohet më shpesh bulizëm dhe raportimit të akteve buliste, synohet të analizohen dhe arsyet pse nxënësit përfshihen në bulizëm.

Ndër qëllimet kyesore të këtij studimi janë:

- Të identifikojë prevalencën e bulizmit në shkollat 9 – vjeçare, specifikisht në ciklin e mesëm të ulët, duke u fokusuar në format më të përhapura të

përfshirjes në bulizëm, në vendet ku nxënësit përfshihen më shpesh në bulizëm duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën që ndjekin nxënësit.

- Të analizojë nëse numri i miqve që ka një nxënës në shkollë ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës të përfshihet në bulizëm.
- Të identifikojë arsyet pse nxënësit përfshihen në bulizëm.
- Të identifikojë masat që janë marrë për të trajtuar rastet e bulizmit në shkolla.

Qëllimi i këtij studimi krahas njohjes së fenomenit të bulizmit në shkollat 9 – vjeçare në klasat e ciklit të mesëm të ulët, është gjithashtu të kuptojë rëndësinë e ndërhyrjeve të hershme dhe të zbatimit të programeve kundër bulizmit, t’u japë sugjerime dhe rekomandime aktorëve kyç të cilët veprojnë në këtë fushë si dhe të rrisë ndërgjegjësimin rreth këtij fenomeni dhe veçanërisht rreth pasojave të tij negative afatshkurtra dhe afatgjata jo vetëm mbi nxënësit e përfshirë direkt në bulizëm, por dhe mbi të gjithë komunitetin.

Njëkohësisht studimi ka si qëllim edhe sjelljen e përvojave pozitive të trajtimit dhe parandalimit të fenomenit të bulizmit në disa vende të Europës, përvoja të cilat mund të aplikohen dhe në bashkinë e Elbasanit.

1.5 Pyetjet kërkimore dhe hipoteza

Pyetja e parë kërkimore: *Sa i përhapur është bulizmi në shkolla, duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën që frekuentojnë nxënësit?*

Pyetja e dytë kërkimore: *Çfarë pasojash përjetojnë nxënësit e përfshirë në bulizëm?*

Pyetja e tretë kërkimore: *Cilat janë arsyet kryesore përse nxënësit përfshihen në bulizëm?*

Pyetje e katërt kërkimore: *A janë ndërmarrë masa konkrete për të trajtuar dhe parandaluar fenomenin e bulizmit të shkollë?*

Hipoteza: *Numri i miqve që ka një nxënës në shkollë, ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste.*

1.6 Epërsitë dhe kufizimet

Ky kërkim përshkrues synon të masë përhapjen, frekuencën, tipet e sjelljeve buliste në bashkinë e Elbasanit në popullatën e përgjithshme të nxënësve, të cilët frekuentojnë arsimin bazë, në ciklin e mesëm të ulët dhe përkatësisht nxënës nga mosha 12 deri në moshën 15 vjeç. Deri tani në bashkinë e Elbasanit nuk është kryer asnjë studim me këtë fokus dhe kryerja e këtij studimi është një risi dhe gjithashtu një epërsi e këtij studimi. Kryerja e këtij studimi mund të nxisë dhe kryerjen e studimeve të mëtejshme rreth bulizmit, gjë që do të çonte drejt një trajtimi dhe më efektiv të tij.

Literatura e shqyrtuar gjithashtu u ofron aktorëve kyç në ndërhyrjen dhe parandalimin e këtij fenomeni shqetësues, informacione dhe këndvështrime të reja të trajtimit të bulizmit. Literatura e shqyrtuar sillet kryesisht për herë të parë në gjuhën shqipe dhe kjo literaturë do të jetë një ndihmesë për njohjen sa më të mirë të bulizmit.

Të dhënat e mbledhura në këtë kërkim do të mundësojnë planifikimin e masave parandaluese të duhura, të programeve dhe strategjive ndërhyrëse të përshtatshme për të zbutur dhe parandaluar fenomenin e bulizmit në shkollat 9 – vjeçare të bashkisë Elbasan.

Limitet e këtij kërkimi kanë të bëjnë me mosekzistencën e studimeve paraprake në fushën e bulizmit në bashkinë Elbasan dhe me subjektivizmin apo gjykimin personal të kërkueses që mund të limitojnë përzgjedhjen e literaturës së përfshirë apo të lënë jashtë në këtë kërkim.

Studimi mund të ishte më gjithëpërfshirës dhe i shtrirë dhe më gjerë gjeografikisht, por diçka e tillë ishte e pamundur për shkak të mungesës së mjeteve logjistike dhe financiare.

Gjithashtu studimi ka dhe disa kufizime metodologjike si:

- Pjesëmarrësit e grupit të fokusit kishin njohje me njëri – tjetrin dhe marrëdhëniet paraprake personale dhe institucionale ndikuan pjesërisht në diskutimin e hapur dhe të singertë të tyre. Diçka e tillë ishte e pamundur të shmangej, pasi përbërja e fokus - grupit ishte qëllimisht e konceptuar e përbërë nga ato pjesëmarrës të përzgjedhur, për shkak të vetë të një prej qëllimeve kryesore të studimit.

- Në intervistat individuale, veçanërisht me viktimat e bulizmit ishte e vështirë fillimisht të krijohej marrëdhënia e besimit midis palëve. Të intervistuarit shpesh herë shfaqnin ndrojtje apo dhe ankth gjatë tregimit të akteve buliste që kishin përjetuar si dhe frikë të shtimit të eksperiencave buliste në të ardhmen. Të intervistuarit fillimisht kishin frikë se do të thyej konfidencialiteti dhe anonimiteti i tyre, frikë e cila u pakësua gjatë zhvillimit të intervistave.
- Gjatë përpunimit të të dhënave të fokus - grupit dhe intervistave individuale ekziston rreziku se kodimi dhe analiza e intervistave mund të mos jenë tërësisht objektive. Këto procese mund të jenë ndikuar nga subjektivizmi i studiueses, gjë që mund të ketë ndikuar dhe në nxjerrjen e përfundimeve sa më objektive të studimit.

1.7 Përkufizimi i termave

Bulizëm: Një veprim ose varg veprimesh negative agresive të ushtruara sistematikisht dhe për një periudhë të gjatë kohe nga një ose disa nxënës superior në pushtet ndaj një ose disa nxënësve të tjerë me qëllim shkaktim dëmi ndaj këtyre të fundit (Olweus, 1993, fq 9).

Agresion: Veprime, pas të cilave qëndron qëllimi i qartë për t'i shkaktuar dëm personit tjetër ose për t'i shkaktuar atij vuajtje

Autor: Nxënësi, i cili kryen aktet buliste me qëllim të përfitimit personal ose të dëmtimit të viktimës dhe i cili perceptohet ose ka më shumë pushtet në krahasim me viktimën.

Viktimë: Nxënësi, i cili bie pre e akteve buliste dhe i cili perceptohet ose ka shumë më pak pushtet se nxënësit e tjerë.

Spektator: Nxënësi, i cili nuk është as viktimë dhe as autor i akteve buliste, por që është i pranishëm si vëzhgues gjatë kryerjes së akteve buliste.

Pushtet: Me pushtet në marrëdhënien viktimë/autor nënkuptohet aftësia e autorit të kontrollojë atë që viktima ndjen, mendon apo bën.

Bulizëm kibernetik: Bulizëm, i cili ndodh nëpërmjet pajisjeve elektronike. Ky koncept zakonisht përfshin ngacmimet apo kërcënimet nëpërmjet rrjeteve sociale, komente denigruese, postimin e fotove apo statuseve negative dhe poshtëruese kundrejt viktimës.

Ndërhyrje: Të ndërhysh ose të veprosh kur një akt bulist është duke ndodhur dhe të zbusësh ndërlikimet e aktit që është duke ndodhur (Huseby, 2006).

Parandalim: Të përpiqesh të ndalosh të ndodhë një akt bulist.

1.8 Struktura e punimit

Kërkimi është i organizuar në pesë kapituj.

Në kapitullin e parë jepet konteksti i studimit si dhe korniza teorike mbi të cilin mbështetet studimi. Gjithashtu në këtë kapitull jepen qëllimet, pyetjet kërkimore, hipoteza si dhe epërsitë e kufizimet e studimit. Në fund të kapitullit të parë jepet dhe përkufizimi i termave bazë të studimit.

Në kapitullin e dytë jepet një analizë e autorëve më të njohur të fushës së bulizmit. Nëpërmjet analizës së literaturës më të spikatur në lidhje me bulizmin, jepen informacione të cilët mundësojnë njohjen më të thellë të fenomenit dhe ofrim orvatjesh për ndërhyrje dhe parandalim të tij. Gjithashtu në këtë kapitull jepet dhe një pasqyrë e kuadrit ligjor, në bazë të të cilit mekanizmat e pushtetit qendror, vendor dhe aktorë të tjerë në komunitet operojnë në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Në kapitullin e tretë përshkruhet metodologjia që është ndjekur në kryerjen e këtij studimi. Në të analizohen popullata, tiparet e kampionimit të përzgjedhur, hapat e kryerjes së anketimit, të fokus - grupit dhe të intervistave individuale, karakteristikat psikometrike të pyetësorit të përdorur, konsideratat etike të zbatuara gjatë kryerjes së kërkimit shkencor dhe mënyra e përpunimit statistikor të të dhënave.

Në kapitullin e katërt analizohen rezultatet e studimit duke u bazuar në pyetjet kërkimore dhe në hipotezën e shtruar.

Në kapitullin e pestë pasqyrohen gjetjet e studimit bazuar në përfundimet e nxjerra nga analiza statistikore e pyetësorëve, nga analiza cilësore e fokus - grupit si dhe nga shqyrtimi i literaturës. Në kapitullin e pestë jepen dhe rekomandime dhe sugjerime për zbutjen e fenomenit të bulizmit.

Kapitulli II: SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky kapitull përmban diskutimin e literaturës lidhur me bulizmin midis nxënësve në ambientet e shkollës. Çështjet që do të trajtohen përfshijnë përkufizimin e termit bulizëm, përcaktimin e tipeve të sjelljeve buliste, përcaktimin e vendeve dhe të kohës ku dhe kur ndodh bulizmi, përcaktimin e aktorëve të përfshirë në bulizëm, pasqyrimin e diferencave moshore dhe gjinore në kryerjen e akteve buliste, përcaktimin e faktorëve riskues në kryerjen e akteve buliste, pasqyrimin e pasojave afatshkurtra dhe afatgjata të akteve buliste mbi aktorët e përfshirë në bulizëm si dhe pasqyrimin e programit parandalues të bulizmit të Dan Olweus – it (Dan Olweus-it). Në këtë kapitull janë pasqyruar dhe mekanizmat institucional në nivel qendror dhe vendor të cilët janë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

2.1 Përkufizimi i bulizmit

Në vendet skandinave dhe në ato gjermanofolëse termi “bullying” njihet si “mobbing”. Konrad Lorenz -i (Konrad Lorenc-i) (1966) e përdori termin “mobbing” (mobbing rrjedh nga fjala mobb, e cila do të thotë turmë, grumbull dhe nga fjala pöbel, e cila do të thotë grabitqar) për herë të parë për të përcaktuar sjelljen kur shumë kafshë sulmonin në grup një kafshë të vetme. Në vendet skandinave termi mobbing u përdor më tej për të përkufizuar dhe sjelljet buliste të njerëzve. Heinemann –i (Hajneman –i) ishte ndër të parët i cili përdori termin “mobbing” nga gjuha norvegjeze për të përshkruar dhunën e papritur dhe të shpejtë të një grupi kundër një individi të dobët (Smith dhe të tjerë, 2002). Olweus –i e zgjeroi më tej këtë fenomen, shprehimisht me sulmin e një fëmije të vetëm të fuqishëm kundrejt një fëmije më të dobët. Në vendet anglosaksone ky fenomen njihet me termin “bullying”. Në këtë studim ky fenomen është përkthyer “bulizëm”

Në bazë të një përkufizimi të pranuar botërisht të Olweus - it, i cili ka vlejtur si bazë që në fillimet e studimit sistematik të fenomenit të bulizmit dhe deri në studimet e sotme, mund të flitet për bulizëm kur një fëmijë pëson dhe vuan në mënyrë të përsëritur dhe sistematike veprimet negative të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të një ose më shumë fëmijëve (D. Olweus, 1978).

Formulimi “veprime negative“ nuk duket konçiz. Alsaker - i (Allsakëri) e përpunoi këtë me qëllim që përkufizimi të ishte më i qartë dhe si rrjedhojë dhe dukuria e bulizmit të ishte më e specifikuar. Me “veprime negative” tashmë kuptohen “të gjitha format e sjelljeve agresive dhe të ashpra, të cilat prekin dhe çënojnë mirëqenien psikologjike dhe fizike të personit tjetër”. Tipike e bulizmit është “kryerja e përsëritur e veprimeve negative kundrejt një personi të caktuar” (Alsaker dhe Olweus, 2002).

Olweus e përkufizon një sjellje negative si një shkaktim i paramenduar dhe i qëllimshëm i mos të ndjerit mirë të personit tjetër, gjendje e cila mund të jetë pasojë e një kontakti fizik apo verbal, shprehi fytyre dhe gjestesh, mosrespektim i qëllimshëm i dëshirave dhe propozimeve të tjetrit ose një izolim apo përjashtim social (Olweus, 1978).

Alsaker - i vë theksin gjithashtu dhe aspektit të disekuilibrit midis autorit dhe viktimës. Sipas tij një tipar i rëndësishëm i bulizmit është fakti që viktimat i nënshtrohet mjaft autorit si në mënyrë fizike, verbale ashtu si dhe psikologjike dhe si rrjedhojë ka vetëm shumë pak shance për t’u mbrojtur. Në studimin e tij të parë në lidhje me bulizmin Olweus konstatoi se në përgjithësi ngacmuesit ishin fizikisht më të fuqishëm se viktimat (Olweus, 1973). Më tej Alsaker - i qartësoi se autorët perceptohen si më të fuqishëm nga bashkënxënësit e tyre moshatar, ndërkohë që autorët realisht ka të ngjarë të mos të jenë aq të fuqishëm, sa perceptohen (Alsaker dhe Valkanover, 2000).

Petermann-i (Peterman), Hayer-i (Hajër) dhe Scheithauer - i (Shajthauër –i) e kanë përkufizuar bulizmin si formë specifike e sjelljes agresive. Ato e shikojnë bulizmin si një “tiranizim i përsëritur ose përjashtim apo mënjanim nga bashkënxënësit, me një disekuilibër pushteti midis autorit dhe viktimës (Scheithauer, Hayer dhe Petermann, 2003).

Schuster – i (Shustër –i) e ndan bulizmin në viktimizim dhe refuzim nga bashkëmoshatarët. Viktimizim do të thotë që një individ pëson veprimet negative nga një individ tjetër ose nga një grup i vogël bashkëmoshatarësh. Tek refuzimi fokusi është në rrafshin e grupit (p.sh.. mënyra këndvështrimi nga bashkënxënësit) dhe në qëndrimet dhe mënyrat e sjelljes. Kështu p.sh. një fëmijë mund të tallet, mënjanohet apo përjashtohet në mënyrë aktive dhe të sulmohet fizikisht nga disa bashkëmoshatarë (d.m.th. viktimizohet), por për bashkënxënësit e tjerë mund të jetë person i dashur dhe/ose mund të jetë i pranuar (d.m.th. nuk mënjanohet apo përjashtohet). Anasjelltas një fëmijë mund të mos pranohet

nga shumica e bashkënxënësve (d.m.th. mënjanohej ose përjashtohet), dhe nuk pëson asnjë veprim viktimizues nga to (Schuster, 1999).

Sipas Dodge-it (Daxh-it) dhe Coie – it (Koë -it) bulizmi është një formë e agresionit proaktiv, gjatë të cilit sjellja buliste nuk është e provokuar dhe vetë autori i sjelljes buliste e nis atë (Dodge dhe Coie, 1987).

2.2 Fakte rreth bulizmit

Bulizmi është forma më e zakonshme e dhunës në shoqërinë tonë. Studimet kanë treguar se rreth 30% e nxënësve nga klasa e gjashtë deri në klasën e dhjetë përfshihen në bulizëm si autor, si viktimë apo në të dyja rolet njëkohësisht. (Lufto krimin: Investo për fëmijët, 2003; Harris dhe Willoughby, 2003; Cohn dhe Canter, 2003; Bowman, 2001; LREN, 2001). Kërkuesit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit të Fëmijëve dhe Zhvillimit Njerëzor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës raportojnë se nga 30% e nxënësve të përfshirë në bulizëm, 13% raportojnë se ato kryejnë akte buliste mbi nxënësit e tjerë, 11% raportojnë se janë pre e akteve buliste dhe 6% raportojnë se ato janë njëkohësisht edhe autorë, edhe viktima të akteve buliste (Lufto krimin: Investo për fëmijët, 2003). 8% e nxënësve raportuan se ato kanë rënë pre e akteve buliste të paktën një herë në javë (LREN, 2001).

Bulizmi ka tendencën të rritet në klasat e ciklit fillor, aktet buliste arrijnë pikun e tyre në klasat e ciklit të mesëm të ulët dhe ulen në klasat e dymbëdhjeta dhe trembëdhjeta (LREN, 2001; Olweus, 1993). Forma më e përgjithshme e bulizmit është abuzimi verbal dhe ngacmimi, i ndjekur nga izolimi social dhe komentet poshtëruese rreth pamjes së jashtme fizike (Shellard, 2002). Në ciklin e arsimit të mesëm të ulët dhe në ciklin e arsimit të mesëm të lartë, bulizmi përfshin më së shumti ngacmimin dhe përjashtimin social, por ai gjithashtu mund të përfshijë dhe dhunë fizike, kërcënime, vjedhje, ngacmim seksual dhe racor, poshtërimin publik dhe shkatërrimin e pronave. Në klasat e ciklit të arsimit fillor bulizmi ka më shumë të ngjarë të përfshijë agresion fizik, por gjithashtu ai karakterizohet nga ngacmimi, frikësimi dhe përjashtimi social (Banks, 1997). Bulizmi shpesh ndodh në zona ku mungon mbikëqyrja e të rriturve (korridoret, dhomat e kyçyra, dhomat e pushimit

apo të zhveshjeve në palestra, në mensë dhe rrugës për në shkollë); megjithatë dhe klasat, ku është prezente prania e të rriturve, nuk janë të sigurta (Shellard, 2002).

Si djemtë, ashtu dhe vajzat përfshihen në bulizëm. Kërkimet më të shumta tregojnë se djemtë ka më shumë të ngjarë të jenë dhe autorë dhe viktime (Cohn dhe Canter, 2003; Nansel dhe të tjerë 2001; LREN, 2001); gjithsesi frekuenca me të cilën përfshihen djemtë dhe vajzat në bulizëm mund të jetë e lidhur dhe me faktin se si përcaktohet ose identifikohet bulizmi (vetëm agresion fizik i dukshëm apo dhe disa forma dinake të bulizmit) (LREN, 2001). Duke u bazuar në raportin e “Indikatorët e Krimit dhe Sigurisë në Shkollë”, 2004 nuk u gjet ndonjë ndryshim domethënës midis përqindjes së meshkujve dhe femrave, të cilët raportuan se kishin rënë pre e akteve buliste. (8% të djemve kundëjt 7% të vajzave) (DeVoe dhe të tjerë, 2004). Tipike tek bulizmi i ushtruar nga djemtë është agresioni fizik, ndërsa tek bulizmi i kryer nga vajzat tipike janë përdorimi i mënyrave më dinake, kryesisht në format e ngacmimit dhe përjashtimit social. Vajzat kanë më shumë të ngjarë të kryejnë akte buliste mbi vajzat e tjera dhe djemtë kanë tendencën të kryejnë akte buliste si mbi djemtë, ashtu dhe mbi vajzat (Nansel dhe të tjerë, 2001; Hoover dhe Oliver, 1996).

Pak dallime janë zbuluar në përfshirjen e akteve buliste për shkak të racës dhe etnisë. Duke u bazuar në raportin e “Indikatorët e Krimit dhe Sigurisë në Shkollë”, 2004 u gjet se nxënësit e bardhë në krahasim me nxënësit afroamerikane apo hispanikë, raportuan pak më shumë raste të të rënë pre e akteve buliste (8% të nxënësve të bardhë, kundëjt 6% të nxënësve afroamerikane dhe hispanikë); gjithashtu dhe nxënësit nga zonat rurale raportuan të kishin rënë më shpesh pre e akteve buliste në krahasim me nxënësit e zonave urbane dhe periferike (10% e nxënësve të shkollave rurale kundëjt 7% të nxënësve të zonave urbane dhe periferike) (DeVoe dhe të tjerë, 2004).

Më poshtë jepen disa nga statistikatat më të fundit mbi fenomenin e bulizmit, të përpiluara në vitin 2012 nga Byroja e Statistikave të Drejtësisë, Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, në 5 shtete të Amerikës, si: Kalifornia, New York, Illinois, Pennsylvania dhe Washington:

- Fëmijë që raportojnë se kanë qënë viktime të bulizmit gjatë kohës që kanë qënë në shkollë - 37% ;

- Fëmijë që ngacmojnë të tjerët dhe që janë shkaktarë të bulizmit - 17 %;
- Fëmijë që bëjnë shaka me fenomenin e bulizmit - 20%;
- Fëmijë që kërcënojnë nëpërmjet thashethemeve - 10%;
- Bulizmi psikologjik - 20%;
- Kërcënime - 6% ;
- Fëmijë që kanë qënë të përjashtuar nga aktivitetet të ndryshme mes moshatarëve - 5%;
- Përqindja e sjelljeve buliste të ndodhura brenda mureve të shkollës - 85%;
- Përqindja e akteve buliste të ndodhura brenda oborrit të shkollës, në autobus ose gjatë rrugës për në shtëpi – 11 %;
- Përqindja e shkollave të mesme që kanë raportuar probleme me bulizmin - 44%;
- Shkollat fillore që raportojnë probleme me bulizmin - 20%;
- Përqindja e nxënësve që shmangin shkollën apo vende të caktuara, sepse janë të frikësuar nga dëmtimet apo lëndimet - 7%;
- Përqindja e lëndimeve me armë në ambjentet e shkollës - 8%.

Statistika për bulizëm kibernetik:

- Përqindja e nxënësve të cilët kanë raportuar se janë viktimë të ngacmimeve kibernetike - 52%;
- Adoleshentë të cilët kanë përjetuar bulizëm kibernetik - 33%;
- Adoleshentë të cilët janë keqtrajtuar në mënyrë të përsëritur nga telefonat e tyre celularë apo internet - 25%;
- Adoleshentë të cilët nuk u tregojnë prindërve të tyre kur u ka ndodhur bulizmi kibernetik - 52%.

(Bulizmi: Raport analitik i Alo 116; janar – qershor 2013).

Statistika rreth bulizmit në rang ndërkombëtar

Në studimin ndërkombëtar “Profili ndër – kombëtar i bulizmit dhe viktimizimit midis adoleshentëve në 40 shtete”, i kryer nga HBSC, 2005 – 2006 dhe gjatë të cilit u përfshinë në studim 202.056 nxënës të moshës 11 – 15 vjeç, u konstatua se ndër to: 10.7% (21.192 nxënës) janë autorë të akteve buliste, 12.6% (24.919) janë viktimë të bulizmit dhe

3.6% (7.138 nxënës) janë autorë – viktimë të akteve buliste. (International Jouth Public Health, 2009, Sep; 54 (Suppl 2), fq 216 – 224)

Përfshirja e djemve në bulizëm (si autorë, viktimë dhe autorë – viktimë) varion nga 8.6 % në Suedi deri në 45.2% në Lituani dhe ajo e vajzave nga 4.8% në Suedi në 35.8% në Lituani. Siç konstatohet dhe nga tabelat e mëposhme, përkatësisht në tabelën 1 dhe 2, dhe në shtetet e Europës Veri – Perëndimore (veçanërisht në ato Skandinave) raportohet një përhapje më e pakët e bulizmit në krahasim me shtetet e Europës Lindore.

Shteti	Numri i djemve	Përqindja
Suedi	2158	8.6
Republika Çeke	2367	9.7
Spanjë	4217	10.2
Islandë	4664	10.3
Hungari	1648	12
Finlandë	2468	13.3
Irlandë	2389	14.5
Skoci	2985	15.1
Maltë	667	15.1
Norvegji	2357	15.3
Kroaci	2401	15.7
Angli	2248	16.5
Danimarkë	2715	17
Slloveni	2493	18
Hollandë	2104	18.5
Itali	1965	19.6
Maqedoni	2616	20.3
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	1782	22.2
Kanada	2744	23.3
Francë	3470	24
Poloni	2632	24.6
Portugali	1802	24.9
Luksemburg	2035	28.8
Zvicër	2217	27
Gjermani	3597	27.1
Belgjikë	2159	28.5
Izrael	2230	30.5
Rusi	3829	30.8
Austri	2338	33.2

Bullgari	2327	33.3
Ukrainë	2324	34.4
Turqi	2752	36.6
Rumani	2040	38
Greqi	1713	41.3
Estoni	2192	42.8
Letoni	1996	43.5
Lituani	2792	45.2

Tabela 1: Numri dhe përqindja e djemve të përfshirë në bulizëm në shtete të ndryshme

Shteti	Numri i vajzave	Përqindja
Suedi	2208	4.8
Islandë	4600	5.4
Maltë	689	6.3
Republika Çeke	2335	6.6
Spanjë	4445	8
Norvegji	2211	8.4
Finlandë	2715	8.8
Irlandë	2357	8.9
Hungari	1802	8.9
Kroaci	2500	9.9
Slloveni	2508	10.1
Hollandë	2096	10.6
Danimarkë	2958	10.9
Maqedoni	2638	11
Itali	1944	11.3
Poloni	2836	11.5
Skoci	3066	11.9
Angli	2415	12.1
Izrael	3123	15.3
Belgjikë	2041	16
Zvicër	2337	16.5
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	1973	16.5
Portugali	1966	16.7
Kanada	3051	17
Gjermani	3569	18.2
Austri	2437	18.3

Bullgari	2410	18.5
Francë	3545	18.8
Luksemburg	2051	19.5
Rusi	4269	23.4
Estoni	2246	25.6
Rumani	2518	26.7
Greqi	1926	28.3
Turqi	2543	28.7
Ukrainë	2650	28.8
Letoni	2173	32
Lituani	2684	35.5

Tabela 2: Numri dhe përqindja e vajzave të përfshira në bulizëm në shtete të ndryshme

2.2.1 Fakte rreth bulizmit në Gjermani

Bazuar në kërkimin empirik i kryer më 2009 nga Prof. Dr. Reinhold S. Jäger, ZepF dhe universitetit të Koblez –it nëpërmjet një anketimi telefonik me nxënës dhe nxënës në Gjermani rreth fenomenit të bulizmit u konstatua se përfshirja në bulizëm fillon të rritet nga mosha 10 vjeç dhe vazhdon të intensifikohet gjithnjë e më shumë deri në moshën 17 vjeç dhe në vazhdimësi fillon të pakësohet. Rreth 40% e nxënësve të përfshirë në bulizëm ndjekin klasat 5 -7; rreth 50% ndjekin klasat 8 – 10 dhe rreth 10% ndjekin klasat 11 – 13.

Bazuar në studimin e kryer në Mynih (M.Schäfer dhe G.Herpel: Raport – Bulizmi, 2010) u konstatua se ndër 10 milion nxënës në Gjermani, rreth 500.000 prej tyre janë viktima të bulizmit; 3 – 5% të nxënësve pohuan se ato bien pre e bulizmit një ose shumë herë në javë.

Bazuar në studimin e kryer nëpërmjet anketimit telefonik të 5892 nxënësve, nga grupi i punës të universiteteve në Mynih, Shtutgard dhe në Frajburg, në periudhën kohore tetor 1999 – nëntor 2000 u konstatua se rreth 10% e nxënësve të anketuar pranuan se ushtrojnë akte buliste dhe rreth 15% e tyre i pësojnë ato. 90.3% e të telefonuarve ishin midis moshës 10 dhe 15 vjeç.

➤ **Format e bulizmit:**

- ❖ 55,6 % përfshihen në bulizëm verbal;
- ❖ 25,1 % përfshihen në bulizëm fizik;
- ❖ 19,3% përfshihen në bulizëm jo të drejtpërdrejtë.
- Vendet ku ushtrohet bulizëm:
 - ❖ 70,8 % në oborrin e shkollës;
 - ❖ 66,9 % në klasa;
 - ❖ 26,3 % në korridoret e shkollës;
 - ❖ 19,9 % në vende të tjera.
 - ❖ 12.5 % gjatë rrugës për në dhe nga shkolla;
- Kohëzgjatja e rasteve të bulizmit:
 - ❖ 75% e të gjithë të telefonuarve raportuan se bulizmi ka zgjatur tashmë mbi tre muaj e gjysëm.
 - ❖ Në 67.2% të rasteve viktimat ka rënë pre e akteve buliste çdo ditë;
 - ❖ Në 23.1% të rasteve viktimat ka rënë pre e akteve buliste 2 -3 herë në javë;
 - ❖ Nga 103 nxënës, që vuajnë nga raste ekstreme bulizmi, 87% e tyre pësojnë bulizëm prej një periudhë më shumë se 1 vit;
- Problemet dhe pasojat negative të viktimave të bulizmit:
 - ❖ Pakënaqësi për të shkuar në shkollë deri në braktisje të shkollës;
 - ❖ Izolim, tërheqje sociale;
 - ❖ Rënie e vetëbesimit;
 - ❖ Rënie e notave;
 - ❖ Probleme psikosomatike;
 - ❖ Tentativë vetëvrasjeje.
- Tiparet e autorëve:
 - ❖ Në 88% të rasteve autorët janë nga e njëjta klasë;
 - ❖ Në 12% të rasteve nga një klasë tjetër më e lartë;
 - ❖ Në çdo klasë ka një viktimë të bulizmit.
- Sa ndihmohen viktimat bulizmit nga bashkënxënësit?
 - ❖ 57,6 % e viktimave nuk morën asnjë ndihmë nga bashkënxënësit;
 - ❖ 36.7% e viktimave u ndihmuan nga pak bashkënxënës;

- ❖ 4.8% e viktimave u ndihmuan nga shumë bashkënxënës;
- ❖ 0.9% e viktimave u ndihmuan nga thuajse të gjithë bashkënxënësit.

Viktimat kërkojnë ndihmë. 57.1% e viktimave u kërkojnë ndihmë mësuesit kujdestar; 48.6% u kërkojnë ndihmë prindërve të tyre. Situata e viktimave përmirësohet mbas ndihmës në vetëm 6% të rasteve. 74% e viktimave vazhduan të vuanin në të njëjtën masë nga bulizmi, d.m.th. bulizmi mbeti konstant. Nëse bashkëbisedimi rreth pësimit të bulizmit me mësuesin kujdestar nuk çoi në asnjë rezultat pozitiv, 33% e prindërve kryen një bashkëbisedim me drejtorin e shkollës. Marrja e vetëm kësaj mase në 86% të rasteve nuk çoi në asnjë përmirësim të situatës së viktimës.

2.3 Bulizmi si formë e veçantë e sjelljes agresive

Bulizmi është një tip i sjelljes agresive. Ai shihet si një rast i veçantë i sjelljes agresive, pra tiranizimi i përsëritur ose përjashtimi nga të tjerët gjatë një çekulibri pushteti apo force midis autorit dhe viktimës, i cili mund të shprehet si në formë të drejtpërdrejtë, ashtu dhe në formë jo të drejtpërdrejtë dhe ndër të tjera është e vëzhgueshme në kontekstin shkollor (Andershed, Kerr dhe Stattin, 2001; Cowie, 2000; Leary, Kowalski, Smith dhe Philips, 2003; Roland dhe Idsoe, 2001; Salmivalli dhe Nieminen, 2002).

Gjithsesi bulizmi nuk duhet të barazohet me agresionin ose dhunën; jo të gjitha sjelljet agresive apo dhunuese përfshijnë bulizmin, dhe jo të gjitha sjelljet buliste përfshijnë agresion ose dhunë (Baldry dhe Farrington, 1999).

2.3.1 Sjellja agresive

Sipas Petermann (Petërmani –it), Niebank (Nibank) dhe Scheithauer – it (Shajtëhauër –it) në rastin e agresionit kemi të bëjmë me një sjellje, e cila ka qëllim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë dëmtues; kjo sjellje perceptohet si dëmtuese nga viktima. Ajo kalon në tre sfera: sfera motivuese, emocionale dhe sjellore (Petermann, Niebank dhe Scheithauer, 2004).

Si sjellje agresive konsiderohen të gjitha sjelljet spikatëse, të cilat shkelin normat apo rregullat shoqërore ose të drejtat e personave të tjerë. Sjelljet agresive nuk shfaqen vetëm në një formë të caktuar; përkundrazi ato janë sjellje mjaft heterogjene, pasi këtu

përfshihen forma të ndryshme sjelljesh agresive (Petermann, Niebank dhe Scheithauer, 2004).

Në varësi të sferave të ndryshme të ambientit shoqëror, në të cilat ndodh sjellja agresive, mund të shfaqen dhe krahasohen forma të caktuara të sjelljes agresive (shih figurën 1; Vitiello & Stoff, 1997).

Keqdashës (me qëllim t'i bëjë keq një personi).	Kundrejt	Instrumental (me qëllim për të arritur diçka të caktuar).
I hapur (e shpreh hapur të qenit keqdashës dhe i vrazhdë, impulsiv dhe i pakontrolluar, si p.sh. zihet fizikisht dhe verbalisht)	Kundrejt	I maskuar (fshihet dhe maskohet, instrumental dhe i kontrolluar, si p.sh. vë zjarr ose vjedh).
Reagues (reagim ndaj një kërcënimi ose provokimi).	Kundrejt	Aktiv (vepron ose argumenton në bazë të një qëllimi, për të arritur diçka të caktuar).
„Grabitqar“ (i kontrolluar, i orintuar në bazë të një qëllimi, i planifikuar dhe i maskuar).	Kundrejt	Emocional (i pakontrolluar, i paplanifikuar dhe impulsiv).

Tabela 3. Dikotimia e sjelljes agresive (Vitiello dhe Stoff, 1997)

Nga rezultatet e anketimeve të kryera nga studime të ndryshme është konstatuar se rruga dhe mënyra se si shfaqet sjellja agresive është në varësi të gjinisë dhe moshës, kështu p.sh.. djemtë zgjedhin forma të sjelljes agresive fizike dhe të drejtpërdrejta, ndërkohë që vajzat zgjedhin forma jo të drejtpërdrejta, të maskuara dhe verbale të sjelljes agresive.

Mënyra të caktuara të sjelljes agresive shfaqen në mënyrë tipike fillimisht që në moshën e fëmijërisë si p.sh. sjellja kundërshtuese ose provokuese; disa të tjera shfaqen më vonë rreth moshës shkollore dhe në adoleshencë si p.sh. kërcënimi i të tjerëve, rrahja, vjedhja (Moffitt dhe të tjerë, 2005).

Dodge – i (Daxhi-i) i ndan veprimet agresive në: agresion reagues dhe agresion proaktiv. Me agresion reagues kuptohen veprimet me baza emocionale si reagim ndaj një provokimi të perceptuar, ndërkohë që me agresion proaktiv kuptohen veprimet e kryera në mënyrë instrumentale, d.m.th. për të arritur një qëllim të caktuar dhe pa provokim të mëparshëm. Këto forma të sjelljeve agresive shpesh shfaqen në mënyrë të përzierë tek individët, d.m.th. mënyrat agresive të sjelljes mund të përmbajnë si aspekte reaguese dhe aspekte proaktive, kjo shpesh dhe për faktin se, si nxitësit, ashtu dhe funksioni i tyre shpesh është i paqartë (Dodge, 1991).

Në themel të formave të ndryshme të sjelljeve agresive qëndrojnë shkaqe apo arsye të ndryshme, veçanërisht rrethana me rrezik të lartë. Kështu p.sh. ekzistojnë ndryshime në përpunimin social – konjitiv të informacionit midis djemve agresiv reagues dhe proaktiv. Ndërkohë që fëmijët agresiv reagues kanë tendencë të interpretojnë në mënyrë të gabuar sjelljen e të tjerëve si keqdashëse, tek fëmijët agresiv proaktiv nuk shfaqen shtrembërime të tilla konjitive (Frick dhe të tjerë, 2003).

Prej disa vitesh sjellja agresive trajtohet në mënyrë më të diferencuar dhe klasifikohen dhe forma të mëtejshme të sjelljeve agresive, veçanërisht ato të shfaqura tek vajzat: jo të drejtpërdrejta, dhe veçanërisht ato të lidhura me agresionin social. E përbashkët tek format e varura dhe sociale të sjelljeve agresive është fakti se ato përfshijnë dëmtime të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të një personi në grupin social, të cilit ai i përket, p.sh. manipulimi social, diskretitimi, shpifja, përjashtimi nga grupi etj. (Scheithauer, Hayer dhe Petermann, 2003). Karakteristikë për agresionin social është gjithashtu dhe fakti se ai ndodh pa përballje të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe kërcënuesit. Agresioni jo i drejtpërdrejtë ndryshon nga agresioni social, për faktin se në rastin e agresionit jo të drejtpërdrejtë nuk përdoret ambjenti social për dëmtimin e viktimës (Xie dhe Cairns, 2005).

2.3.2 Lindja e sjelljeve agresive

Ende debatohet nëse sjellja agresive është kryesisht e mësuar dhe kushtëzohet prej faktorëve të ambjentit ose nëse janë faktorët gjenetik ato që luajnë një rol vendimtar në lindjen e agresionit.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis mënyrave të sjelljeve agresive që shfaqin shumica e njerëzve të shëndetshëm psikologjikisht me ato që shfaqin shumica e njerëzve me çrregullime psikologjike. E parë në mënyrë të përgjithshme sjellja agresive fizike shfaqet tek shumica e fëmijëve (në rreth 80% të tyre) në moshën e fëmijërisë së hershme, por më pas kalon në normalitet. Deri në moshën 2 vjeçare këto sjellje agresive fizike zvogëlohen vazhdimisht. Vetëm një grup i vogël fëmijësh shfaqin sjellje agresive të qëndrueshme dhe klinike, d.m.th. sjellje agresive të cilat janë të qëndrueshme në situata të ndryshme dhe në një hark kohor të gjatë dhe që shfaqen me një intensitet të caktuar, me dëmtime domethënëse psiko - sociale dhe një sërë simptomash të tjera karakteristike (Loeber dhe të tjerë, 1990).

Loeber - i (Lloubër) (1990) e sheh zhvillimin e sjelljes agresive të qëndrueshme klinike si progresion fazash, të cilat kalojnë ndër hapa të caktuara që prej shtatzanisë deri në adoleshencë. Modeli i tij itinerar i zhvillimit përshkuan pasoja të mundshme të zhvillimit duke marrë në konsideratë kushtet e shumëllojshme të rrezikut të lartë të lidhur me mënyrat e sjelljes agresive. Merren parasysh dhe lidhjet midis koncepteve bazë të ndryshme psikopatologjike me ato të zhvillimit psikologjik si mosha (në manifestimin e parë të sjelljes agresive), periudhat kritike të rritjes, detyra domethënëse të zhvillimit, „vështirësitë“ në sjellje dhe deficietet neuropsikologjike (Loeber dhe të tjerë, 1990).

Në shfaqjen e sjelljes agresive një rol mjaft të rëndësishëm luajnë dhe faktorët riskues dhe mbrojtës. Konceptet faktorë risku dhe mbrojtës rrjedhin nga psikopatologjia e zhvillimit. Ato mbështetet në bazat biopsikosociale, d.m.th. e kupton zhvillimin e përshtatshëm dhe atë të papërshtatshëm si rezultat i ndikimit të ndërsjelltë të mekanizmave biologjik, proceseve psikikë dhe ndikimeve sociale. Faktorët riskues dhe veçanërisht ato mbrojtës kuptohen rrjedhimisht si kushte biologjikë, psikikë dhe social, të cilët favorizojnë zhvillimin e papërshtatshëm dhe veçanërisht mbështesin një zhvillim të shëndetshëm (Loeber dhe të tjerë, 1990).

Janë identifikuar faktorë të ndryshëm riskues, të cilët favorizojnë zhvillimin e sjelljes agresive. Këtu përfshihen faktorët riskues prenatal si p.sh.: duhanpirja e nënës, gjë që mund të rrisë riskun e një dëmtimi neuropsikologjik të fëmijës; ndër të tjera dhe faktorët riskues gjatë lindjes si p.sh. komplikimet gjatë lindjes ose pesha e ulët në lindje dhe faktorët

riskues pas lindjes si p.sh. temperamenti i vështirë i foshnjës. Në moshën parashkollore mund të shfaqen hiperaktiviteti, impulsiviteti dhe/ose çrregullimet e vëmendjes, të cilat shtojnë rrezikun të zhvillojnë tek fëmija sjelljen nxitëse kundërshtuese. Fëmijët me sjellje nxitëse kundërshtuese kanë shpesh probleme me marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe nga këto probleme ato shpesh tërhiqen, dhe si rrjedhojë ato dhe mund të ndjehen të izoluar. Përveç kësaj, kjo ka si pasojë dhe defiçite sociale në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Sjellja agresive e shfaqur shpesh është e lidhur mjaft me defiçitet dhe problemet shkollore. Delikuenca si rrjedhojë shihet si pasojë e defiçiteve të përmendura dhe shfaqet me sjellje të tilla si: neglizhenca deri tek braktisja e shkollës, gënjeshttrat dhe vjedhjet. Ajo mund të shfaqet gjithashtu me rezultate të dobëta shkollore dhe keqpërdorim të drogave. Si një element rëndues shtohet në këtë rast dhe lidhja me adoleshentë të tjerë disocial, gjë që formon një kontekst social, që e ndihmon dhe mbështet sjelljen delikuyente. Proçeset e zhvillimit natyrisht që në mënyrë individuale janë të ndryshëm (Loeber dhe të tjerë, 1990).

Përpyqjet teorike në lidhje me proçesin e të mësuarit kanë dalë në përfundimin se sjelljet agresive janë të mësuar nëpërmjet mekanizmave mësues në përgjithësi që në moshën e fëmijërisë së hershme dhe ato konservohen më tej me kalimin e viteve.

Në themel ekzistojnë katër mekanizma, të cilët mbështeten nga ambjenti social për mësimin dhe konservimin e sjelljeve agresive (Bandura, 1973).

- **Të mësuarit në bazë të një modeli:** Të nxënësit nga vëzhgimi ndodh atëherë kur sjellja e një vëzhguesi ndikohet nga qenia dëshmitar i sjelljes model dhe shpesh nga pasojat e saj (Vasta R, Haith M. dhe Miller S. 2007). Eksperienca e interpretuar nëpërmjet vëzhgimit të një modeli agresiv, i drejtpërdrejtë ose në media. Modelet luajnë një rol të rëndësishëm në shprehjen e agresionit (Bandura, Ross dhe Ross, 1963). Fëmijët që rriten në familje me ndërshtime të ashpra dhe me dhunë familjare kanë më shumë gjasa të ushtrojnë tipe të ndryshme sjelljesh agresive për të zgjidhur problemet e tyre (Patterson, 1997). Një burim shumë real i modeleve agresive gjendet thuajse në çdo shtëpi, television apo media të tjera. Ekspozimi gjatë fëmijërisë ndaj dhunës në media është faktor për sjelljen agresive në moshë të rritur, si për meshkujt, ashtu dhe për femrat (Huesmann, Moise – Titus, Podolski dhe Eron, 2003). Në më shumë se 70% të skenave të dhunës, autori i dhunës nuk pëson

asnjë ndërshkim (Kirsh, 2005). Gjithashtu dhe lojërat e dhunshme në internet janë shkak për mendimet dhe sjelljet agresive të adoleshentëve (Anderson dhe Bushmann, 2001; Kirsh, 2003).

- **Përforcimi pozitiv:** Përforcues pozitiv është pasoja përforcuese që përfshin prezantimin e diçkaje të këndshme që ndjek një sjellje të dhënë (Vasta R, Haith M. dhe Miller S. 2007). Fëmija nëpërmjet sjelljes agresive arrin një qëllim të caktuar. Një nxënës, i cili kryen forma të ndryshme të akteve buliste, nëpërmjet tyre arrin të përfitojë të mira materiale nga bashkënxënësit, arrin të fitojë dhe rrisë reputacionin dhe popullaritetin e tij në shkollë etj..
- **Përforcimi negativ:** Përforcuesi negativ është pasoja përforcuese që përfshin largimin e diçkaje të papëlqyeshme që ndjek një sjellje të dhënë (Vasta R, Haith M. dhe Miller S. 2007). Nëpërmjet sjelljes agresive fëmija arrin të shmangë një situatë të pakëndshme ose një ngjarje kërcënuese. Një nxënës, i cili kryen forma të ndryshme të akteve buliste, nëpërmjet tyre mund të jashtëzojë tek viktimat e akteve buliste gabimet apo fajet e tyre duke shmangur përgjegjësinë që duhet të mbajnë ato vetë.
- **Toleranca ose moskundërshtimi:** Ndaj një sjellje të caktuar të fëmijës nuk mbahet asnjë qëndrim, gjë që nga fëmija interpretohet si miratim i heshtur. Kur një nxënës kryen një sjellje buliste dhe ndaj tij nuk mbahet asnjë qëndrim nga figurat autoritare si mësuesit apo prindërit, apo dhe nga vetë bashkënxënësit, atëherë autori i akteve buliste mendon se sjellja e tij buliste është e pranueshme nga personat e lartpërmendur; si e tillë ai ka bindjen se kjo sjellje është pozitive dhe vazhdon ta kryejë atë dhe në të ardhmen. Salmivalli dhe kolegët e tij (1996) mundën të vërtetonin që dhe thjesht injorimi i kryerjes akteve buliste përforcon sjelljen buliste të autorëve të akteve buliste.

Këto ndikime rrallë shfaqen në mënyrë të izoluar në jetën e përditshme, por ato ndërveprojnë me njëri-tjetrin në një proces reciprok.

E vëzhguar në mënyrë përmbledhëse është e dukshme që faktorët gjenetikë dhe faktorët e ambjentit janë në një marrëdhënie të anasjelltë. Para së gjithash në një model sjelljeje kaq kompleks si agresioni merren parasysh ekzistenca e lidhjeve gjenetike, të cilat në përmasa

të ndryshme rrisin probabilitetin e shfaqjes së sjelljes agresive, kur ekzistojnë gjithashtu dhe kushte të tjera me rrezik të lartë (Blanz, 2003).

2.3.3 Kufizimet nga format e tjera të dhunës.

Kategorizimi i bulizmit si një mënyrë specifike e dhunës dhe një formë e veçantë e agresionit, bën të nevojshëm kufizimin nga format e tjera të dhunës.

Koncepti „Agresion“ përcakton normalisht veprime, pas të cilave qëndron qëllimi i qartë për t'i shkaktuar dëm personit tjetër ose për t'i shkaktuar atij vuajtje (Parke dhe Slaby, 1983). Si rrjedhojë sjellja agresive shkakton lëndim të viktimës.

Megjithatë jo gjithmonë është e sigurt, nëse pas një agresioni qëndron një qëllim i caktuar. Gjithashtu personi agresiv nuk është gjithmonë detyrimisht i vetëdijshëm për pasojat që do të ketë sjellja e tij ndaj personit tjetër. Megjithatë shumica e ngacmuesve e dinë që agresioni i tyre ndikon në mënyrë të pakëndshme, negative ose lënduese (Dodge, 1991).

Një person, i cili është mësuar të sillet dhe të bindë apo mbizotërojë në mënyrë agresive, jo çdo herë ka qëllimin t'i bëjë keq dikujt. Ai sillet ashtu, pa u menduar fare për pasojat që do t'i shkaktojë personit tjetër. Një akt agresioni nuk është detyrimisht rezultat i keqëdashjes, por mund të kryhet në mënyrë të pastër instrumentale. Këtë model e gjejmë dhe tek bulizmi. Këtu qëllimi primar i veprimit agresiv nuk është dëmtimi i drejtpërdrejtë i viktimës, por përmirësimi i vetvetes, d.m.th. sigurimi i disa të mirave ose privilegjeve, ose arritja e një statusi të lartë ose superior në grupin e bashkëmoshatarëve. Gjithashtu mund të konstatohet se çdo formë e bulizmit paraqet një mënyrë të veçantë të agresionit, por jo çdo mënyrë e agresionit është bulizëm (Olweus, 1993.a).

Talljet, grindjet fizike dhe zënkat shfaqen relativisht shpesh mes fëmijëve dhe nuk përcaktohen si episode bulizmi, pasi pjesëmarrësit në këto grindje janë thuajse njësoj të fortë fizikisht dhe psikologjikisht. Konfliktet janë pjesë e jetës së përditshme të fëmijëve dhe ato duhet të kenë mundësinë t'i përballojnë dhe zgjidhin këto konflikte në mënyrën e duhur, të paraqesin, parashatrojnë dhe mbrojnë dhe interesat e tyre. Përjetimi dhe zgjidhja e konflikteve u mundëson gjithashtu fëmijëve të njohin dhe të mësojnë të respektojnë kufijtë e tyre dhe të njerëzve të tjerë. Flitet për bulizëm kur kemi të bëjmë me zotërimin e

konflikteve të vazhdueshme midis palëve të pabarabarta. Bulizmi nuk u ofron fëmijëve mundësi zhvillimi. Konfliktet nuk janë të barabarta me bulizmin dhe bulizmi nga ana tjetër nuk është thjesht një konflikt.

Gjithashtu edhe përlëshjet apo grindjet e përkohshme në formë loje kufizohen nga bulizmi. Në këtë rast bëhet fjalë për një formë tipike dhe të pranueshme të lojës sociale, (“lojë e rrëmujshme”) e cila shërben për matjen e forcës midis miqsh të mirë. Këto përlëshje dhe grindje në formë loje kuptohen si lojë edhe nga vetë fëmijët pjesëmarrës (Humphreys dhe Smith, 1987).

Alsaker -i gjithsesi paralajmëron që përlëshjet në formë loje kryhen gjithashtu dhe në situata bulizmi me qëllim që të ngatërrojnë të rriturit. Kështu p.sh. një agresor mund ta përfshijë një viktimë, pa e pyetur atë, në një përlëshje në formë loje, për t'i lënë të kuptojë një të rrituri se bëhej fjalë për një lojë (Alsaker, 2003).

Tek fëmijët shfaqen mënyra sjelljesh që qëndrojnë midis kufijve të sjelljeve të pranuar dhe të sjelljeve të padurueshme dhe lënduese. Kështu ekzistojnë përlëshje në formë loje që lëkunden midis shakasë dhe seriozitetit, ose bëhen komente të cilat janë të paqarta nëse janë në formën e shakasë apo vërejtjes (Alsaker, 2003).

Argumentet e mësipërme e bëjnë të qartë sa e vështirë mund të jetë, para së gjithash për ata që vëzhgojnë nga jashtë, të bëhet dallimi midis një sjellje të vrazhdët dhe bulizmit.

2.4 Kuadri ligjor në lidhje me të drejtat e fëmijëve

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e përkufizon dhunën si: Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi apo komuniteti, force e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim (OBSh 1999 dhe 2002). Duke marrë në konsideratë format dhe pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të bulizmit, ai konsiderohet një formë dhune, ndaj dhe i gjithë kuadri ligjor në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve vlen dhe për bulizmin.

2.4.1 Akte ndërkombëtare

Të drejtat e fëmijëve dhe veçanërisht respektimi i tyre ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues në mbarë botën. Si i tillë, për ta zbutur dhe parandaluar atë, në

Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948 në nenin 25, paragrafi 2 thuhet: “Të gjithë fëmijët, bashkëshortorë dhe jobashkëshortorë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje sociale. Përveç kësaj, edhe fëmijët janë njerëz, pra të gjitha të drejtat e njeriut vlejné dhe për fëmijët”.

Duke patur parasysh mosrespektimin e të drejtave të fëmijëve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, shpalli më 20.11.1959 “ Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës”, deklaratë e cila u zgjerua më tej më 1979 nëpërmjet Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Të drejtat e fëmijëve në pjesën më të madhe të botës mbrohen bazuar në “Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës”, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20.11.1989. Republika e Shqipërisë e ka nënshkruar Konventën më 26. 01. 1990 dhe e ka ratifikuar atë më 27.02.1992. Konventa ka hyrë në fuqi më 27.02.1992.

Në bazë të “Konventës mbi të drejtat e Fëmijës” fëmijët gëzojnë disa nga të drejtat e mëposhtme:

1. *Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.* Në bazë të nenit 2, shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga rraca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjor.

2. *Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për një edukim të mirë. Prindërit apo edukatorët e tjerë nuk duhet të përdorin dhunë; keqtrajtimi dhe keqpërdorimi është i ndaluar. Gjithashtu fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për një arsim fillestar falas. Përveç kësaj, atyre duhet t’iu mundësohet edhe arsimi i mëtejshëm.* Në bazë të nenit 28, shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës. Shtetet palë marrin gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që

disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

Në bazë të nenit 19 shtetet palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim: a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës; b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara; c) Të rrisë respektin për prindërin e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti. d) Të përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone.

3. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Në bazë të nenit 13 fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për a) respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose për b) mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

4. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga shteti në çfarëdo lloji situatë. Në bazë të nenit 19 shtetet palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja ose mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, trajtimi dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

2.4.2 Legjislacioni i brendshëm

Ligji Nr. 10 347, dt. 04.11.2010 “ Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizmin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën (Neni 1).

Ky ligj ka si qëllim: a) mbrojtjen e veçantë të fëmijës nëpërmjet realizmit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; b) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij; c) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës dhe ç) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe të organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijëve (Neni 2).

Disa nga të drejtat kryesore të fëmijës të saksionuara me këtë ligj janë:

1. *Barazia dhe eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ose të ndërkshimit* për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë etj. (Neni 5);

2. *E drejta për arsimim*. Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij (Neni 16);

3. *E drejta për nivel jetese të përshtatshëm*. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror (Neni 18);

4. *Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës*. Sipas nenit 21 fëmija mbrohet nga çdo formë e ...:

- dhunës fizike dhe psikologjike;
- ndërkshimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues;
- diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes;
- keqtrajtimit dhe braktisjes;
- mospërfilljes dhe neglizhimit;

- shfrytëzimit dhe abuzimit;
- dhunës seksuale.

2.4.3 Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Në bazë të nenit 32, mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

Mekanizmat në nivel qendror janë:

- *Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (KKMDF).* 1) Në bazë të nenit 33, KKMDF - është organ këshillimor ad hoc, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. 2) KKMDF – është kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe përbëhet nga 9 përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile. 3) Përfaqësuesit nga shoqëria civile në KKMDF - është duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës përzgjedh, me një procedurë konkurrimi të hapur, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ia propozon Kryeministrit për anëtarë të KKMDF - je. Në bazë të nenit 34 detyrat e këtij këshilli janë: a) bashkërendon politikat shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shoqërore, arsimore, shëndetësore dhe kulturore; b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës programet kryesore shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre; c) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse; ç) analizon zbatimin e politikave

shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës; d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikisht të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre, kryesisht të atyre që kanë nevojë për mbrojtje emergjente; dh) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

- *Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.* Bazuar në nenin 35 Ministri që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse që ka për këtë qëllim: a) të hartojë politika dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës; b) të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së fëmijës; c) t'i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht, dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga KKMDf - ve; ç) të bashkërendojë punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës; d) të kontrollojë veprimtarinë e ASHMDf - ës dhe të miratojë raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të mbrojtjes së fëmijës; dh) të nxjerrë udhëzime metodologjike për veprimtarinë e njëjësive të të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore; e) të orientojë mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët; ë) të ofrojë mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.10 093, datë 9.3.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile"; f) të bashkërendojë punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të KKMDf – ës.
- *Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.* Bazuar në ligjin Nr 10347 datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", ASHMDf - ës, ka përgjegjësi të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji. Më konkretisht, në

VKM Nr 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, në nenin 3 theksohet se “ASHMDF - ës bashkëpunon me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në nivel bashkie/komune për të garantuar zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet, monitorimit të zbatimit të detyrave të kësaj strukture të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit Nr 10347 datë 4.11.2010 “ Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

ASHMDF - ës ka këto detyra: a) të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit të saj, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të legjislacionit në fuqi në këtë fushë; b) t'i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës; c) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijëve udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore; ç) të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin European në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; d) t'i japë mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; dh) të bashkërendojë punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të KKMDF - ës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së fëmijës; e) të organizojë dhe të bashkërendojë kërkimet shkencore dhe veprimtaritë informuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; ë) të ndërtojë dhe të realizojë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera; f) të ndërtojë mekanizmat e mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si

dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre; g) të unifikojë të dhënat statistikore për çështjet që lidhen me fëmijët, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë në nivel vendor për mbledhjen dhe përpunimin e përgjithshëm të tyre; gj) të realizojë mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për promovimin e respektimit e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; h) t'i paraqesë ministrin që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; i) të zhvillojë dhe të mirëmbajë sistemin e informacionit për: - institucionet e specializuara për fëmijët dhe personat e kontaktit; - organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; - të dhëna të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijës; j) të koordinojë burimet e ndryshme të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve; k) të vendosë gjobë ndaj shkelësve të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij ligji.

Ajo duhet të bashkërendojë veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me Agjencinë, për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të të dhënave të tjera të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

Mekanizmat në nivel vendor janë:

- *Njësia për të drejtat e fëmijës në Këshillin e Qarkut.* NJDF-ës është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e aktorëve për zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijëve në territorin e qarkut, si dhe i raporton ASHMDF -ës mbi situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në qark. NJDF-ës ka një rol të rëndësishëm për të garantuar dhe koordinuar mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, në ato raste kur bashkitë/komunat nuk kanë ngritur NJMF -ës ose nuk kanë kapacitetet për të menaxhuar situata të tilla . Në nenin 38 të ligjit të mësipërm theksohet se “Njësia e të Drejtave të Fëmijëve funksionon brenda

strukturës administrative të Këshillit të Qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale”.

NJDF – ja ka për detyrë: a) të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut; b) të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut; c) të koordinojë funksionimin e grupit multidisciplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut; ç) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile; d) të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark; dh) t'i raportojë Këshillit të Qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut; e) t'i raportojë periodikisht ASHMDF - ë të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark; ë) t'i paraqesë periodikisht ASHMDF - ë informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

- *Njesia për mbrojtjen e fëmijës në bashki.* NJMF - ë funksionojnë brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe kanë për detyrë të identifikojnë dhe menaxhojnë rastet e fëmijëve në rrezik, që ndodhen brenda zonës ku kjo njësi shtrin juridiksionin e saj. Sipas detyrave të përcaktuara në legjislacion, NJMF - ë duhet ta shtrijnë shërbimin e tyre duke filluar që nga shërbimet sensibilizuese e parandaluese e deri tek menaxhimin i rasteve në rrezik.

NJMF - ë bazuar në nenin 39 ka për detyrë: a) të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet "jo në rrezik"; b) të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisciplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës; c) të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës; ç) të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore,

psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës; d) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë/komunës mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë; dh) t'i raportojë periodikisht ASHMDF –ës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës; e) t'i paraqesë periodikisht ASHMDF -ës informacione për situatën e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

Pranë bashkisë/komunës krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës.

- *Grupi Teknik Multidisiplinar*, është një grup *ad hoc* i cili funksionon pranë bashkisë, thirret në bazë të vlerësimit fillestar, drejtohet nga Drejtori/Përgjegjësi i shërbimeve sociale në bashki, dhe ka këtë përbërje: a) punonjës in pranë NJMF -ës në Bashki; b) përfaqësuesin e strukturës së Policisë; c) përfaqësuesin e Shërbimit Social Rajonal; d) përfaqësuesin e Drejtorisë Arsimore Rajonale; e) administratorin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore të bashkisë ku jeton fëmija; f) prindërit/kujdestarët ligjorë/përfaqësuesit ligjorë të fëmijës ose anëtarët e familjes; g) Edukatoren e kopshtit ose mësuesin/en e shkollës të fëmijës; h) koordinatori e psikogëve të Drejtorisë Arsimore Rajonale, psikologun e shkollës; i) specialistët e shëndetit, mjekun e familjes apo një specialist që ka vizituar apo vlerësuar fëmijën; j) koordinatorin për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare në bashki/administratori shoqëror i ngarkuar për çështjet e dhunës; k) çdo specialist që njeh fëmijën ose që mund të flasë për një problem që është shqetësues për fëmijën (avokat, psikolog, punonjës social, specialistë që ofrojnë shërbime të specializuara lidhur me zhvillimin e fëmijës etj.); l) OJF-të që ofrojnë shërbime për fëmijën, ofrues publikë, privatë të shërbimeve sociale; m) fëmijën, bazuar në moshën dhe shkallën e pjekurisë dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

Grupi Teknik Multidisiplinar ka për detyrë: a) të shqyrtojë dhe të vlerësojë propozimet e NJMF - ë, bazuar në vlerësimin fillestar të kryer nga kjo Njësi; b) të analizojë situatën duke diskutuar për mënyrat e ndërhyrjes; c) të diskutojë dhe të miratojë Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës; d) të sigurojë ofrimin dhe koordinimin e shërbimeve mbi bazën e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës; e) të mbledhet në mënyrë periodike dhe të rishikojë Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës, duke ju përshtatur nevojave në ndryshim të fëmijës dhe familjes; f) të miratojë mbylljen e rastit kur vlerëson që fëmija nuk është në rrezik.

Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, për realizmin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.5 Ndarja e roleve në bulizëm

Bulizmi është një fenomen i cili haset në shumë situata sociale, d.m.th. kudo ku njerëzit bashkëjetojnë rregullisht dhe ku viktimat nuk mund t'i largohet ngacmuesit. Në shkollë është në të shumtën e rasteve e pamundur largimi i viktimës nga situatat ngacmuese dhe kërcënuese, ndaj dhe shmangia e plotë e këtij fenomeni është thajse e pamundur.

Fëmijët që përfshihen në bulizëm kanë role të ndryshme dhe ndahen në tre grupe kryesore (Alsaker, 2003).

2.5.1 Autorë (ngacmuesit) janë fëmijët të cilët ngacmojnë dhe torturojnë të tjerët, por nuk përjetojnë asnjë ngacmim apo eksperiencë viktimizuese vetë. Ato perceptohen nga bashkëmoshatarët e tyre si të pëlqyeshëm dhe të fuqishëm. Ato kanë veti udhëheqëse dhe sens humori. Në aspektin e vetëvlerësimit social këto fëmijë ndjehen të kënaqur me vetveten dhe me ndërveprimet me bashkëmoshatarët e tyre. Ato gjithashtu mund të kenë

marrëdhënie pozitive me mësuesit dhe mund të kenë dhe rezultate të larta akademike (Shellard, 2002; Olweus, 1993). Nga eksperiencia e tyre ato kanë konstatuar se veprimet e tyre agresive u kanë sjellë pasoja dhe ato përjetojnë shumë dhunë të cilën e kanë vëzhguar në familje, tek komshijtë dhe/ose në televizor (K.A. Dodge, 1991).

Autorët ngacmojnë veçanërisht ato bashkënxënës, të cilët janë më të vegjël dhe më pak të aftë për t'u vetëmbrojtur. Ato e perceptojnë vetveten si superiorë ndaj bashkënxënësve të tjerë dhe i fajësojnë ato për faktin se janë më të dobët apo ndryshe nga të tjerët. Autorët zihen me bashkënxënësit e tjerë si mënyrë për të shpallur dominimin e tyre dhe njëkohësisht ato mund të përfshijnë dhe miqtë e tyre për të kryer aktet buliste për to. (LREN, 2001).

Shumica e sjelljeve buliste zhvillohen si reagim ndaj faktorëve të shumtë në familje, shkollë dhe brenda grupit të bashkënxënësve. Shpeshtësia dhe ashpërsia e bulizmit janë të lidhura me mungesën e mbikëqyrjes së të rriturve në shtëpi. Studimet tregojnë se autorët vijnë nga familje ku ushtrohet ndërkim fizik dhe ku fëmijët mësohen të reagojnë në të njëjtën mënyrë për të zgjidhur problemet, si dhe nga familje ku mungon përfshirja dhe ngrohtësia prindërore (Cohn dhe Canter, 2003).

Ross - i (2002) i ndan autorët në dy kategori të ndryshme: **autorë agresivë dhe autorë ankthioz.**

- Autorët agresivë kanë tendencën të jenë më të fuqishëm se mesatarja e bashkëmoshatarëve të tyre, aktivë dhe impulsiv. Ato përdorin sjellje ose qëndrime kërcënuese, mund të provokohen lehtësisht dhe mbajnë qëndrim pozitiv ndaj dhunës. Ato e përjetojnë botën e tyre nëpërmjet ndjenjave dhe mendimeve paranoide, janë mjaft të aftë në shmangien e fajit dhe nuk ndjejnë empati për viktimat e tyre dhe as brerje ndërgjegjeje për veprimet e tyre. Ato gëzojnë popullaritet në rrethin shoqëror dhe kanë nivel të lartë vetëvlerësimi.
- Autorët ankthioz kanë mungesë besimi, vetëvlerësim të ulët dhe pak miq. Ato shfaqin shpesh emocione të pakontrolluara të tilla si shpërthime inati. Për shkak të vetëvlerësimit të tyre të ulët dhe dëshirës për të patur më shumë miq, ato janë shpesh ndjekës besnik të autorëve agresiv. Autorët ankthioz shpesh bashkohen në

incidente buliste, të cilat i ka nisur autori agresiv dhe merr përsipër dhe fajin për të provuar besnikërinë.

- Ekziston dhe një grup tjetër autorësh, që përcaktohet dhe si nëngrup i grupit të autorëve agresivë. Ato janë të ftohtë dhe manipulues. Ato janë ekspertë në situata sociale, duke përdorur metoda jo të drejtpërdrejta ndërveprimi me grupin tjetër të autorëve ndjekës duke ia lënë atyre të kryejnë aktet buliste dhe vetë dalin të pafajshëm. Ky grup mund të shfaqë sjellje ekstreme antisociale dhe nuk u frikësohen pasojave negative.

2.5.2 Viktima janë ato fëmijë të cilët ngacmohen dhe torturohen, por nuk kryejnë asnjë veprim ngacmues apo torturues vetë. Viktima të lehta janë ato fëmijë, të cilët nuk bëjnë rezistencë kur bien pre e akteve buliste (Shellard, 2002).

Kërkimet nuk e mbështesin pohimin se disa fëmijë ngacmohen për shkak të pamjes së tyre fizike (p.sh. obeziteti apo mbajtja e syzeve). E vetmja karakteristikë fizike që ka më shumë të ngjarë t'i vendosë fëmijët më në risk të bien pre e akteve buliste është madhësia dhe fuqia fizike e tyre. Shumica e viktimave janë pasivë dhe kanë prirjen të jenë më ankthioz, të pasigurt, të matur, të urtë dhe të ndjeshëm. Ato shpesh duken të dobët dhe lehtësisht të dominueshëm prej personave të tjerë (Banks, 1997; Kreidler, 1996).

Viktimat u sinjalizojnë të tjerëve se ato janë të pasigurt, pasiv dhe se nuk do të kundërpërgjigjen në rast se sulmohen. Si rrjedhojë, autorët përzgjedhin ato që duken të dobët fizikisht dhe emocionalisht. Studimet tregojnë se viktimat vijnë nga familje mbimbrotëse. Gjithashtu dhe stafi i shkollës i mbimbron ato. Si rezultat, ato shpesh nuk janë të aftë të përballojnë vetë situata të ndryshme të vështira. Ato kërkojnë miratim; madje dhe pas bulizmit, disa vazhdojnë të kryejnë përpjekje joproduktive për të ndërvepruar me autorët, të cilët kryejnë akte buliste mbi to (Cohn dhe Canter, 2003).

Viktimat kanë pak ose asnjë mik të ngushtë në shkollë dhe janë të izoluar në aspektin social. Ato mund të përpiqen të qëndrojnë pranë mësuesve ose pranë të rriturve gjatë pushimeve; ato evitojnë tualetet dhe hapësirat e tjera të izoluara, ose kërkojnë leje për të qëndruar në shtëpi, larg shkollës sa më shumë që të jetë e mundur (LREN, 2001; Olweus, 1993).

Sipas Ross (2002) dhe grupi i viktimave mund të ndahet në dy grupe të ndryshme: **viktimat pasive dhe viktimat provokative**.

- Viktimat pasive priren të jenë të ndjeshëm emocionalisht dhe të kenë vetëvlerësim të ulët. Gjithashtu ato kanë tendencën të jenë më të vegjël dhe më të dobët fizikisht sesa nxënësit e moshës së tyre. Ato nuk kanë aftësi sociale dhe kanë aftësi të varfëra ndërpersonale.
- Viktimat provokative janë më të sigurt, më vetëbesues dhe më aktiv sesa viktimat pasive dhe ato e zgjasin grindjen edhe kur e kuptojnë se po e humbasin atë. Ato përshkruhen si të paqëndrueshëm, shpërthyes, agresivë dhe krijojnë probleme të menaxhimit të situatave në shkollë. Ato kanë pak miq për faktin sepse u mungojnë aftësitë sociale.

2.5.3 Autorë – Viktima janë fëmijët të cilët jo vetëm ngacmohen dhe torturohen nga të tjerët, por edhe ngacmojnë dhe torturojnë të tjerët. Ato janë fëmijë me temperament “shpërthyes” dhe shfaqin në provokacionin më të vogël inat dhe sjellje agresive. Këto tipare çojnë që ato të jenë në grupin e bashkëmoshatarëve si autorë dhe si viktima të bulizmit. Ato kanë karakteristika si të autorëve dhe viktimave, në varësi të rrethanave në të cilat gjenden dhe kalojnë nga njëra kategori në tjetrën disa herë në ditë (Holt, Finkelhor dhe Kaufman Kantor, 2007). Anëtarët e këtij grupi kanë tendencën të jenë hiperaktivë dhe impulsiv dhe kanë mungesë të aftësive sociale. Shpesh ato kanë pak miq për shkak të mos qenit i ndërgjegjshëm për sjelljet e tyre. Ato ndjejnë pasojat negative të të qenit autor dhe viktimë në të njejtën kohe dhe është grupi më shumë i izoluar.

3.5.4 Përkrahës ose autorë pasiv: Olweus - i (1996) ka identifikuar më tej dhe një grup tjetër, të cilin e përkufizon si përkrahës ose autorë pasiv. Këtu përfshihen fëmijët, të cilët ndihmojnë ndonjëherë gjatë ngacmimit, por që vetë personalisht nuk do ta kishin marrë kurrë iniciativën për të ngacmuar dhe torturuar të tjerët. Një grup tjetër studiuesish e kanë analizuar më tej këtë grup dhe i kanë ndarë fëmijët në: asistentë, d.m.th. fëmijë që i ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë autorët apo ngacmuesit dhe në përforcues të ngacmimit apo akteve buliste, d.m.th. fëmijë që qëndrojnë pasiv dhe që tregojnë qartë

përkrahjen p.sh. nëpërmjet të parit dhe të qeshurit (C. Salmivalli, C., K. Lagerspetz, K. Björkqvist, K. Östermann, dhe A. Kaukiainen, 1996).

I njëjti grup studiuesish identifikoi më tej një grup tjetër, që e përkufizoi si mbrojtës dhe ndihmues të viktimës. Këto përpiqen të ngushëllojnë dhe ndonjëherë dhe t'i japin fund bulizmit, dhe pse në të shumtën e rasteve nuk janë të suksesshëm.

Si përfundim ekziston dhe një grup i madh i mospjesëmarrësve ose atyre që qëndrojnë neutral. Këtu përfshihen fëmijët që as nuk i ngacmojnë apo torturojnë të tjerët, as nuk pësojnë ngacmim dhe të cilët nuk përfshihen aspak në asnjë lloj mënyre në këto episode bulizmi apo torturimi por preferojnë t'i shmangin dhe t'i injorojnë ato (Alsaker, 2003).

2.6 Format e shfaqjes së bulizmit

Në përgjithësi veprimet agresive ndaj të tjerëve ndahen në forma fizike, verbale dhe joverbale si dhe në forma të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

Me veprime të drejtpërdrejta agresive kuptohen të gjitha ato veprime ku ngacmuesi dhe viktimat konfrontohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëri – tjetrin. Tek veprimet jo të drejtpërdrejta agresive nuk kemi konfrontim, gjë që është dhe një përparësi për agresorin, pasi shmanget rezistenca e menjëhershme e viktimës (Xie, Cairns dhe Cairns, 2005).

Bulizmi mund të ndodhë ndodhë në forma të ndryshme. Roland dhe Munthe – i (1989) konstatuan se bulizmi mund të përfshijë sulm fizik, verbal dhe psikologjik. Viktimat e bulizmit mund të përjetojnë sjellje të tilla si goditje, shtyrje, sharje, përhapje thashethemesh rreth tyre, manipulim i rrethit të shoqërisë, të qenit i përjashtuar apo i injoruar dhe të qenit i kërcënuar nga nxënës të cilët janë më të mëdhenj, më të fortë dhe më të pushtetshëm (Dulmus dhe Sowers, 2004).

Sipas Anderson –it (Enderson –it) (2007) mund të përcaktohen nëntipe të ndryshme të bulizmit nëse merret në konsideratë mënyra sesi ato drejtohen drejt viktimave. Ekzistojnë dy kategori për përshkrimin e akteve buliste: bulizmi i drejtpërdrejtë dhe bulizmi jo i drejtpërdrejtë. Sulmet e hapura dhe ballë për ballë kundrejt viktimës konsiderohen si forma të drejtpërdrejta të bulizmit. Format jo të drejtpërdrejta të bulizmit përshkruhen si më “dinake” dhe rrallë herë kryhen ballë për ballë (Boulton, Trueman dhe Flemington, 2002).

Lee (Li) (2004) shtoi se format jo të drejtpërdrejta të bulizmit zakonisht përfshijnë në bulizëm dhe palë të treta. Kjo formë e bulizmit mund të përfshijë sjellje si izolimi social dhe përjashtimi nga grupi (Boulton dhe të tjerë, 2002). Disa akte buliste mund të përfshihen vetëm në një nga dy format e lartpërmendura, ndërkohë që disa të tjera mund të përfshihen në të dyja grupet.

Në studimin aktual të bulizmit do të preken dhe dallimet midis formave të ndryshme të bulizmit.

2.6.1 Forma të drejtpërdrejta të bulizmit

Format të drejtpërdrejta të bulizmit mund të ndahen në bulizëm fizik dhe verbal (Alsaker, 2003). Bulizmi fizik midis nxënësve varion nga veprimet relativisht të padëmshme, veprimet e dhembshme dhe deri tek ato kërcënuese për jetën.

Alsaker - i (2003) nënrendit në format e drejtpërdrejta fizike të bulizmit të gjitha prekjet trupore, të cilat janë të padëshirueshme nga fëmija që preket dhe shton këtu dhe shembuj të tjerë si p.sh. kapja apo shtrëngimi fort kundër dëshirës, mbyllja në një dollap apo dhomë, dhënia me zor për të pirë apo ngënë e diçkaje që personi e ka neveri.

Rezultatet e kërkimeve tregojnë gjithashtu që format fizike të bulizmit shfaqen më rrallë në shkollë, sesa ato verbale, joverbale dhe jo të drejtpërdrejta (Alsaker dhe Brunner, 1999).

Si forma më e shpeshtë në disa studime identifikohet bulizmi verbal, d.m.th. thënia e shprehjeve të neveritshme, të ashpra apo të pahijshme dhe banale. Sipas Krappman qeshjet, britmat, përcaktimet apo komentet denigruese, demaskimi (p.sh. të treguarit bashkëmoshatarëve për dobësitë që një fëmijë mund të ketë, bërja e kritikave degraduese, ofrimi i ndihmës për ta bërë tjetrin të ndihet i paaftë) dhe kombinimi i të gjitha këtyre janë format më të shpeshta të bulizmit verbal (Krappman, 1994).

Kanosja dhe kërcënimi shfaqen gjithashtu shpesh dhe në këtë kategori ato marrin një pozicion mjaft të veçantë, pasi ato shpesh përmbajnë nënkuptime apo luajnë një rol në bulizmin e mëtejshëm fizik (Alsaker, 2003).

2.6.2 Forma jo të drejtpërdrejta të bulizmit

Bulizmi jo i drejtpërdrejtë është shpesh më i fshehur dhe më dinak. Në pamje të jashtme ai të lë përshtypjen se nuk përmban sjellje me qëllim dëmtimi. Ndonjëherë në të tilla raste përdoren dhe fëmijët e tjerë si mjete për realizimin e qëllimit të dëmtimit. Në format jo të drejtpërdrejta të bulizmit përfshihen p.sh.: mënyra sjelljeje si përjashtimi nga grupi, përhapja e thashethemeve ose injorimi.

Sjelljet buliste jo të drejtpërdrejta kategorizohen në tre kategori: agresioni relacional, bulizmi verbal dhe bulizmi racist (Alsaker, 2003).

- **Agresioni relacional** përfshin manipulimin social si përjashtimi i të tjerëve nga grupi, përhapja e thashethemeve, thyerja e besimeve midis bashkënxënësve dhe ndikimi për mospëlqimin e nxënësve të caktuar. (Harris dhe Hathorn, 2006). Me manipulim social kuptohen të gjitha veprimet, që shkaktojnë keqësimin e situatës sociale të një personi, veçanërisht këtu theksohet izolimi apo përjashtimi i personit nga grupi i bashkëmoshatarëve. Kjo p.sh. mund të arrihet nëpërmjet përhapjes së thashethemeve. Në agresionin e lidhjeve miqësore tentohet të shkatërrohen marrëdhëniet, që janë mjaft të rëndësishme për personin, p.sh. rasti kur i flet shumë keq një vajze për një shokun e saj (Crick, Casas dhe Mosher 1997)
- **Agresioni verbal** është forma më e përdorshme dhe më e zakonshme. Bulizmi verbal ndodh kur dikush përdor gjuhën për të fituar pushtet dhe fuqi mbi nxënës të caktuar. (Harris dhe Hathorn, 2006).
- **Bulizmi racist** përkufizohet si çdo incident i perceptuar si racist nga viktimi ose nga personat e tjerë (MacPherson, 1999).

2.6.3 Format e bulizmit bazuar në pyetësin e bulizmit të Olweus -it

Duke u bazuar dhe në pyetësin e bulizmit të Olweus -it nëntë format më të përhapura me anë të cilave kryhen aktet buliste janë si më poshtë vijojnë:

1. **Bulizmi verbal** duke përfshirë komentet poshtëruese ose nofkat keqdashëse. Sjelljet më të zakonshme në këtë tip bulizmi janë:
 - Thirrja e dikujt me emra të pisët;
 - Sharjet;

- Kritikat;
- Kërcënimet;
- Mallkimet;
- Përhapja e thashethemeve;
- Kryerja e telefonatave të vazhdueshme kërcënuese apo tallëse;
- Shkrimi i shënimeve ofenduese apo shaka rreth fesë, gjinisë, orientimit seksual, etnisë, statusit social – ekonomik apo pamjet së jashtme të nxënësve të caktuar;
- Përdorimi i sarkazmës.

2. Bulizmi nëpërmjet përjashtimit social ose izolimit. Sjelljet më të zakonshme në këtë tip bulizmi janë:

- Të folurit keq rreth nxënësve të tjerë;
- Përhapja e thashethemeve;
- Thyerja e besimit ose shpërndarja e sekreteve;
- Krijimi i aleancave midis grupeve shoqërore;
- Shakatë negative dhe talljet e nxënësve të tjerë për shkak të pamjes së tyre të jashtme apo mënyrës si ato vishen;
- Përjashtimi dhe izolimi i të tjerëve;
- Lënia e mesazheve lënduese dhe keqdashëse në celular, në bankë apo në dhomat e zhveshjeve në palestër;
- Ngacmimi i të tjerëve nëpërmjet shikimeve tallëse apo kërcënuese;
- Përdorimi i gjuhës së trupit negative si p.sh. përqeshja;
- Inkurajimi i nxënësve të tjerë për të injoruar apo përjashtuar nxënës të caktuar.

3. Bulizmi fizik i tillë si goditjet, shtyrjet, përleshje, goditjet dhe pështyrjet. Sjelljet më të zakonshme të bulizmit fizik janë:

- Gjuajtjet;
- Shkelmimet;
- Shkulja e flokëve;

- Përdorimi i thikave apo i armëve të tjera;
 - Veprimet e rrezikshme dhe plagosëse si goditja me sende të ndryshme (p.sh. shkop, gur, rraketë tenisi);
 - Hedhja e një fëmije nga shkallët.
- 4. Bulizmi nëpërmjet gënjeshtreve dhe përhapja e thashethemeve të pavërteta.**
- Të folurit keq rreth nxënësve të tjerë;
 - Përhapja e thashethemeve;
 - Përdorimi i kodeve për të folur për të tjerët.
- 5. Dëmtimi apo përvetësimi i parave apo i sendeve të tjera personale të viktimës.**
- Goditja e dikujt me qëllim përvetësimin e parave apo sendeve të tjera;
 - Fshehja e sendeve personale;
 - Marrja hua e parave apo diçkaje tjetër dhe moskthimi i tyre për shkak të frikës që ka viktimja t'i kërkojë;
 - Kërcënimi i dikujt, qoftë dhe verbal dhe më pas marrja me dhunë e parave, celularit, tabletit, MP 3-it etj.
- 6. Kërcënimi apo detyrimi me forcë i kryerjes së sjelljeve të ndryshme nga ana e viktimës.**
- Detyrimi i një nxënësi për të kryer veprime pa dëshirën apo iniciativën e tij individuale;
 - Manipulimi emocional dhe imponimi agresiv i viktimës për të kryer sjellje në dobi të autorit apo në dobi të një viktime tjetër.
- 7. Bulizmi racor.** Ndaj nxënësve të caktuar kryhen akte buliste për shkak të racës apo kulturës së tyre. Këto incidente mund të përfshijnë:
- Abuzim racist;
 - Kërcënime apo sulme raciste;
 - Të veshurit e simboleve provokative;
 - Sjellja e revistave apo fletushkave humoristike raciste;

- Nxitja e sjelljeve raciste.
- 8. Bulizmi seksual.** Ndaj nxënësve të caktuar kryhen sjellje buliste për shkak të gjinisë dhe orientimit seksual. Çdo sjellje e cila përmban mesazhe seksuale dhe që ka si qëllim ta dëmtojë personin tjetër konsiderohet sjellje buliste seksuale. Qëllimi i bulizmit seksual është të poshtërojë, të vërë në siklet apo ta përulë personin tjetër bazuar në gjininë dhe orientimin e tij seksual (Olsen, 2006). Ndër sjelljet më të zakonshme përmenden:
- Komentet seksuale;
 - Thënia e shakave seksuale rreth dikujt;
 - Krijimi i profileve të rreme për dikë në media të ndryshme elektronike dhe postimi i komenteve dhe statuseve të rreme me nuancë seksuale;
 - Thirrja e dikujt me emra me nuanca seksuale;
 - Kryerja e gjeveve seksuale të cilët sugjerojnë akte seksuale;
 - Përhapja e imazheve, videove të një personi me përbërje seksuale;
 - Prekje, ledhatime të padëshirueshme në zona intime.
- 9. Bulizmi kibernetik (nëpërmjet celularit apo internetit).** Ai kryhet në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit me anë të postës elektronike, dhomave të chat-it dhe mediave të ndryshme sociale si Facebook, Instagram etj. Autorët e akteve buliste tani mund të shkelin hapësirën personale të viktimave të tyre dhe të dhunojnë ato dhe të drejtat e tyre edhe brenda shtëpive të tyre nëpërmjet celularit apo kompjuterit. Ambjenti i shkollës nuk është më i vetmi vend armiqësor dhe kërcënues; armiqësia dhe kërcënimet e autorëve të akteve buliste tashmë mund të depërtojnë dhe në të vetmin vend të supozuar të sigurt të tyre, në shtëpinë e tyre. Sipas Willard - it (Uillërd-it) (2007) bulizmi kibernetik mund të karakterizohet nga format e ndryshme si më poshtë vijnë:
- Dërgimi i mesazheve vulgare rreth një nxënësi në grup ose vetëm drejt atij nxënësi nëpërmjet postës elektronike ose mesazhit të shkruar në celular;
 - Dërgimi i vazhdueshëm i mesazheve ofenduese një nxënësi;

- Dërgimi i statuseve të rreme ose dëmtuese rreth një nxënësi, nxënësve të tjerë dhe postimi i tyre në mediat sociale;
- Dërgimi apo postimi i materialeve të cilët përmbajnë informacion privat;
- Përfshirja nga grupi i mediave sociale.

Format e ndryshme të bulizmit mund aplikohen njëkohësisht ose në episode të ndryshme kundrejt viktimës. Kështu, për shembull një episod mund të fillojë me një formë të ngacmimit jo të drejtpërdrejtë (p.sh., i ndalon viktimën të luajnë së bashku), vazhdon më tej me forma verbale (p.sh., e tall, e shan, e fyen viktimën) dhe në fund përfundon në forma fizike (p.sh., e shtyn, e godet, i shkul flokët viktimës).

Bulizmi i jep kënaqësi jo vetëm autorëve të ngacmimit, por nganjëherë dhe shikuesve. Shpesh nuk mund ta fshehim të qeshurën kur shohim që një person tjetër po e tallin apo ngacmojnë, dhe kur është e qartë se kjo për viktimën është diçka e pakëndshme dhe e dhimbshme. Argëtimi në kurriz të të tjerëve konstatohet se është një karakteristikë e përhapur njerëzore (M. Titze, 1995). Të tilla episode “qesharake” nuk ndodhin rastësisht gjatë bulizmit, por kryhen qëllimisht nga autorët në këtë mënyrë dhe gjithnjë e më tepër ato janë të lidhura me të njëjtën viktimë.

2.7 Karakteristikat e episodeve të bulizmit

Në pamje të jashtme bulizmi ndodh në forma të ndryshme, por gjithsesi ka disa ngjashmëri midis episodeve të ndryshme të bulizmit, d.m.th. midis situatave në të cilat ndodh bulizmi.

- **1. Poshtërimi:** Një tipar i parë i përbashkët është poshtërimi, d.m.th. dëmtimi i vetëvlerësimit të një personi. Të gjithë autorët e bulizmit, pavarësisht nga mosha e tyre, e përdorin poshtërimin si një strategji bulizmi. Është e paqartë nëse kjo ndodh gjithmonë në mënyrë të vetëdijshme; por gjithsesi funksioni i kësaj metode është unik dhe ka për qëllim, ta zbresë viktimën gradualisht nga hierarkia e grupit të bashkëmoshatarëve deri në rangun më të ulët. Poshtërimi nga të tjerët e klasifikon viktimën si një person të pavlefshëm, kështu që si pasojë ai do të trajtohet dhe si tillë. Nga ana tjetër rezulton se, me kalimin e kohës dhe vetë viktimë e percepton vetveten si një person të pavlefshëm (Alsaker, 2003).

Rezultate të ngjashme kanë nxjerrë edhe Crick (Krik) dhe Bigbee – u (Bigbi) (1998), si dhe Olweus - i (1993). Në bazë të rezultateve të tyre, ato pranojnë që pasqyrimet negative që fëmijët e viktimizuar marrin nga kërcënuesit e tyre, mund të çojnë në një vetëvlerësim negativ, si dhe më pas si pasojë në probleme të përshtatjes. Kështu nëse dëmtohet perceptimi i vetëvlerësimit të përgjithshëm, përvojat e viktimizimit mund të shkaktojnë p.sh. poshtërim të vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët, gjë kjo që çon në rritjen e ankthit tek fëmijët. Në studime të ndryshme vetëvlerësimi i ulët është identifikuar si një faktor domethënës rreziku për zhvillimin e simptomave të ankthit tek fëmijët. Ndërsa vetëvlerësimi i madh është një faktor mbrojtës në lidhje me zhvillimin e ankthit gjatë ngjarjeve kritike të jetës .

- **2. Heshtja ndaj akteve buliste:** Një tjetër tipar i episodeve të bulizmit është heshtja jo vetëm e viktimave dhe autorëve, por gjithashtu dhe e të gjithë pjesëmarrësve në bulizëm, duke përfshirë këtu dhe vëzhguesit e episodeve të tilla. Përveç kësaj, bulizmi rrallë herë diskutohet nga të rriturit, pra nga mësuesit, prindërit apo personat e tjerë kujdestar; dhe në rastet kur diskutohet rreth akteve buliste të ushtruara apo të pësuar, ato shpesh nuk trajtohen me seriozitetin e duhur (Alsaker, 2003). Heshtja e të rriturve, sipas Whitney (Uitni) dhe Smith – it (Smith) (1993), mund të jetë për shkak se më pak se gjysma e fëmijëve të cilët ekspozohen ndaj bulizmit disa herë në javë, e lidhin bulizmin me një mësues. Ndër fëmijët e vegjël, heshtja është në mënyrë të konsiderueshme më pak e pranishme sesa ndër fëmijët më të mëdhenj. Përveç kësaj, vajzat i raportojnë më shumë se djemtë përvojat e tyre si viktima, dhe në përgjithësi raportimi i përvojave viktimizuese gjatë episodeve të bulizmit pakësohet gjithnjë e më tepër.

Viktimat zakonisht heshtin nga frika se mos i shkaktojnë dëm autorëve dhe si rrjedhojë këto të fundit mund të hakmerren për këtë. Kjo frikë nuk është e pajustificuar, pasi autorët e bulizmit i kërcënojnë në të vërtetë viktimat e tyre pikërisht për këtë. Sipas Alsaker - it (2003) një arsye tjetër pse viktimat heshtin, është fakti që ato e keqkuptojnë një mesazh si sulm, gjë që në rastin më të keq, mund të perceptohet si i tillë dhe nga një mësues. Frika e viktimave, se ka shumë të ngjarë që as mësuesit apo prindërit nuk mund ta mbrojnë atë nga shfryrja apo sulmi

i hakmarrjes nga ana e autorëve të bulizmit, është e justifikueshme, pasi atyre më parë nuk u është dhënë besimi i duhur nga ana e personave të rritur, pasi këto të rritur nuk kanë reaguar në mënyrë të hapur dhe nuk kanë treguar gadishmëri për t'u dhënë ndihmë viktimave të bulizmit (D.J Pepler dhe W.N. Craig, 1997).

Në këtë kontekst problematik është fakti se, të dhënat apo përshkrimet e viktimave shpesh nuk e theksojnë seriozitetin e situatës, pasi shumica e episodeve të bulizmit janë relativisht jo aq dramatik në vetvete. Është pikërisht akumulimi apo grumbullimi i përvojave viktimizuese që përbën thelbin e bulizmit (Alsaker, 2003). Kështu p.sh. mund të ndodhë që një fëmijë ndjen se ai nuk merret apo trajtohet seriozisht, nëse disa përvoja të tij viktimizuese trajtohen fillimisht si gjëra të parëndësishme nga të rriturit. Ka shumë të ngjarë që viktima në të ardhmen të mos u tregojë asgjë më shumë personave që e rrethojnë rreth pësimit të akteve të ndryshme buliste. Si rrjedhojë, me kalimin e kohës, viktimat e konsiderojnë situatën e tyre si normale nëse askush nuk ndërmerr diçka për ta ndihmuar atë.

- **3. Mosparashikueshmëria e kryerjes së akteve buliste:** Një viktimgë zakonisht nuk mund ta parashikojë se kur do të përballlet me sulmin e ardhshëm. Kjo e bën atë të paaftë për t'u vetëmbrojtur në mënyrë efektive. Kjo shkakton tek ai lindjen e ndjenjave të pafuqisë dhe të paaftësisë për t'u mbrojtur nga aktet buliste. Në kombinim me mungesën e kontrollit mbi situatën, viktima që ka ndjesinë e pafuqisë dhe të paaftësisë ndjen se në fund të fundit tani ai ka detyrë të rezistojë. Si rrjedhojë e gjithë këtyre ndjenjave në vetvete tek viktima krijohet një rreth vicioz, i cili sofistikohet dhe ashpërsohet gjithnjë e më tepër (Alsaker, 2003).
- **4. Izolimi social i viktimave:** Një tjetër karakteristikë tipike e bulizmit është izolimi social i viktimave. Viktimat janë shpesh të papëlqyeshëm, madje dhe më të papëlqyeshëm se autorët e bulizmit dhe prandaj nuk mund të mbështeten në përkrahjen e shokëve të papërfshirë në bulizëm. Nga rezultatet konstatohet gjithashtu se viktimat nuk kanë asnjë mik ose kanë vetëm pak miq në klasën e tyre. Ky zbulim shpjegon pjesërisht dhe pasivitetin e fëmijëve të papërfshirë në bulizëm ndaj viktimave. Një tjetër arsye e mundshme është se fëmijët e papërfshirë në bulizëm shpesh dhe thjesht nuk e dinë se çfarë duhet të bëjnë në rast bulizmi. Ata

gjithashtu mund t'i frikësohen faktit, se mos bien vetë pre e bulizmit, ndaj për mirëqenien dhe sigurinë e tyre ato distancohen nga viktimat. Disa kanë frikë se mos bëjnë diçka të gabuar dhe si rrjedhojë të shkaktojnë dhe më shumë probleme për viktimat e bulizmit dhe për veten e tyre (H.Cowie, 2000). Ndaj nga bulizmi nuk vuajnë vetëm fëmijët e përfshirë drejtpërdrejt në akte buliste. Të gjithë fëmijët që ndodhen në një klasë ku ekziston problemi i bulizmit vuajnë nga stresi i vazhdueshëm, gjë që shkakton dhe defiçite në vetëvlerësimin dhe në vetërespektin e fëmijëve (Alsaker, 2003).

- **5. Pasiviteti i të rriturve:** Pasiviteti i të rriturve ka dhe më shumë arsye. Kështu shumë prej tyre nuk ndihmojnë në situata bulizmi, pasi situatat në të cilat ndodh bulizmi janë mjaft komplekse. Mësuesit gjithashtu shpesh nuk reagojnë ndaj bulizmit për shkak se ato nuk kanë njohuritë e mjaftueshme lidhur me këtë fenomen. Alsaker -i (2003) si shkaktarë kryesorë të pasivitetit të mësuesve shton dhe frikën, tabutë dhe mungesën e informacionit të hollësishëm në fushën e arsimit si dhe mangësitë në trajnime. Ky qëndrim pasiv i të rriturve, por edhe ai i fëmijëve të tjerë i përforcon autorët ta shohin sjelljen e tyre gjithnjë e më tepër si të pranueshme, ose të paktën ato mësojnë se mund të vazhdojnë të sillen në këtë mënyrë pa u ndërkshuar as nga personat e rritur dhe as nga bashkëmoshatarët e tyre.

2.8 Dallimet gjinore në bulizëm në moshën shkollore

Sipas Atlas (Etlas) dhe Pepler (Peplë) (1998), gjinia është një faktor tjetër individual që lidhet me ndërveprimet buliste. Studimet kanë treguar se gjini të ndryshme ushtrojnë bulizëm në forma të ndryshme. Djemtë mund të shfaqin sjellje agresive që në moshën dy vjeçare. Ndërkohë që ato rriten mund të zhvillojnë tendencën e ushtrimit të sjelljeve agresive si mënyrë për të fituar status, ndërkohë që vajzat nuk e bëjnë këtë në përgjithësi.

Për vajzat, dominimi brenda përbrenda grupin nuk është zakonisht aq e rëndësishme sa krijimi i grupimeve dhe bashkëpunimeve. Si rrjedhojë, vajzat ndjehen fajtores nëse ato ushtrojnë agresion direkt kundrejt një nxënëse/i tjetër. Ato kanë më shumë të ngjarë të përfshihen në bulizëm verbal ose relacional (Jacobs, 2006)

Studimet e Olweus -it (1996) treguan se djemtë në moshë shkollore shfaqeshin më shpesh se vajzat si autorë të bulizmit, por gjithashtu ato njëkohësisht ishin dhe më shpesh viktimë. Veçanërisht në klasat e shtata, të teta dhe të nënta, duket më qartë se djemtë përjetojnë rreth tre herë më shpesh eksperiencë viktimizuese se sa vajzat. Këto rezultate janë në përputhje dhe me ato të studimeve të tjera që konstatojnë se pavarësisht nga forma e bulizmit, djemtë shfaqen më shpesh se vajzat si autorë dhe viktimë të bulizmit (K.M.J. Lagerspetz, K. Björqvist dhe T. Peltonen, 1998; A. O'Moore dhe B. Hillery, 1988).

Një arsye për këto konkluzione, mund të jetë përzgjedhja e instrumenteve matës për zbulimin e bulizmit për shkak se këto instrumenta shpesh regjistrojnë vetëm agresionin "mashkullor", d.m.th. bulizmin fizik dhe jo atë jo të drejtpërdrejtë ose relacional. Duke patur parasysh faktin se vajzat torturohen në mënyrë të tërthortë apo jo të drejtpërdrejtë dhe veçanërisht që ato përdorin ngacmimin relacional, ato shpesh nuk shfaqen si autore, ndërsa djemtë shfaqen si të tillë, gjë kjo që bëhet e dukshme dhe për faktin se djemtë tregojnë më qartë formë të dukshme fizike të agresionit (Alsaker, 2003).

E njëjta gjë vlen edhe për viktimat e bulizmit, për shkak se viktimat identifikohen më lehtë kur ato janë pre e bulizmit të drejtpërdrejtë. Kjo tezë mbështetet dhe nga konkluzionet e studimeve të shumta, sipas të cilave vajzat torturohen si në raporte bulizmi "vetëm nga vajzat", "vetëm nga djemtë" si dhe "nga vajza dhe djem së bashku", ndërkohë që djemtë rrallë herë torturohen "vetëm nga vajzat" (M.J. Boulton dhe K. Underwood, 1992).

Djemtë sillen në mënyrë agresive si kundrejt djemve të tjerë, po ashtu dhe kundrejt vajzave (dhe pse më rrallë). Ndërsa vajzat agresive rrallë herë ngacmojnë apo torturojnë vetëm djemtë. Kështu si rrjedhojë, djemtë agresivë kanë më shumë mundësi të gjejnë viktimë në klasa të përziera, por gjithashtu njëkohësisht ato mund të përjetojnë dhe më shumë marrëdhënie prosociale (Alsaker, 2003).

Gjithsesi dalin në pah konkluzione të tjera kur bëhet një dallim midis formave të bulizmit jo të drejtpërdrejtë - relacional dhe të drejtpërdrejtë - fizik. Djemtë përjetojnë më shpesh formë të hapura - fizike të bulizmit (si autor apo viktimë), vajzat në anën tjetër përjetojnë më shpesh formë të hapura - verbale të bulizmit, ndërsa format jo të drejtpërdrejta - relacionale të bulizmit përjetojnë zakonisht nga të dyja gjinitë njësoj, por

gjithsesi ato kanë gjasa të përjetohen dhe më shpesh prej vajzave (si autore dhe viktima) (A.C. Baldry dhe D.P. Farrington, 1999).

Një shpjegim për këto dallime gjinore mund të qëndrojë në strukturën grupeve të djemve dhe vajzave. Kështu, në kontrast me vajzat, djemtë qëndrojnë në grupe më të mëdha. Bulizmi ndodh më shumë midis dy personave të të njëjtit seks. Kjo gjë rrit mundësinë e shfaqjes së bulizmit të drejtpërdrejtë dhe fizik midis djemve. Bulizmi jo i drejtpërdrejtë social mund të jetë më efektiv në kontekstin social të rretheve të vogla dhe të ngushta të miqve, ku përfshihen dhe vajzat. Gjithashtu në këtë rast përdorimi i bulizmit jo të drejtpërdrejtë - relacional minimizon rrezikun, që viktima të hakmerret në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe që autorët të mund të identifikohen qartë menjëherë dhe si rrjedhojë të dënohen nga personat kompetent apo të autoritetit për sjelljen e tyre agresive. Kjo mbështetet dhe nga studimi i Galen-it (Gellën-it) dhe Underwood-it (Andërud-it)(1997), sipas të cilit vajzat e perceptojnë agresionin social në të njëjtën mënyrë lënduese apo dëmtuese si bulizmin fizik. Nëse një vajzë kryen një ngacmim fizik, ajo shmanget, refuzohet dhe përjashtohet nga rrethi shoqëror i vajzave të tjera. Frika e pasojave të tilla ka shumë të ngjarë të pengojë përdorimin e bulizmit fizik midis vajzave (D.J. Pepler, K.C. Madsen, C. Webster dhe K.S. Levene, 2005).

Alsaker - i (2003) në studimin e tij në një kopësht kishte konstatuar që djemtë në këtë moshë i përdornin më shpesh se vajzat thujtë të gjitha format e ngacmimit (me përjashtim të refuzimit ose përjashtimit, të cilët janë përdorur shpesh në mënyrë të barabartë). Ky konstatim korrespondon me ato nga studime të tjera në lidhje me format jo të drejtpërdrejta të sjelljeve agresive në fëmijët e shkollës fillore (N.R. Crick, D.A. Nelson, J.R. Morales, C. Cullerton-Sen, J.F. Casas dhe Hickmann, 2001).

Alsaker - i (2003) bazuar në konstatimet e tij sugjeron se duhet të tregohet kujdes dhe të kuptohet që vajzat e kompesojnë sjelljen e tyre të pakët fizike agresive me forma të tjera dëmtuese ose torturuese. Bulizmi jo i drejtpërdrejtë është forma, që vajzat përdorin më shpesh kur ato sillen në mënyrë agresive. Në përgjithësi është e qartë që vajzat sillen më rrallë në mënyrë agresive se djemtë. Përveç kësaj, vajzat gjenden më shumë në rolin e mbrojtësve të viktimave se sa djemtë (Salmivalli, Lappalainen & Lagerspetz, 1998).

Konstatimet në lidhje me dallimet gjinore gjatë fenomenit të bulizmit, duke përfshirë apo marrë në konsideratë format e ndryshme të tij, nuk janë në tërësi standarte apo të njëtrajtshme, gjë që i atribuohet kryesisht burimeve të ndryshme të informacioneve dhe ndryshimeve të moshës. Scheithauer – i (Shajthauer-it) (2003), megjithatë, ka identifikuar disa tendenca që duket se mbizotërojnë. Këto tendenca janë:

- Pavarësisht nga gjinia, format e shprehjeve verbale të kërcënimit (p.sh., fyerjet, talljet etj.) janë format më të zakonshme të bulizmit;
- Djemtë e të gjitha grupmoshave përfshihen në mënyrë kostante më shpesh se vajzat në bulizëm kryesisht si autorë, por dhe si viktime;
- Raporti gjinor ndryshon shumë në varësi të përdorimit të formave të ndryshme të bulizmit. Ndryshimet më të mëdha shfaqen tek bulizmi fizik, në të cilin dominojnë dukshëm djemtë, ndërkohë që vajzat i përkasin më së shumti grupit të viktimave të formës së bulizmit relacional, e veçanërisht atij jo të drejtpërdrejtë.

2.9 Ndryshimet moshore në bulizëm në moshën shkollore

Sipas Sullivan –it (Suhlin) (2000) kemi të bëjmë me bulizëm horizontal kur bulizmi ndodh midis nxënësve të të njejtës moshë, ndërsa kur nxënësit më të mëdhenj kryejnë akte buliste mbi ato më të vegjël kemi të bëjmë me bulizëm vertikal.

Bulizmi (si ekperiencat si autorë, ashtu dhe si viktime) pakësohet në shkolla me nxënës në moshë më të rritur dhe gjithashtu kemi dhe rritje të sjelljeve prosociale. Zakonisht konstatohet një ulje e bulizmit, ndërkohë që nxënësit rriten dhe kalojnë në klasa më të larta (Due, P., Holstein, B.E., Lynch, J, Diderichsen, F., Gabhain, S.N., Scheidt, P., dhe Currie, 2005).

Nxënësit në ciklin fillor dhe në atë të mesëm të ulët kanë tendencën të kryejnë më shumë akte buliste, në krahasim me nxënësit e ciklit të mesëm të lartë (Fitzpatrick, K. M., Dulin, A. J., Piko, dhe B. F., 2007).

Bulizmi ka tendencën të arrijë pikun e tij në klasën e 9-të (Peskin, M. F., Tortolero, S. R. dhe Markham, C. M. 2006).

Bulizmi fizik pakësohet me rritjen e moshës, ndërkohë që bulizmi verbal, social dhe ai kibernetik ka tendencën të rritet midis moshës 11 dhe 15 vjeç (Archer, J., dhe Cote, S. 2005), (Espelage, D. L., Meban, S. E., dhe Swearer, S. M. 2004).

Vajzat priren të fillojnë të kryejnë forma sociale të bulizmit në një moshë më të hershme se sa djemtë (Crick, N. R., Nelson, D. A., Morales, J. R., Cullerton-Sen, C., Casas, J. F., dhe Hickman, S. E. 2001). Shtimi i kryerjes së formave buliste sociale, verbale dhe kibernetike mund të ndodhë për shkak të pubertetit, ndryshimeve të shkollës dhe/ose zhvillimit të aftësive sociale, të cilat ofrojnë mundësitë si për ndërveprimet pozitive sociale, ashtu dhe për manipulimin social (Smith, P.K., Madsen, K. C., dhe Moody, J. C. 1999).

Kur pyeten nëse kanë rënë pre e akteve buliste, nxënësit më të vegjël raportojnë nivele më të larta të viktimizimit në krahasim me nxënësit më të mëdhenj. Si rrjedhojë ekziston një ulje në viktimizim ndërkohë që nxënësit rriten. Nxënësit raportojnë pikun e viktimizimit në fund të ciklit të mesëm të ulët, i cili fillon të bjerë ndërkohë që nxënësit shkojnë në ciklin e mesëm të lartë (Fitzpatrick, K. M., Dulin, A. J., Piko, dhe B. F. 2007).

Edhe pse viktimizimi ka tendencën të ulet (veçanërisht format fizike) viktimizimi verbal priret të mbesë në shkallë të lartë gjatë gjithë ciklit të mesëm të lartë (Smith, P.K., Madsen, K. C., dhe Moody, J. C. 1999).

Nxënësit të cilët viktimizohen vetëm nga bashkënxënësit kanë tendencën të jenë më të vegjël sesa nxënësit të cilët janë njëkohësisht dhe autorë dhe viktima (Stein, J. A., Dukes, R. L., dhe Warren, J. I. 2007).

Në përgjithësi, mund të arihet në përfundimin se autorët preferojnë të kërkojnë viktima më të vegjël se ata vetë, gjë që e bën të qartë, se ata zgjedhin viktima, të cilët perceptohen si më pak të rrezikshëm për të bërë rezistencë, ndaj dhe është absolutisht e dukshme se bulizmi është një demonstrim force apo fuqie. Por këtu nuk bëhet fjalë për matjen e forcës personale të autorit, por të matjes së forcës së tij duke e krahasuar me një person më të vogël në moshë dhe të perceptuar që në fillim si më të dobët se vetja (Alsaker, 2003).

Kërkimet gjithsesi sugjerojnë se bulizmi është më i përhapur kur nxënësit fillojnë ciklin e mesëm të ulët, sepse çdo grup i ri është më i rrezikuar të bie pre e bulizmit nga nxënësit më të mëdhenj, të cilët tashmë janë të familjarizuar me shkollën dhe e kanë

përjetuar tashmë procesin e fillimit dhe të pranimit në të (Rigby dhe Slee, 1995). Ky është veçanërisht rasti i djemte. Oyaziwo (2006) konfirmon se djemtë adoleshentë kanë më shumë të ngjarë të bien viktima të bulizmit. Gjithashtu është konstatuar se ndërkohë që autorët e akteve buliste rriten, ato kanë tendencën të shfaqin më pak simpati për viktimat e tyre dhe në kulturat shkollore ku bulizmi është pjesë e statusit, autorët kanë tendencën të dëshirojnë të bëhen dhe më të fuqishëm. Dhe pse të dhënat statistikore tregojnë se bulizmi zbutet me rritjen e klasës, ka gjithashtu raste të raportuara ku bulizmi bëhet më i ashpër në klasa më të larta (Rigby, 1996).

Është konstatuar se numri i nxënësve, të cilët raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste, ka tendencën të ulet me rritjen e moshës (Smith dhe të tjerë, 1999a). Bulizmi është më pak i pranishëm në ciklin e mesëm të ulët, në krahasim me ciklin fillor. Djemtë, në fillim të ciklit të mesëm të ulët, vazhdojnë të kryejnë akte akte buliste me qëllim për të ushtruar dominim në grupin e ri të nxënësve, por mbasi ky dominim është arritur, aktet buliste pakësohen (Pellegrini dhe Long, 2002). Siç e kanë theksuar dhe Smith dhe të tjerë (2001) ky trend do të thotë që lidhja midis bulizmit dhe faktorëve të tij të ndryshëm të riskut është më e fortë dhe më e qëndrueshme në fëmijërinë e hershme. Kjo ndodh për shkak se ndërveprimet e hershme kanë më shumë gjasa të jenë të paqëndrueshëm pasi fëmijët provojnë role të ndryshme, mësojnë aftësi të reja sociale (përfshirë këtu dhe aftësi të tilla si grindjet) dhe zhvillojnë rrjetet e reja të miqësisë. Shumica e fëmijëve ka shumë të ngjarë të kenë pritshmëri për të rënë pre e disa akteve buliste apo e ngacmimit në vitet e tyre të para të shkollës, por ato fëmijë të cilët vazhdojnë të pësojnë akte buliste ka shumë gjasa të kenë dështuar në krijimin e ndërveprimeve të përshtatshme me bashkënxënësit. Gjithashtu, ato nxënës të cilët vazhdojnë të kryejnë akte buliste mbi nxënësit e tjerë, janë ato, të cilët në të kaluarën kanë fituar një status dhe një popullaritet në shkollë për shkak të ushtrimit të akteve buliste.

Rezultatet e studimeve mbi ndryshimet e moshave në fenomenin e bulizmit mund të përmbledhen si më poshtë:

- Bulizmi ndodh që në moshën kur fëmijët frekuentojnë kopshtin;
- Shpeshtësia e dukurisë së bulizmit rritet duke filluar që në vitet e para të ciklit të mesëm të ulët (10 – 15 vjeç). Duke filluar nga shkollat e mesme me rritjen e moshës

reduktohet numri i autorëve dhe viktimave të bulizmit. Pra duke filluar nga moshë 15 – 16 bulizmi në shkollë pakësohet (Fitzpatrick, K. M., Dulin, A. J., Piko, dhe B. F. 2007);

- Periudhat e tranzicionit (të tilla si ajo regjistrimit në shkollë, ndryshimet e shkollës, etj.) janë të një rëndësie të veçantë, sepse ato shpesh kanë si pasojë rritjen e problematikës së bulizmit (A.D. Pellegrini, 1998);
- Bulizmi fizik lidhet më së shumti me moshën. Sa më shumë rriten fëmijët, aq më pak ato përdorin forma të drejtpërdrejta dhe fizike bulizmi. Me rritjen e moshës përdoren më shpesh format relacionale dhe verbale të bulizmit, d.m.th. format e shprehjes së bulizmit me rritjen e moshës bëhen gjithnjë e më tepër të mprehta dhe komplekse (Archer, J., dhe Cote, S. 2005), (Espelage, D. L., Meban, S. E., dhe Swearer, S. M. 2004);
- Gjithashtu njëkohësisht kemi dhe shtim të sjelljeve prosociale. Me rritjen e moshës vihet re rritja e tendencës së shtimit të sjelljeve prosociale (Alsaker, 2003).

2.10 Faktorët riskues dhe faktorët mbrojtës të bulizmit

Hodges (Hoxhis) dhe Perry (Përi) sugjerojnë se ekzistojnë kryesisht tre faktorë social rrisku për pësimin e akteve buliste. Ato janë: të pasurit pak miq; të pasurit miq, të cilët janë të paaftë për të të ndihmuar apo për të të mbrojtur dhe të qenit i refuzuar nga grupi i bashkëmoshatarëve. Kërkimet në Amerikë (Perry dhe të tjerë, 1988) dhe në Angli (Boulton dhe Smith, 1994; Nabuzoka dhe Smith, 1993) tregojnë se viktimat dhe autorët e akteve buliste pëlqehen pak nga bashkënxënësit. Gjithashtu nga këto kërkime është konstatuar se viktimat rrallë herë kanë një shok të ngushtë në shkollë apo një miqësi të ngushtë me dikë (Boulton dhe të tjerë, 1999). Në studimin e fëmijëve anglezë, Boulton (Boulton) dhe Underwood (Undërud), 1992, konstatuan se viktimat e bulizmit kishin raportuar se kishin pak miq dhe se ato kishin më shumë gjasa t'i kalonin pauzat gjatë orëve të vetmuar. Në një studim të kryer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës Kochenderfer (Kokenderfer) dhe Ladd (Led), 1996 konstatuan se viktimat e bulizmit ndjeheshin më shumë të vetmuar në krahasim me nxënësit e tjerë në shkollë. Kochenfelder dhe Ladd, 1997, studiuan më tej dhe karakteristikat e viktimave dhe ato dolën në përfundimin se ato

viktima të bulizmit, të cilët kishin mundur të gjenin një shok, që mund t'i ndihmonte, kishin më shumë mundësi të mos vazhdonin të binin më pre e akteve buliste. Nxënësit, ndaj të cilëve vazhdonin të kryheshin akte buliste, kishin miq, por këto viktime të bulizmit ose nuk ishin të aftë të kërkonin apo të merrnin ndihmë nga miqtë e tyre, ose miqtë e tyre nuk ishin të aftë t'u ofronin ndihmën apo mbështetjen e duhur.

Për të shpjeguar pse fëmijët bëhen autorë ose bien në rolin e viktimës, janë zhvilluar disa orvatje shpjeguese, të cilat bazohen në identifikimin faktorëve riskues dhe faktorët mbrojtës për këto role. Zhvillimi formohet nëpërmjet një bashkëveprim të faktorëve riskues dhe atyre mbrojtës. Krahas karakteristikave individuale të një fëmije, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm, për të kuptuar zhvillimin e sjelljeve agresive duhet të merret parasysh dhe konteksti shoqëror, ku rritet dhe edukohet fëmija. Ndërveprimet në familje dhe me bashkëmoshatarët si dhe në një kontekst më të gjerë konsiderohen si përcaktuesit kryesorë të shoqërizimit.

2.10.1 Faktorët riskues të bulizmit

1. Faktorët riskues lidhur me kontekstin **individual** janë:

- **Faktorë riskues për autorët:**

- ❖ *Komunikimi dhe menaxhimi i papërshtashëm i emocioneve* (Baldry dhe Farrington, 2005; Garner dhe Stowe Hinton, 2010). Shumë nxënës agresivë apo dhe ato të tërhequr kanë aftësi të pakta shoqërizuese. Nxënësit hiperaktivë dhe të pavëmendshëm shpesh nuk i kuptojnë drejt gjestet e shokëve, ose nuk arrijnë të kontrollojnë impulset e tyre. Si rrjedhim, edhe aftësitë e tyre shoqërore janë të dobëta (Coplan, Prakash, O'Neil dhe Armer, 2004; Stormshak, Biermann, Bruschi, Dodge dhe Coie, 1999).
- ❖ *Aftësi të pakta të zgjidhjes së problemeve në situata sociale*. Nxënësit, të cilët nuk zotërojnë aftësitë e duhura për të zgjidhur probleme të ndryshme, me të cilët përballen në jetën e tyre shkollore apo dhe jashtë saj, kanë tendencët t'i zgjidhin këto probleme në mënyrë agresive (Garner dhe Stowe Hinton, 2010).

- ❖ *Gjinia*: Djemtë, në krahasim me vajzat, kanë më shumë të ngjarë të ndërmarrin rolin e autorit dhe autor/viktimës (Jansen dhe të tjerë, 2011).
- ❖ *Të qenit viktimë e akteve buliste*. Nxënësit, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste, për t'i shmangur ato në të ardhmen, kanë tendencën të fillojnë të kryejnë akte buliste mbi nxënësit e tjerë (Barboza dhe të tjerë, 2009).
- ❖ *Mungesa e empatisë*: Autorët e akteve buliste kryesisht nuk janë të aftë të kuptojnë drejt emocionet dhe ndjenjat që përjeton një nxënës tjetër (Barboza dhe të tjerë, 2009).
- ❖ *Vetëvlerësimi i ulët* mund të jetë i lidhur me ndjeshmërinë ndaj presionit të bashkënxënësve (Pepler dhe të tjerë, 2008).
- ❖ *Kompetencat e larta sociale* lejojnë përdorimin e pushtetit për të manipuluar dhe shënjestruar nxënësit në risk të viktimizimit (Pepler dhe të tjerë, 2008a)
- **Faktorë riskues për viktimizim:**
 - ❖ *Reagimi i viktimës përcakton ecurinë e sjelljes buliste*. Reagimet emocionale të cilat janë pasive ose agresive çojnë në vazhdim të sjelljeve buliste (Craig dhe të tjerë, 2007). Disa nxënës janë të prirur të duken të fortë, të tjerët si viktimë. Një nga llojet e viktimave janë ata që kanë prirjen të kenë një vetëvlerësim të ulët për veten dhe ndjehen ankthioz, të vetmuar, të pasigurt dhe jo të lumtur. Këta nxënës shpesh priren të mbyllën në vetvete dhe qajnë shumë lehtë. Kur sulmohen, përgjithësisht ata nuk e mbrojnë veten. Këto viktimë mendojnë se nuk pranohen nga të tjerët, për shkak të të metave që kanë dhe që nuk janë në gjendje t'i korrigjojnë apo t'i kontrollojnë. Ekziston dhe një lloj tjetër viktimash – nxënës shumë emocional dhe gjaknxehtë, të cilët provokojnë reagime agresive nga ana e bashkënxënësve (Pellegrini, Bartini dhe Brooks, 1999).
 - ❖ *Brendësimi i emocioneve dhe sjelljeve përballuese*. Nxënësit, të cilët pësojnë akte buliste kanë tendencën të mos i shprehin emocionet dhe ndjenjat e tyre; ato janë kryesisht tipa introvertë dhe nuk janë të aftë të përballen në mënyrën e përshtatshme me situatat e ndryshme në shkollë dhe jashtë saj (Baldry dhe Farrington, 2007).

2. Faktorët riskues lidhur me kontekstin e **ambjentit rrethues** janë:

- **Klima në shkollë:**

- ❖ *Mungesa e strukturës dhe mbikëqyrje e pakët.* Në ambjentet e shkollës, ku mungon mbikëqyrja e duhur, veçanërisht në vendet në të cilët ushtrohet më shumë bulizmi, ofrohet dhe më shumë mundësia e vazhdimit të ushtrimit të bulizmit (Swearer dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Përqindje e lartë e konflikteve nxënës – nxënës dhe nxënës – mësues.* Në ato shkolla, ku marrëdhëniet midis bashkënxënësve dhe marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësuesëve nuk janë shumë pozitive, nxënësit kanë tendencën të përfshihen më shumë në akte buliste, në krahasim me shkollat ku raporti midis aktorëve të lartpërmendur është më pozitiv (Swearer dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Mosperceptimi i duhur nga ana e mësuesve i bulizmit.* Shpesh mësuesit kur vërejnë sjellje agresive midis bashkënxënësve, nuk u japin atyre rëndësinë e duhur, por i trajtojnë ato si mosmarrëveshje momentale. Fakti që ato nuk perceptohen si sjellje buliste çon në përforcimin jo të drejtpërdrejtë të bulizmit (Raskauskas dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Ndjesia e të mosqenit i lidhur me shkollën.* Nxënësit të cilët nuk e ndjejnë veten pjesë të ambjentit shkollor dhe të procesit mësimor kanë tendencën të jenë gjithashtu indiferent ndaj klimës jo pozitive në shkollë. Atyre nuk u bën përshtypje nëse një bashkënxënës përfshihet në bulizëm (Barboza dhe të tjerë, 2009; Raskauskas dhe të tjerë, 2010).

- **Prindërimi:**

- ❖ *Mungesa e lidhjeve përkujdesëse dhe të ngrohta fëmijë – prind* (Barboza dhe të tjerë, 2009; Swearer dhe të tjerë, 2010). Marrëdhënia emocionale që krijohet midis njerëzve quhet lidhje. Lidhja e parë krijohet midis fëmijës dhe prindërve apo kujdestarëve të tij. Cilësia apo mungesa e kësaj lidhjeje duket se ka ndikim në krijimin e lidhjeve të tjera gjatë gjithë jetës (Thompson dhe Raikes, 2003). Fëmijët të cilët krijojnë lidhje të pasigurta

apo të çorganizuara, ka gjasa të jenë ankthiozë, të frikësuar, të dëshpëruar, të ngjitur, refuzues, agresivë në ndërveprimet e tyre me njerëzit e tjerë (Roeser, Peck dhe Nasir, 2006).

❖ **Rrezik për të kryer akte buliste** (Baldry dhe Farrington, 2005; Barboza dhe të tjerë, 2009):

- ✓ *Përdorimi i stilit prindëror autoritaristë.* Prindërit autoritaristë (pak dashuri, shumë kontroll) paraqiten të ftohtë dhe kontrollues në ndërveprimet e tyre me fëmijët. Fëmijët duhet të sillen si të pjekur dhe të bëjnë çfarë thotë prindi “sepse kështu them unë!” Në këto raste nuk flitet për emocione. Ndërshkimet janë të rrepta, por jo abuzive. Prindërit i duan fëmijët e tyre, por nuk e shfaqin dashurinë. (Woolfolk, A, 2011).
- ✓ *Përdorimi i ndërshkimit ose përdorimi i sjelljeve agresive.* Prindërit të cilët synojnë ta forcojnë apo shuajnë një sjellje të caktuar tek fëmijët e tyre nëpërmjet ushtrimit të sjelljeve agresive, modelojnë tek fëmijët e tyre ushtrimin e sjelljeve agresive nga ana e vetë fëmijëve në të ardhmen në situata në ngjashme (Baldry dhe Farrington, 2005).
- ✓ *Jashtëzimi i konflikteve midis prindërve* duke u përshkallëzuar në ndërveprime dhunuese ose agresive. Shpesh herë të rriturit i shfaqin problemet e tyre dhe mënyrat agresive se si i zgjidhin ato, dhe në sy të fëmijëve të tyre. Fëmijët duke u ballafaquar në familjet e tyre me forma sjelljeje agresive, kanë tendencën t’i ushtrojnë ato mbi bashkëmoshatarët e tyre (Barboza dhe të tjerë, 2009).

❖ **Rrezik për viktimizim** (Baldry dhe Farrington, 2005; Barboza dhe të tjerë, 2009):

- ✓ *Përdorimi i ndërshkimit agresiv.* Fëmijët, ndaj të cilëve është ushtruar ndërshkim agresiv, kanë tendencën të mos bëjnë rezistencë dhe ta pranojnë pësimin e akteve buliste nga bashkënxënësit e tjerë (Baldry dhe Farrington, 2005).

- ✓ *Stil prindërimi tepër lejues.* Prindërit lejues (shumë dashuri, pak kontroll) janë të ngrohtë e të kujdesshëm, por vendosin pak rregulla për fëmijët e tyre. Ato nuk presin që fëmijët e tyre të sillen si të pjekur, sepse në fund të fundit “ fëmijë janë “. (Woolfolk, A, 2011).
- ✓ *Stil prindërimi tepër mbrojtës.* Nxënësit, të cilët janë rritur në mënyrë mbimbrotëse nga prindërit e tyre, vuajnë nga mungesa të aftësive për t’u përballur me situata të vështira sociale jashtë ambjentit të shtëpisë. Si rrjedhojë ato janë më të prirur, të përzgjidhen nga autorët e bulizmit si viktime (Baboza dhe të tjerë, 2009).

- **Marrëdhëniet me bashkënxënësit:**

- ❖ Rrezik për të kryer akte buliste.

- ✓ *Pak marrëdhënie pozitive me bashkënxënësit.* Kur një nxënës nuk është shumë i lidhur emocionalisht dhe kur nuk ndërvepron në mënyrë efektive me bashkënxënësit e tjerë, ai ka tendencën të kryejë akte buliste mbi to ose të pranojë ushtrimin e akteve buliste mbi to (Swearer dhe të tjerë, 2010).
 - ✓ *Numri i rritur i miqve krijon përshtypjen e popullaritetit dhe pozitën e pushtetit.* Nxënësit të cilët kanë më shumë miq në shkollë dhe të cilët perceptohen si të suksesshëm nga bashkënxënësit e tjerë, kanë gjithashtu tendencën të ushtrojnë akte buliste mbi të tjerët, pasi ato e perceptojnë veten e tyre si më të pushtetshmit në rrethin e bashkënxënësve (Barboza dhe të tjerë, 2009).

- ❖ Rrezik për bulizëm

- ✓ *Status i ulët shoqëror dhe stigmatizimi nga bashkënxënësit.* Kur një nxënës rrjedh nga një familje me status social – ekonomik të ulët ai ka tendencën të perceptohet si më i pafuqishëm nga bashkënxënësit e tjerë dhe si rrjedhojë të jetë më vunerabël për të rënë pre e akteve buliste (Balboza dhe të tjerë, 2009).

2.10.2 Faktorët mbrojtës të bulizmit

1. Faktorët mbrojtës lidhur me kontekstin **individual** janë:

- **Faktorët mbrojtës për reduktimin e rrezikut të qenit viktimë:**

- ❖ *Sjelljet prosociale*. Nxënësit të cilët kryejnë sjellje të pëlqyeshme për bashkënxënësit e tjerë kanë tendencën të kenë një rrjet të madh miqsh dhe si i tillë ai nuk është i rrezikuar për të rënë pre e bulizmit. Gjithashtu ato marrin shpesh rolin e liderit në rrethin e tyre shoqëror dhe kjo redukton gjithashtu rrezikun e pësimit të akteve buliste (Raskauskas dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Empatia*. Nxënësit që ndjejnë empati për bashkënxënësit e tjerë kanë gjithashtu tendencën të kenë një rreth të madh miqsh. Ato perceptohen si viktima të vështira nga autorët e bulizmit, pasi në rast rreziku nga bulizmi ato do të mbështeten nga miqtë e tyre dhe si rrjedhojë ato janë të mbrojtur nga bulizmi (Raskauskas dhe të tjerë, 2010).

- **Faktorë mbrojtës për të mos rënë pre e akteve buliste:**

- ❖ *Strategjitë dhe teknikat e zbutjes së konflikteve i pengojnë sjelljet buliste*. Nxënësit të cilët janë të aftë të përballojnë dhe veçanërisht të zbusin konfliktet e mundshme me bashkënxënësit e tjerë në mënyrë sa më paqësore janë gjithashtu më të mbrojtur nga pësimi i bulizmit (Craig dhe të tjerë, 2007).

2. Faktorët mbrojtës lidhur me kontekstin e **ambjentit rrethues** janë:

- **Klima në shkollë:**

- ❖ *Roli i mësuesve për të modeluar sjellje prosociale*. Në ato shkolla ku mësuesit krahas procesit të të mësuarit, i venë një theks të rëndësishëm dhe edukimit qytetar të nxënësve, duke synuar tek ato modelimin e sjelljeve sociale, ka shumë më pak probabilitet që të ushtrohet bulizëm ndër bashkënxënës (Swearer dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Klima pozitive në shkollë zbut pasojat e mundshme negative të përkujdesjes së pakët prindërore* (Swearer dhe të tjerë, 2010). Në rastin e nxënësve të cilët përballen me probleme emocionale apo ndërpersonale, mësuesit janë

shpesh burimi më i mirë i ndihmës. Kur nxënësit vijnë nga përvoja kautike dhe të papritura në shtëpi, ata kanë nevojë për një autoritet që shqetësohet për ta dhe që është i qëndrueshëm. Ata kanë nevojë për mësues që u vënë kufij të qartë, që janë konsistentë, që zbatojnë rregullat me vendosmëri, pa i ndërshtuar, që i respektojnë ata dhe shfaqin interesim të vërtetë për mirëqenien e tyre (Woolfolk, A, 2011).

- ❖ *Ambjentet shkollore të cilat promovojnë shprehje pozitive të vetvetes, bashkëpunim dhe barazi.* Në ato shkolla ku nxënësit ndjehen të vlerësuar, të respektuar, të barabartë dhe bashkëpunues me njëri – tjetrin, nuk e ndjejnë të nevojshme të ushtrojnë bulizëm (Raskauskas dhe të tjerë, 2010).
- ❖ *Ndjesia e të qenit i lidhur me shkollën.* Sa më shumë i lidhur të jetë me shkollën dhe me bashkënxënësit një nxënës, aq më pak i predispozuar është ai për të mos rënë pre e akteve buliste (Raskauskas dhe të tjerë, 2010).

- **Prindërimi:**

- ❖ *Nxitje njohëse maksimale dhe mbështetje emocionale nga ana e prindërve në fëmijërinë e hershme.* Kur një nxënës është mbështetur vazhdimisht emocionalisht nga prindërit e tij, atëherë ai nuk ka tendencë të ndjehet i pashpresë dhe i pambrojtur në situata të ndryshme të vështira. Përkundrazi ai tashmë i zotëron skemat njohëse me anë të të cilave mund të shmangë ose të përballë me aktet buliste (Zimmerman dhe të tjerë, 2005).
- ❖ *Komunikim pozitiv me prindërit.* Kur një nxënës rritet me prindër, të cilët janë të hapur dhe bashkëpunues në komunikim, kanë tendencën të ndajnë me to eksperiencat e bulizmit që mund të kenë përjetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në shkollë, gjë që ndikon mjaft në zbutjen e bulizmit në shkolla (Springgs dhe të tjerë, 2007).
- ❖ *Stil prindëror mbështetës dhe autoritativ.* Kur nxënësit kanë gjetur mbështetje nga prindërit e tyre, ato u tregojnë rreth frikës së mundësisë se mund të bien pre e bulizmit në shkollë, apo se kanë rënë pre e bulizmit në shkollë, pasi ato janë të bindur në vetvete, që prindërit do t'i ndihmojnë në

situata të tilla. Si rrjedhojë ato janë dhe më të mbrojtur ndaj bulizmit (Baldry dhe Farrington, 2005).

2.11 Pasojat e bulizmit

Duke u bazuar në raportin e “Qendrës për studimin e dhe parandalimin e dhunës” ka pasoja afatgjata dhe afatshkurtra si për viktimat dhe autorët, ashtu dhe për tërë klimën e shkollës (Departamenti i Shëndetit dhe i Sherbimeve Sociale, SHBA 2001).

Shumë individë besojnë se bulizmi është pjesë normale e fëmijërisë. Gjithsesi, kërkimet tregojnë se bulizmi mund të ndikojë negativisht tek rezultatet mësimore, si dhe të ketë pasoja negative fizike, sociale, emocionale dhe psikologjike tek të gjithë nxënësit e përfshirë në bulizëm. Bulizmi mund të ndikojë tërë klimën e shkollës.

Pasojat e bulizmit mund të jenë afatshkurtra dhe afatgjata (Banks, 2000). Izolimi dhe përjashtimi që shoqëron shpesh bulizmin, jo vetëm që u mohojnë viktimave të bulizmit shoqërimin, miqësinë dhe ndërveprimet sociale, por gjithashtu shkaktojnë tek ato ndjesinë e të qenit jo kompetent dhe jo tërheqës. Viktimat e bulizmit shpesh kanë vështirësi në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve dhe kanë tendencën të kenë një jetë më pak të suksesshme (Sullivan, 2000). Viktimat e bulizmit mund të ndjehen të mërzhitur, të pakënaqur, të lënduar ose të refuzuar si rezultat i viktimizimit nga ana e bashkënxënësve. Bazuar në komentet e bëra nga viktimat e bulizmit konstatohet se ato shpesh ndjehen keq për veten e tyre. Bulizmi i vazhdueshëm mund të shkatërrojë vetëbesimin e viktimës, mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore dhe madje mund të shkatërrojë karrierën e viktimës. Viktimat gjithashtu mund të përjetojnë dhembje koke, pagjumësi, ankth dhe depresion. Disa prej viktimave madje mund të vuajnë më vonë dhe nga çrregullimi i stresit post-traumatik (Awake, 2003).

Duncan –i (Duncan-i) (1999) konstaton se në krahasim me fëmijët e tjerë, viktimat e bulizmit kanë tendencën të manifestojnë gjendjet vijuese: vetëbesim të ulët, vetëvlerësim të ulët, depresion, ankth, pasiguri, moskompetencë, hipersensibilitet etj.. Ato gjithashtu kanë ndjesinë se janë të pasigurt, nervoz dhe në panik në shkollë (International Journal of Education and Research Vol. 1 No. 8 August 2013 5). Viktimat e bulizmit shpesh sjellin në shtëpi frustrimet e përjetuara në shkollë dhe përballen me prindër, të cilët për fat të keq nuk

janë aspak të ndërgjegjësuar rreth viktimizimit të fëmijëve të tyre në shkollë. Si pasojë prishen dhe marrëdhëniet familjare (Selekman & Vessey, 2004). Sipas Oyaziwo, (2006), pasojat më ekstreme të bulizmit mbi viktimat dhe shoqërinë është dhuna, si në formën e vrasjes, ashtu dhe në formën e vetëvrasjes. Ndjesia e të qenit i pafuqishëm, që përjetohet nga viktimat mund të jetë aq e thellë, sa disa viktimat të bulizmit mund të reagojnë në mënyrë vetëdëmtuese ose në hakmarrje vdekjeprurëse.

2.11.1 Pasojat afatshkurtra

Pasojat afatshkurtra që viktimat e bulizmit përjetojnë shpesh përfshijnë reagime të dhimbshme dhe poshtëruese të cilat çojnë në distres, konfuzion, pakënaqësi të përgjithshme (Burger, 2005). Shumë viktimat të bulizmit gjithashtu mund të përjetojnë humbje të vetërespektit, ankth dhe ndjenja pasigurie. Mungesa e sigurisë zakonisht ndikon negativisht në aftësitë individuale për të mësuar dhe në uljen e nivelin e përqëndrimit. Viktimat e bulizmit shfaqin performancë të ulët dhe marrin nota në ulta në shkollë. Procesi i të nxënësve nuk ndodh në mënyrë automatike tek nxënësit, por kërkon vëmendje dhe përqëndrim; pësimi i akteve buliste apo frika nga pësimi i tyre në shkollë ul mundësinë e të qenit i vëmendshëm dhe i përqëndruar në orën e mësimit. Duke u ndjerë të frikësuar nga pësimi i akteve buliste, nxënësit vendosin si prioritet të parë sigurinë e tyre në shkollë dhe procesi i të nxënësve mbetet prioritet i dytë. Këta individë ndjehen të kërcënuar dhe të pasigurt, si rrjedhojë ato nuk kanë sukses në shkollë dhe shpesh ato sabotojnë procesin e të mësuarit duke munguar shpesh dhe/ose duke mos u aktivizuar gjatë procesit mësimor. Prindërit fillojnë të kritikojnë dhe nxënësit vuajnë njëkohësisht edhe nga frika e pësimit të akteve buliste, edhe nga mosbesimi apo ankesat e prindërve dhe si rrjedhojë gjendja e tyre emocionale dhe psikologjike rëndohet, duke e lënë jashtë trajtimin e problemit të vërtetë, problemin e bulizmit.

Shumë shpesh viktimat zhvillojnë simptoma psikosomatike, të tilla si dhembje koke dhe stomaku, të cilat ndikojnë dhe në aftësitë dhe mundësitë e tyre për të frekuentuar rregullisht shkollën.

2.11.2 Pasojat afatgjata

Efektet afatgjata të sjelljes buliste mbi viktimat janë të shumta. Një prej tyre është vetëvlerësimi i ulët. Ekziston një korrelacion i lartë midis nxënësve të cilët kanë rënë pre e akteve buliste dhe problemeve të shëndetit mendor. Viktimat e bulizmit kanë më shumë tendencë të jenë në risk më të madh për të vuajtur nga depresioni në moshën e rritur se sa nxënësit që nuk kanë rënë pre e akteve buliste. Në rastet më ekstreme ato përfshihen dhe në sjellje kriminale dhe vetëdëmtuese si vetëvrasja (McIntyre, 2003). Vetëvrasja shpesh vjen si rrjedhojë e të ndjerit keq, shumë të dëshpëruar dhe të depresuar, nga ndjesia se nuk kanë askënd pranë për t'i ndihmuar në rast nevojë dhe vetëvrasja duket e vetmja mënyrë me anë të së cilës mund t'i japin fund frikës dhe dhembjes që ndjejnë si pasojë e bulizmit. Vetëvrasja shpesh ndodh disa muaj apo dhe disa vite pas përfshirjes në akte buliste dhe ndodh shpesh në situata ku ka ripërsëritje të vështirësive ekstreme dhe talljeve sociale, gjatë të cilave ndodh relapsi në të njejtën gjendje emocionale si nxënësit janë ndjerë si pasojë e të qenit viktimë e akteve buliste. Mënyra shprehjes së të ndjerit dhe sjellja e viktimave të bulizmit para vetëvrasjes shpesh ndryshon nëse merret në konsideratë gjinia. Nxënëset kanë më shumë prirjen të vrasin në mënyrë të fshehtë vetveten, duke lënë pas shënime dhe mesazhe të cilat faktojnë se sa shumë kanë vuajtur ato prej bulizmit. Nxënësit nga ana tjetër kanë tendencën të vrasin vetveten duke shkaktuar dhe dhunë; ato i mbledhin dhe i shkaktajnë dëm nxënësve të cilët kanë kryer akte buliste mbi to para se të kryejnë aktin e vetëvrasjes.

Gjithashtu nxënësit e përfshirë në akte buliste kanë tendencën të përfshihen më shpesh në sjellje devijante. Ndërsa ato rriten, autorët e akteve buliste janë shumë të riskuar për t'u përfshirë në aktivitete kriminale. Nga një kërkim i kryer në 2013 nga një grup shkencëtarësh i departamentit të drejtësisë kriminale dhe kriminologjisë të universitetit të Karolinës së Veriut dhe i prezantuar nga Turner-i, u dol në përfundimin se 14% e nxënësve të cilët kishin vuajtur nga bulizmi do të kryejnë një vepër kriminale deri në moshën 18 vjeçare (Shoqata Amerikane e Psikologëve, Kongresi vjetor i 121, 2013, Honolulu). Në analizën e tij Turner - i (Tërnër-i) pohon se në krahasim me individët, të cilët nuk kanë qenë viktimat e akteve buliste, viktimat e akteve buliste kishin një përqindje më të madhe të përfshirjes në vepra kriminale. Të qenit viktimë e akteve buliste në një periudhë të caktuar

të fëmijërisë apo adoleshencës lidhet ngushtë me probabilitet të lartë për t'u përfshirë në akte ligjshkelëse, abuzim me substancat, arrestime në periudhën e adoleshencës së vonë dhe në moshën e rritur. Por nxënësit të cilët kanë qenë viktimat të vazhdueshme të bulizmit, si në periudhën e fëmijërisë, ashtu dhe në atë të adoleshencës kanë probabilitetin më të madh për t'u përfshirë në vepra kriminale. Ato janë gjithashtu në risk për të vuajtur nga çrregullimi i abuzimit me substancat, duke krijuar varësi nga alkoli dhe drogat (Turner, 2013).

Ka shumë të ngjarë që si viktimat, ashtu dhe autorët e akteve buliste të kenë probleme në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive si në familje, ashtu dhe në shoqëri. Vetëbesimi është një nga fushat që dëmtohet më së shumti në aspektin emocional. Viktimat e bulizmit shpesh izoloohen shumë nga rrethi i bashkënxënësve, nuk u besojnë bashkënxënësve, msuesve, prindërve dhe personave të tjerë kujdestarë. Kjo ua vështirëson viktimave të bulizmit krijimin e marrëdhënieve dhe punët në grup në të ardhmen. Ato kanë tendencën të jenë antisocial dhe “qen” të punës duke e shmangur sa më shumë të jetë e mundur kontaktin social. Humbja e besimit personal mund të ketë një impakt negativ mjaft të madh në aftësinë e individit për të qenë të sukseshëm në jetë dhe veçanërisht në aftësinë për të gjetur një vend pune të paguar më mirë, në aftësinë për të bërë karrierë dhe për të qenë konkures.

2.12 Impakti i bulizmit mbi shëndetin mendor

Lidhjet midis bulizmit në shkollës dhe shëndetit mendor kanë qenë të njohura prej një kohe të gjatë. Disa nga studimet më të hershme me fokus bulizmin në shkollë kanë treguan se si bulizmi mund të jetë shkak që nxënësit të ndjehen të trishtuar, të tërhequr dhe të shqetësuar; të gjitha këto janë tregues kryesorë të problemeve të shëndetit mendor. Meqë hulumtimi në këtë fushë ka vazhduar të rritet, është bërë e qartë se përfshirja në bulizëm, si në rastin e autorit, ashtu dhe në atë të viktimës mund të ketë një ndikim negativ në të gjitha aspektet e funksionimit mendor të një fëmije.

A janë problemet e shëndetit mendor shkak apo pasojë e bulizmit?

Para se të tentohet të diskutohet rreth kësaj pyetjeje, një faktor kyç që duhet marrë parasysh është drejtimi i shkakësisë: A është bulizmi një faktor, i cili ndikon në lindjen e

problemeve të shëndetit mendor apo a janë fëmijët me probleme të shëndetit mendor, ato fëmijë të cilët kanë më shumë gjasa të përfshihen në bulizëm? Hulumtimet tregojnë se shumë nga simptomat që lidhen me problemet e shëndetit mendor, të tilla si vështirësitë në sjellje ose ato emocionale janë faktorë të rëndësishëm rreziku për përfshirjen në bulizëm. Fëmijët që kanë vetëbesim të ulët, që përjetojnë ndjenja ankthi ose që janë të tërhequr nga shoqëria, dhe ato të cilët kanë probleme të sjelljes, probleme emocionale apo probleme në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët janë në rrezik më të madh për t'u bërë viktimë ose autorë - viktimë të akteve buliste në shkollë. Përveç kësaj, fëmijët që shfaqin vështirësi në sjellje dhe probleme të sjelljes mund të kenë më shumë gjasa të angazhohen në rolin e autorit të akteve buliste. Ndërsa shumë prej këtyre karakteristikave mund të jenë të pranishme para se fëmijët të përfshihen në akte buliste në shkollë, ka edhe dëshmi se përfshirja në bulizëm mund t'i përkeqësojë më tej këto probleme. Dikush që ka rënë pre e akteve buliste për shkak se ai përjeton ndjenja ankthi dhe sepse është i tërhequr nga shoqëria, pasi ka qenë viktimë e bulizmit është bërë dhe më i izoluar dhe i shqetësuar si rezultat i akteve buliste të pësuar.

Dallimi midis problemeve të shëndetit mendor që ekzistojnë para përfshirjes në bulizëm dhe i atyre që kanë lindur vetëm si pasojë e përfshirjes në bulizëm është fokusi i shumë studimeve të fundit, gjë që ndihmon në përcaktimin e dëmit të vërtetë që mund të shkaktojë bulizmi. Në studimet e kohëve të fundit janë analizuar të dhëna gjatësore, të cilat janë krahasuar me të dhënat e mbledhura në një periudhë specifike të mëparshme me qëllim për të evidentuar pasojat e pavarura që ka bulizmi mbi shëndetin mendor. Pasi kontrollohen influencat e jashtme, të cilat mund të ndikojnë shëndetin mendor, të tilla si historia familjare apo situata social – ekonomike familjare, nëpërmjet studimeve gjatësore sot është e mundur të krahasohet shëndeti mendor para dhe pas përfshirjes në bulizëm, duke mundur në këtë mënyrë evidentimin e faktit se sa bulizmi ndikon mbi shëndetin mendor të një personi

Gjetjet kryesore

Në seksionet vijuese, shqyrtohen rezultatet e kërkimeve të fundit gjatësore, të cilat analizojnë problemet e shëndetit mendor, të cilat janë shkakuar si pasojë e përfshirjes në bulizëm në shkollë. Janë evidentuar katër probleme të shëndetit mendor, të cilat shkaktohen si pasojë e përfshirjes në bulizëm, të cilat përkatësisht janë: depresioni, ankthi,

çrregullimet psikotike dhe vetëdëmtimi e vetëvrasja. Secili prej këtyre problemeve të shëndetit mendor mund të ketë një ndikim të madh në mirëqenien psikologjike dhe fizike të fëmijëve, duke ndikuar në mënyrën se si ata e perceptojnë veten dhe të tjerët, se si sillen dhe përshtaten në shtëpi dhe në shkollë dhe se si ndjehen në vetvete, pavarësisht nëse e demostrojnë atë dukshëm, apo jo.

Depresioni

Depresioni është një nga çrregullimet më shumë të diskutuara të shëndetit mendor. Studimet tregojnë se ekziston një rrezik i madh për të vuajtur nga depresioni tek fëmijët, të cilët janë viktimë apo autorë – viktimë të bulizmit në shkollë. Depresioni mund të manifestohet në shumë mënyra të ndryshme dhe disa simptoma tipike të tij janë:

- Të ndjerit i trishtuar ose ndjesi se askush nuk mundet të të ndihmojë;
- Mungesë të energjisë ose entuziazmit;
- Të ndjerit i shqetësuar apo nervoz;
- Vështirësi për t'u përqëndruar
- Vështirësi për të fjetur;
- Të ndjerit i lodhur ose i rraskapitur;
- Tërheqje nga shoqëria;
- Mungesa e oreksit.

Depresioni mund të çojë në një ndryshim të dukshëm në sjelljen e fëmijëve, në braktisjen e shkollës dhe në distancimin nga familja dhe nga miqtë e tyre. Çrregullimi i depresionit madhor ka qenë gjithashtu i lidhur me mendime apo sjellje vetëdëmtuese dhe vetëvrasëse.

Një studim i kohëve të fundit në Mbretërinë e Bashkuar, kampioni i të cilit përbëhej nga mbi 3,692 fëmijë, konstatoi se pas kontrollit për një sërë faktorësh ekzistues të rrezikut, të tilla si psikopatologjia dhe fatkeqësitë familjare, të qenit viktimë e bulizmit në shkollë rrit në një masë të madhe rrezikun, që fëmijët të shfaqin simptoma të depresionit madhor. Për më tepër, u konstatua një marrëdhënie midis të qenit viktimë e bulizmit dhe depresionit; nxënësit, ndaj të cilëve ushtrohej bulizëm në mënyrë të qëndrueshme dhe të shpeshtë, përjetojnë simptoma depresive të rënda dhe të qëndrueshme.

Kohët e fundit, një tjetër studim krahasoi rezultatet e testeve që masin depresionin në moshën 18 vjeçare të një kampioni prej 3,898 të rinjve. Duke marrë në analizë subjektet që kishin rënë pre e akteve buliste ose jo në moshën 13-vjeçare, studiuesit zbuluan se ndër fëmijët të cilët kishin rënë në depresion, 5,5% e subjekteve nuk kishin rënë pre e akteve buliste, ndërkohë që 7.1% e tyre kishin pësuar disa herë akte buliste. Ndër subjektet, të cilët kishin pësuar vazhdimisht akte bulizmi, 14.8% e tyre kishin rënë në depresion në moshën 18 vjeçare; duke përfaqësuar në këtë mënyrë një rritje mbi dyfish në gjasat e zhvillimit të depresionit klinik.

Nëpërmjet një meta-analize të 28 studimeve gjatësore, krahas evidentimit të faktit se efektet e bulizmit mbi depresionin mund të jenë afatgjata, u arrit gjithashtu në përfundimin se përvoja e të rënit pre e akteve buliste në fëmijëri ishte një faktor rreziku unik dhe i rëndësishëm për depresion gjatë adoleshencës dhe moshës madhore, edhe në ato raste kur kanë qenë në kontroll një numër i madh faktorësh aktual të rrezikut, ose qoftë dhe të dikurshëm .

Edhe pse disa studime kanë sugjeruar që fëmijët, të cilët ushtrojnë akte buliste mbi të tjerët, mund të përjetojnë disa simptoma depressive, në tërësi, hulumtimi arrin në konkluzionin se ekziston një korrelacion i dobët midis të qenit autor i akteve buliste dhe shfaqjes së simptomave të depresionit.

Ankthi

Shpesh i hasur dhe në kombinim me depresionin, ankthi është një tjetër pasojë e zakonshme e bulizmit në shkollë, veçanërisht i pranishëm tek nxënësit që janë viktimë ose autorë - viktimë të bulizmit në shkollë. Si rrjedhojë e ankthit të përjetuar nxënësit ndjehen vazhdimisht të shqetësuar për shumë aspekte të jetës së tyre të përditshme dhe disa nga simptomat tipike mund të përfshijnë:

- Shqetësim i tepruar;
- Ndjenja paniku;
- Djersitje, dridhje ose gulçim;
- Përzierje;
- Rrahje të forta zemre;
- Çrregullime gjumi;

- Vështirësi në përqëndrim.

Përveç kësaj, ankthi i rëndë kur mbetet i patrajtuar mund të përkeqësohet më tej, duke bërë që nxënësit të vuajnë dhe nga çrregullime të ndryshme të ankthit si:

- Sulme paniku;
- Fobitë sociale duke përfshirë agorafobinë (frika nga hapësira të hapura ose publike);
- Çrregullim obsesiv-kompulsiv;
- Çrregullim të stresit post – traumatik.

Simptomat e ankthit mund të kenë një ndikim të thellë në cilësinë e integritetit dhe të performancës së nxënësve në shkollë. Simptomat e ankthit, përveç se shkaktojnë vështirësi në formimin dhe ruajtjen e miqësive, shkaktojnë dhe diskriminim të nxënësve, për shkak se si rezultat i shfaqjes së disa prej këtyre simptomave, nxënësit shfaqen të ndryshëm nga bashkënxënësit e tjerë, gjë që i bën ato dhe më të riskuar për të rënë pre e akteve buliste.

Bazuar në shumë studime ndër – seksionale arrihet në konkluzionin se viktimat e bulizmit shfaqin rezultate më të larta në testet e ankthit në krahasim me nxënësit, të cilët nuk kanë pësuar bulizëm. Për shembull, një sondazh i mbi 2,700 nxënësve të shkollave holandeze, të moshës 9 - 12 vjeç, zbuloi se 28% e viktimave dhe 23% e autorëve - viktimat të bulizmit raportuan se përjetonin ankth, dhe 10% të nxënësve që përjetonin ankth nuk ishin viktimat të bulizmit. Përveç kësaj, vetëm 10% e nxënësve autorë të bulizmit raportuan se përjetonin ankth, duke sugjeruar se ankthi nuk shkaktohet nga ushtrimi i akteve buliste.

Studimet gjatësore konfirmojnë lidhjen ndërmjet viktimizimit dhe ankthit. Një studim i 1,420 pjesëmarrësve, i cili pati në fokus të tij analizimin e problemeve ekzistuese psikiatrike të fëmijërisë dhe vështirësitë familjare, zbuloi se viktimat e bulizmit në shkollë rrezikonin shumë të vuanin nga ankthi i përgjithësuar, çrregullimi i panikut dhe agorafobia në moshën e rritur të hershme, ndërsa autorët - viktimat të bulizmit kishin më shumë gjasa të përjetonin çrregullim paniku dhe, vetëm femrat përjetonin agorafobi.

Një tjetër studim gjatësor i 3,629 adoleshentëve të Mbretërisë së Bashkuar krahasoi rezultatet e ankthit të nxënësve në moshën 18 vjeçare me përvojat e të qenit viktimë e bulizmit në moshën 13 vjeçare. Ndër ato nxënës, të cilët nuk kishin qenë viktimat të bulizmit, vetëm 6% e tyre kishin përjetuar ndonjë formë të çrregullimit të ankthit në

moshën 18 vjeçare; ndër nxënësit të cilit kishin përjetuar rrallë bulizëm, 11% e tyre kishin përjetuar ankth në moshën 18 vjeçare dhe ndër nxënësit të cilët kishin qenë rregullisht viktimat të bulizmit, mbi 15% e tyre kishin përjetuar ankth në moshën 18 vjeçare. Studimet ndër – seksionale tregojnë se viktimat apo autorët – viktimat të bulizmit përjetojnë më shumë ankth, në krahasim me nxënësit të cilët nuk përfshihen herë pas here në bulizëm. (Fokus mbi: Bulizmi dhe Shëndeti Mendor). Në veçanti, të qenit viktimë e akteve buliste rrit mundësinë e zhvillimit të çrregullimeve të lidhura me ankthin, duke përfshirë këtu çrregullimin e ankthit të përgjithësuar, fobitë sociale dhe fobi të tjera specifike dhe çrregullimet e panikut. Në përgjithësi, të qenit viktimë e akteve buliste rrit 2 – 3 herë mundësinë për të zhvilluar çrregullime ankthi në krahasim me ato që nuk kanë qenë viktimat të bulizmit.

Çrregullimet psikotike

Ekzistojnë të dhëna, të cilat faktojnë se fëmijët që janë viktimat të shpeshta të bulizmit në shkollë mund të jenë në rrezik të zhvillimit të problemeve të rënda të shëndetit mendor në formën e simptomave ose çrregullimeve psikotike. Çrregullimet psikotike janë klasifikuar si probleme të rënda të shëndetit mendor të cilat ndikojnë aftësinë e një personi për të menduar dhe për të vepruar normalisht. Njerëzit me këto çrregullime mund të humbasin gjithnjë e më shumë kontaktin me realitetin dhe mund të përjetojnë simptoma të tilla si haluçinacione pamore dhe dëgjimore, mendime deluzionale dhe paranojë. Përveç kësaj, disa simptoma të njohura që lidhen me çrregullimet psikotike përfshijnë:

- Tërheqje sociale;
- Depresion;
- Ankth;
- Mungesë motivimi;
- Axhitim ose nervozizëm;
- E folur e çorganizuar;
- Sjellje të çrregullta ose të pazakonshme;
- Mungesë të oreksit.

Përveç këtyre simptomave, ka edhe disa çrregullime psikotike të cilat, nëse nuk marrin trajtimin e duhur mjekësor dhe psikologjik, mund të kenë një ndikim të madh në mirëqenien e një individi. Këto çrregullime psikotike përfshijnë:

- Skizofreninë;
- Çrregullimin skicoafektiv;
- Çrregullimin bipolar;
- Çrregullimi e personalitetit kufitar;
- Çrregullim deluzional.

Aktualisht, vetëm një pjesë e vogël e studimeve kanë shqyrtuar lidhjen midis bulizmit dhe simptomave psikotike. Megjithatë, të qenit viktimë apo autor – viktimë e bulizmit, duket se rrit ndjeshëm rrezikun e fëmijëve që ato të zhvillojnë më tej simptoma psikotike. Një studim gjatësor i 6,000 adoleshentëve vlerësoi nëse fëmijët kishin qenë viktima të bulizmit në shkollë duke filluar nga mosha 8 vjeç dhe nëse kishin përjetuar simptoma psikotike 6 muajt para intervistës. Rezultatet treguan se 11% e nxënësve të cilët nuk ishin viktima të bulizmit shfaqën simptoma psikotike, ndërkohë që kjo përqindje rritej në 14% tek nxënësit, të cilët kishin pësuar nganjëherë bulizëm dhe në 22% tek nxënësit, të cilët kishin pësuar vazhdimisht bulizëm. Të qenit vazhdimisht viktimë e bulizmit dyfishon rrezikun që nxënësit të zhvillojnë simptoma psikotike, në krahasim me të qenit më rrallë viktimë e bulizmit.

Gjatë meta – analizës së 14 studimeve u konstatua se ekziston një lidhje midis bulizmit në shkollë dhe simptomave psikotike. Autorët dolën në përfundimin që, edhe pse kishte akoma një mungesë të hulumtimeve në fushë, gjetjet treguan një lidhje të qëndrueshme midis të qenit viktimë e bulizmit dhe zhvillimit të simptomave psikotike. Sa më të shpeshtë, të ashpër dhe të zgjatur në kohë të jenë aktet buliste të pësura, aq më e fortë bëhej kjo lidhje. Në përgjithësi, gjetjet sugjeronin se të qenit viktimë e bulizmit çon në një rritje pothuajse të trefishtë në gjasat që fëmijët të zhvillonin simptoma psikotike.

Kohët e fundit, një studim i ri i bazuar në të dhënat nga 4,720 pjesëmarrës në Mbretërinë e Bashkuar identifikoi lidhjen ndërmjet kryerjes së akteve buliste dhe simptomave psikotike. Duke kontrolluar paraprakisht dhe karakteristikat paraprake, duke përfshirë ato sjellore, emocionale dhe të shëndetit mendor, autorët zbuluan se çdo formë e

përfshirjes në bulizëm në shkollës, qoftë si viktimë, autor – viktimë apo dhe viktimë, rrit gjasat që nxënësit të përjetojnë simptoma psikotike në moshën 18 vjeç. Për më tepër, sa më shpesh që nxënësit të përfshihen në bulizëm si viktimë apo autorë - viktimë, aq më shumë gjasa ka që ata të shfaqin simptoma psikotike. Ndonëse fëmijët që janë autorë të bulizmit, nuk janë shumë në rrezik të madh për t'u rënë në depresion ose për të përjetuar ankth, ky studim sugjeron se ata mund të jenë më të prekshëm në zhvillimin e simptomave psikotike më vonë në adoleshencë dhe në moshë madhore.

2.13 Bulizmi dhe vetëbesimi

Adoleshenca është periudha gjatë së cilës ndodhin ndryshime dramatike dhe si rrjedhojë e të tilla ndryshimeve, ndryshon dhe perceptimi i individëve për botën. Është e dokumentuar saktë se ka shumë “hipje dhe zbritje” gjatë kësaj periudhe (Adams, 1995). Sipas Harter -it (Harter-it) (1993), një nga konceptet më të rëndësishme gjatë adoleshencës është ai i vetëbesimit. Ndërveprimi me të tjerët është i rëndësishëm për adoleshentin dhe luan një rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e vetëbesimit. Vetëbesimi është i lidhur ngushtë me zhvillimin pozitiv të personalitetit të individit (Kaya & Sackes, 2004) dhe ai është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që ndikon mjaft në aspekte të ndryshme të jetës (Hamarta, 2004). Vetëbesimi i referohet “Vlerësimit nga ana e një individi të vlerave personale, në bazë të të cilave ai e sheh vetveten si pozitiv, kompetent dhe me aftësi përshtatëse” (Aronson, Wilson, Akert & Fehr, 2001, p. 19). Në këtë këndvështrim, mbështetja shoqërore është një faktor i rëndësishëm në formimin e vetëbesimit gjatë adoleshencës. Është gjithashtu e ditur që marrëdhëniet e prindërve dhe të bashkënxënësve me adoleshentët mbështesin zhvillimin e vetëbesimit të adoleshentit. (Hoffman, Levy-Shiff & Ushpiz, 1988; Kulaksizoglu, 2001). Sipas Coopersmith -it (Kupersmith-it) (1967), vëmendja që një individ merr nga njerëzit e tjerë dhe shkalla e pranimi dhe e respektit që ai ose ajo ndjen luan rol në zhvillimin e vetëbesimit. Teoria e “parjes së vetes në xham” pohon se individët e shohin veten e tyre nga perspektiva e të tjerëve dhe i integrojnë këto perceptime me vetëkonceptin e tyre ekzistues (Cooley, 1902; Mead, 1934). Kjo është e rëndësishme sepse sasia e perceptuar e pranimi nga të tjerët mund të përfshihet tek ndjesia personale e vetëvlerësimit dhe e vetëbesimit (Murray, Holmes & Griffin, 2000).

2.14 Shenjat paralajmëruese të përfshirjes në akte buliste

Ka shenja të shumta paralajmëruese të cilat mund të sugjerojnë se dikush është i përfshirë në akte buliste, si në rolin e autorit, ashtu edhe në rolin e viktimës së akteve buliste. Njohja e këtyre shenjave paralajmëruese përbën hapin e parë të rëndësishëm në ndërmarrjen e masave parandaluese kundër bulizmit. Një numër i konsiderueshëm nxënësish të cilët ushtrojnë apo bien pre e akteve buliste, nuk kërkojnë ndihmë për ndalimin e tyre.

Është e rëndësishme t'u ofrohet ndihmë nxënësve të cilët shfaqin shenja të përfshirjes në akte buliste. Këto shenja parandaluese mund të jenë dhe tregues të problemeve të tjera si depresioni apo abuzimi me substancat. Bashkëbisedimi me nxënësit mund të ndihmojë në identifikimin e rrënjëve të problemit.

2.14.1 Shenja se fëmija pëson akte buliste

Ndryshimet në sjellje apo në gjendjen emocionale janë shenja paralajmëruese se një nxënës është duke pësuar akte buliste, por duhet patur gjithashtu parasysh se jo të gjithë nxënësit të cilët pësojnë akte buliste shfaqin shenja paralajmëruese.

Disa shenja të cilat mund të paralajmërojnë pësim të akteve buliste janë:

- Plagë të pashpjegueshme;
- Humbje apo shkatërrim i rrobave, librave, pajisjeve elektronike apo aksesoreve;
- Dhembje të shpeshta të kokës apo të stomakut, të ndjerit i sëmurë apo stimulimi i të ndjerit i sëmurë;
- Ndryshime në zakonin e të ngrënies, si mosngrënie e papritur e një vakti apo mosngrënia me qejf e një vakti. Nxënësit mund të vijnë nga shkolla të uritur pasi nuk kanë ngrënë mëngjes;
- Vështirësi për të fjetur ose makthe të vazhdueshme gjatë natës;
- Ulje të notave, humbje e interesit ndaj detyrimeve apo pjesëmarrjes në aktivitete social – kulturore në shkollë si dhe mosdashje të të shkuarit në shkollë;
- Humbje e papritur e miqve apo shmangie e situatave sociale në shkollë e jashtë saj;
- Ndjenja të pamundësisë për të qenë i ndihmuar ose ulje e vetëvlerësimit;

- Sjellje vetëdëmtuese të tilla si largimi nga shtëpia, dëmtimi i vetvetes ose biseda rreth vetëvrasjes.

2.14.2 Shenja se fëmija kryen akte buliste

Nxënësit mund të jenë duke kryer akte buliste nëse ato:

- Përfshihen në grindje fizike apo verbale;
- Kanë shokë të cilët kryejnë akte buliste ndaj nxënësve të tjerë;
- Janë gjithnjë e më shumë agresivë;
- Dërgohen shpesh tek psikologu apo në drejtori;
- Kanë para të shumta apo sende të reja në pronësi me burim të pashpjegueshëm;
- Fajësojnë të tjerët për problemet e tyre;
- Nuk pranojnë mbajtjen e përgjegjësisë për problemet e tyre;
- Janë konkurues dhe shqetësohen për reputacionin apo popullaritetin e tyre në shkollë.

Marrë nga: <https://www.stopbullying.gov/at-risk/warning-signs/>

2.15 Programet e parandalimit të bulizimit

Qëllimi i programeve të parandalimit të bulizimit është të rrisin cilësinë e lidhjeve dhe marrëdhënieve midis bashkënxënësve dhe ta bëjnë shkollën një vend pozitiv dhe të sigurt për nxënësit që të mësojnë dhe të zhvillohen. Nevoja për zbatimin e këtyre programeve mbështetet edhe nga kërkimet të cilët theksojnë mungesën e komunikimit midis nxënësve dhe stafit të mësuesve përsa u përket sjelljeve buliste. Harris (Harris) dhe Willoughby – u (Uillëbi –u) (2003) zbuluan se vetëm 4% e nxënësve i treguan mësuesve kur ato kanë rënë pre e akteve buliste dhe vetëm 25% e nxënësve perceptuan se mësuesit ishin të interesuar të ndalonin aktet buliste. Harris dhe Isernhagan - i (2003) raportuan se 43% e nxënësve të anketuar raportuan “nuk e di” pyetjes nëse stafi i shkollës ishte i interesuar për t’u përpjekur për ta ndaluar bulizmin dhe 14% besonin se ato nuk ishin aspak të interesuar për t’i ndaluar sjelljet buliste. Në të dy studimet, gjithsesi, shumica e stafit raportoi se të gjitha format e bulizmit janë të dëmshme. Kërkuesit dolën në konkluzionin se perceptimi i nxënësve se stafi i shkollës nuk ishte i interesuar për të reduktuar bulizmin ka

shumë gjasa të mos të ishte i saktë, sepse stafi nuk kishte transmetuar shqetësimin e tij rreth nxënësve.

McCartney - i (Mek Kartni) (2005) zbuloi se viktimat zakonisht nuk u tregojnë mësuesve që ato kanë rënë pre e akteve buliste, sepse ato “nuk besojnë se të rriturit mund të bëjnë ndonjë gjë kundër akteve buliste; nuk duan që nxënësit e tjerë të jenë në dijeni të faktit se ato kanë probleme; ato janë të ndrojtur dhe u mungon besimi për të ngritur zërin; dhe nuk duan të dëgjojnë të rriturit t’u thonë “Injoroje atë”. “Nxënësit duan që të rriturit t’i pyesin ato rreth problemeve të bulizmit, të krijojnë mundësi të flasim privatisht me nxënësit, t’i ruajnë ato dhe t’i ndërshkojnë autorët e akteve buliste, në vend që thjesht vetëm t’u japin këshilla apo sugjerime.

Programet parandaluese të bulizmit kanë si qëllim dhe ndërgjegjësimin e komunitetit ndaj akteve buliste dhe si rrjedhojë trajtimin dhe parandalimin e tyre. Të gjithë anëtarët e komunitetit duhet të ndërgjegjësohen për evidentimin, mospranimin, trajtimin dhe parandalimin e akteve buliste pasi aktet buliste kanë pasoja emocionale dhe psikologjike tek të gjithë individët e përfshirë në bulizëm dhe në mënyrë të veçantë tek viktimat e akteve buliste. Kur ndaj nxënësve ushtrohen akte buliste, ato shpesh ndjejnë inat dhe turp në të njëjtën kohë, gjë që shkakton ndjenjën e poshtërimit. Kur në shkollë ushtrohen akte buliste, dhe për më tepër kur ndaj tyre nuk ndërmerren nisma parandaluese nga ana e mësuesve apo nga ana e prindërve ose e personave të tjerë kujdestarë, nxënësit detyrohen të tolerojnë një padrejtësi dhe në këtë mënyrë dëmtohet ndjenja e dinjitetit dhe e vetëbesimit. Nxënësit në këtë mënyrë mund të mos kenë më besim tek të rriturit, gjë që pengon dhe raportimin e mëtejshëm të akteve buliste dhe ul ndjenjën e sigurisë së nxënësve ndaj shkollës dhe ambjenteve të tjera në komunitet.

2.15.1 Programi i parandalimit të bulizmit Olweus - it (PPBO)

PPBO - it, i krijuar dhe i përpunuar në Norvegji më vitet 1980, është ende iniciativa më e njohur për reduktimin e bulizmit (Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 2004; Federata Amerikane e Mësuesve, 2000; Starr, 2000; Olweus dhe Limber, 1999). Programi është i hartuar për rritjen e ndërgjegjësimin, përmirësimin e marrëdhënieve midis bashkënxënësve, ndërhyrjet për të shmangur

ngacmimet, zhvillimin e rregullave të qarta kundër sjelljeve buliste si dhe mbështetja dhe mbrojtja e viktimave. Stafi i shkollës, mësuesit, prindërit, anëtarët e komunitetit, autorët, viktimat dhe shumica e heshtur e nxënësve janë të gjithë të përfshirë në program.

Karakteristikat kryesore të PPBO - it janë se përgjegjësia primare për zgjidhjen e problemeve u jepet stafit mësimor dhe psiko - social në shkollë (më pak sesa prindërve apo nxënësve). Në këtë program vihet në fokus e tërë popullata e shkollës (jo thjesht disa nxënës problematikë) me komponentë të orientuar si drejt individit, ashtu dhe drejt sistemit dhe programi është një komponent i përhershëm i ambjentit shkollor, dhe jo një program i përkohshëm për zbutjen dhe shuarjen e sjelljeve buliste.

Është parashikuar që programi të përdoret në mënyrë afatgjate: Zbatimi i tij zgjat 18 deri 20 muaj; mbas tij shkollat aplikojnë më tej programin “Sistemi i ruajtjes së kualitetit” të Olweus –it, i cili shërben për të ruajtur rezultatet e arritura deri më tani nëpërmjet PPBO –it.

PPBO - it ndërhyr në tre nivele:

- **Shkolla:** Trupa pedagogjike i anketon nxënësit në mënyrë anonime për të përcaktuar natyrën dhe përhapjen e problemeve të sjelljeve buliste në shkollë. Mbikëqyrja e nxënësve rritet gjatë pushimeve midis orëve dhe kryhen takime në shkollë për të diskutuar rreth sjelljeve buliste. Kryhen takime këshilluese për të edukuar mësuesit, drejtuesit, prindërit e nxënësve dhe anëtarët e komunitetit rreth bulizmit, strategjive përkatëse dhe burimeve të mundshme. Mësuesit marrin trajnime shtesë për mënyrën si ta zbatojnë programin. Komiteti koordinues formohet për ta menaxhuar programin, tipikisht ai përbëhet nga drejtuesi, mësues nga secili nivel klase, psikologu, si dhe nga përfaqësues të prindërve dhe nxënësve. Takimet dhe diskutimet e vazhdueshme rreth sjelljeve buliste zhvillohen sipas një plani kohor të përcaktuar dhe midis stafit të shkollës dhe prindërve.
- **Klasa:** Mësuesit prezantojnë dhe forcojnë rregullat e klasës kundër bulizmit, zhvillojnë mbledhje klase me nxënësit për të diskutuar rreth bulizmit dhe takohen me prindërit për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre.
- **Individual:** Stafi i shkollës ndërvepron me autorët, viktimat dhe prindërit e tyre për të ndalur aktet buliste nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme social – kulturore, me

kryerjen e diskutimeve serioze rreth bulizmit si dhe me ofrimin e seancave psikologjike individuale dhe në grup.

Vlerësimet e kryera kanë treguar se programi është mjaft efektiv si në klasat e arsimit bazë, ashtu dhe në ato të arsimit të mesëm, duke e ulur përhapjen e bulizmit me 50% ose dhe më shumë gjatë dy viteve të para të zbatimit të tij. Është treguar se programi zhvillon klimën e shkollës dhe çon në uljen e shkallës së sjelljeve antisociale. Disa studime kanë treguar se ndryshimet bëhen më të dukshme, ndërkohë që programi vazhdon të zbatohet për një kohë të gjatë (Zyra e Drejtësisë të të rinjve dhe parandalimi i kundravajtjeve/krimeve, 2001; Federata amerikane e mësuesve, 2000; Olweus dhe Limber, 1999).

2.15.2 Strategji për zhvillimin e programit parandalues të bulizmit.

Shpeshësia me të cilën ndodh bulizmi mund të ulet duke krijuar një klimë pozitive në shkollë, e cila edukon/evokon respekt dhe vendos standarte të larta për sjelljet ndërpersonale (Cohn dhe Canter, 2003; Banks, 1997). Programet efektive parandaluese të bulizmit duhet të ristrukturojnë ambjentin mësimor për të krijuar një klimë të karakterizuar nga përfshirje mbështetëse të të rriturve, modele pozitive rolesh të të rriturve, limite të mirëpërcaktuar dhe sanksionime të qëndrueshme për sjelljet buliste (Cohn dhe Canter, 2003; Starr, 2000). Rishikimi i mëtejshëm i literaturës rreth programeve të sukseshme antibulizëm ka identifikuar strategjitë e përgjithshme të mëposhtme si komponentë themelore të programeve efektive:

- **Zbatimi i një programi gjithëpërfshirës në shkollë:** të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës duhet të bëjnë pjesë dhe të angazhohen për të promovuar një klimë pozitive në shkollë. Programi duhet të ndërtojë një ambjent, në të cilin fëmijët të ndjejnë përkujdesje dhe respekt dhe ku të rriturit të japin modelet e sjelljeve pozitive. Administrata e shkollës, duke filluar nga Bordi i Shkollës dhe deri tek drejtori i saj duhet të promovojë dhe të financojë programin (Cohn dhe Canter, 2003; Shellard, 2002; LREN, 2001).

Programet më produktive janë ato që zgjasin gjatë gjithë vitit shkollor dhe të cilët bashkërendohen me kurrikulën, politikat e disiplinës në shkollë dhe me orvatjet e parandalimit të dhunës. Diskutimet e izoluara kanë pak gjasa të shkaktojnë

përmirësime domethënëse të sjelljeve (Pirozzi, 2001). Nevojiten orvatje të rishikuara çdo vit për të rforcuar politikat e zbatuara antibulizëm me nxënësit, prindërit e tyre dhe me stafin e shkollës (DDSHBA, 2004). Laboratori Rajonal i Edukimit të Northwest- it (2001) paralajmëron se ndryshimi nuk ndodh menjëherë dhe se duhet mbështetja e vazhdueshme e të gjithë komunitetit të shkollës për të arritur ndryshimin e kulturës së përgjithshme të shkollës.

- **Ndërhyrja e hershme:** Edhe pse kërkimet tregojnë se mund të arrihen ulje të incidenteve buliste në shkollat e mesme të ulëta dhe në ato të larta (Stevens dhe të tjerë, 2000), ekspertët sugjerojnë që programet parandalues të bulizmit duhet implementuar në shkollat fillore. Studimet kanë treguar se programet janë veçanërisht efektive në klasat e para fillore pasi bulizmi ka tendencën të rritet më tej në klasat e arsimit të mesëm të ulët (Cohn dhe Canter, 2003; Ballard dhe të tjerë, 1999). Ndërhyrjet janë gjithashtu më të lehta të implementohen në klasat fillore, për shkak të madhësisë dhe strukturës së tyre. Duke patur parasysh faktin që nxënësit ndërveprojnë me më pak mësues çdo vit, është më e lehtë që ato të marrin mesazhe antibulizëm më të qëndrueshme (Stevens dhe të tjerë, 2000).
- **Vlerësimi i shtrirjes së problemit:** Gjatë fazave fillestare të zhvillimit të programit, nxënësit, mësuesit dhe prindërit duhet të anketohen rreth përhapjes së bulizmit në shkollë. Anketimet japin informacione ku, kur dhe midis kujt ndodhin sjelljet buliste dhe gjithashtu e lejojnë stafin e shkollës të shqyrtojë dhe analizojë mospajtimet midis perceptimeve të nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Administratorët e programit mund të diskutojnë më pas, cilat nga çështjet e identifikuar nga anketimet janë më urgjente dhe si të zbuten ato, duke u dhënë ndihmë dhe fonde stafit të shkollës (Shellard, 2002; LREN, 2001; Federata Amerikane e Mësuesve, 2000; Olweus, 1996).
- **Drejtuesi ofron udhëheqje:** Disa studiues sugjerojnë se angazhimi dhe përfshirja e drejtuesit të shkollës në parandalimin dhe kontrollimin e bulizmit kontribon në uljen e numrit të sjelljeve buliste (Farrington, 1993). Si udhëheqësi i shkollës, drejtuesi duhet të marrë iniciativën të promovojë dhe të përkrahë në mënyrë aktive sjelljet antibulizëm. Ai ose ajo duhet të edukojë stafin rreth karakteristikave të autorit dhe

viktimës, si dhe rreth pasojave të menjëhershme dhe afatgjata të bulizmit. Drejtuesi duhet gjithashtu t'i komunikojë stafit dhe nxënësve se sjellja agresive nuk është pjesë normale e zhvillimit dhe se të qenit i viktimizuar nuk e ndihmon viktimën të rritet apo të forcohet (Shellard, 2002; Ballard dhe të tjerë, 1999; Garrity dhe të tjerë, 1996).

- **Kryerja e trajnimeve të stafit:** Duhet të kryhen trajnime për mësuesit, drejtuesit dhe stafin tjetër të shkollës, në mënyrë që ato të mund të njohin dhe të reagojnë në mënyrën më efektive ndaj bulizmit duke njohur strategjitë ndërhyrëse. Në trajnime duhet të përfshihen edhe anëtarët e stafit, të cilët kanë më shumë gjasa të ndodhen në vendet ku ndodhin më së shumti sjelljet buliste (të tillë si: të punësuarit në barin e shkollës, shoferët e autobuzit të shkollës, stafi i rojeve dhe i sanitareve, si dhe mbikëqyrësit e kopshit të shkollës). Çështje të cilat duhet të mbulohen në sesionet trajnuese përfshijnë (DDSHBA, 2004; Cohn dhe Canter, 2003; Shellard, 2002; LREN, 2001):

- Përcaktimin e bulizmit;
- Dallimin midis konflikteve normale midis bashkënxënësve dhe bulizmit;
- Treguesit e sjelljeve buliste;
- Karakteristikat e autorëve dhe të viktimave;
- Pasojat afatgjata të mosndërhyrjes tek autorët dhe tek viktimat e bulizmit;
- Mënyrat për të integruar materialet antibulizëm në kurrikulën shkollore dhe strategjitë për adresimin e sjelljeve buliste, duke përfshirë nisma specifike të cilat duhet ndërmarrë kur ndodh bulizmi.

Disa studime sugjerojnë që në klasat e nxënësve me probleme të sjelljes, emocionale apo me probleme me të nxënëit ka më shumë autorë dhe viktime dhe si rrjedhojë mësuesit në këto klasa mund të kenë nevojë për trajnime shtesë për të identifikuar dhe trajtuar situatat buliste (DDSHBA, 2004).

- **Vendosja e rregullave dhe politikave të qarta antibulizëm:** Formulimi i politikave antibulizëm ndihmon për t'u siguruar se incidentet buliste trajtohen në mënyrën e duhur nga i gjithë stafi i shkollës. Studimet kanë dalë në konkluzionet se

shkollat të cilat operojnë në bazë të rregullave lehtësisht të kuptueshme të sjelljeve dhe në bazë të praktikave të disiplinës të paanshme, raportojnë më pak dhunë (Cohn dhe Canter, 2003). Politikat antibulizëm duhet të përmbajnë përcaktime të qarta të bulizmit dhe përshkrime si duhet të reagojë stafi në raste të incidenteve buliste. Shkolla duhet të forcojë në mënyrë të vazhdueshme rregullat antibulizëm dhe të sigurohet se të gjithë nxënësit janë të informuar plotësisht rreth pasojave të thyerjes së rregullave (DDSHBA, 2004).

Për të theksuar rëndësinë që shkolla i vendos kundërshtimit të sjelljeve buliste, mund të vendosen në çdo klasë postera të cilët ndalojnë bulizmin dhe që pasqyrojnë pasojat e tij. Gjithashtu nxënësit të cilët janë regjistruar rishtazi në shkollë duhet të informohen rreth politikave antibulizëm të shkollës, për të shmangur kështu çdo shfaqësim që nxënësit e rinj mund të kenë për kryerjen e sjelljeve buliste (DDSHBA, 2004).

➤ **Integrimi i temave antibulizëm në kurrikulën shkollore:** Mësuesit luajnë një rol thelbësor në mënyrën si prezantohen dhe përçohen tek nxënësit politikat dhe programet antibulizëm. Studiuesit kanë arritur në përfundimin se ndërhyrja në kurrikulën shkollore është një komponent kritik i programeve antibulizëm, sepse nxënësit mësojnë si t'i bëjnë ballë autorëve dhe të ndihmojnë viktimat (Shellard, 2002). Temat antibulizëm duhet të integrohen në kurrikulën shkollore nëpërmjet aktiviteteve socio – kulturore dhe nëpërmjet diskutimeve me fokus bulizmin. Kurrikula antibulizëm duhet të përmbajë (Shellard, 2002; Pirozzi, 2001; Fried dhe Fried, 1996; Kreidler, 1996):

- Përcaktimin e bulizmit;
- Diskutime se si bulizmi mund të prekë këdo;
- Materiale të cilët inkurajojnë nxënësit të eksplorojnë dallimet, të përkrahin dhe promovojnë miqësitë përtej kufijve të dallimeve dhe të lehtësojnë bisedat rreth bulizmit;
- Diskutime rreth mënyrave dhe rrugëve se si mund të ndihmohen viktimat;

- Takime për të diskutuar pasojat dhe dëmet që mund të shkaktojë bulizmi dhe strategjitë se si mund të pakësohen ato;
- Zhvillimi i planit të veprimit i klasës për t'i sqaruar nxënësit çfarë të bëjnë kur ato vëzhgojnë akte buliste;
- Trajnimi i aftësive sociale, menaxhimi i inatit dhe edukimi i karakterit;
- Bashkëpunimi i mësuesve duke hartuar projekte të cilët kërkojnë bashkëpunim.

➤ **Puna individuale me nxënësit:** Fëmijët nuk mund t'i zgjidhin të vetëm problemet e bulizmit. Stafi shkollor duhet të krijojë një atmosferë besimi ku nxënësit të kenë kurajo t'i raportojnë përfshirjen në bulizëm si njëri - tjetrit ashtu dhe të tjerëve (LREN, 2001). Mësuesit duhet të ndërtojnë ura komunikimi dhe mirëbesimi me nxënësit dhe ato duhet të dinë si të shprehin gatishmërinë për t'i ofruar ndihmë nxënësve (Harris dhe Willoughby, 2003).

Stafi i shkollës mund t'u tregojë nxënësve se secili prej tyre vlerësohet dhe respektohet duke krijuar mundësitë për nxënësit të mësojnë të punojnë së bashku, si p.sh. përmbushja e detyrave të cilat kërkojnë shpërndarje informacioni dhe bashkëpunim (Hoover dhe Oliver, 1996; Kreidler, 1996; Rigby, 1995).

Duke patur parasysh faktin që shumë nxënës ndjehen në siklet ose ndjehen të tmerruar të flasin rreth bulizmit, stafi duhet t'i fillojë vetë këto biseda, në vend që të presë që nxënësit ta prekin këtë temë (Fried dhe Fried, 1996).

Stafi duhet të jetë i përgatitur të ndërhyjë dhe të veprojë menjëherë kur ato venë re akte bulizmi dhe gjithashtu ato duhet të shprehin një mosmiratim të fuqishëm kur bulizmi ndodh ose kur diskutohet rreth tij (LREN, 2001).

Mësuesit dhe drejtuesit duhet t'ua bëjnë mjaft të qartë nxënësve se ato nuk e falin ngacmimin apo keqtrajtimin e të tjerëve (Kreidler, 1996).

Programet antibulizëm nuk duhet t'i stigmatizojnë nxënësit as si autorë, dhe as si viktimë. Duke e etiketuar nxënësin si autor, apo viktimë mund të sigurohesh se ai do të marrë ndihmë, por nga ana tjetër e bën dhe më të vështirë që nxënësi t'i largohet atij roli (LREN, 2001). Autorët shpesh herë shfaqin vetveten në mënyrë pozitive kur ato pozicionohen në role drejtuese që i lejojnë ato të ridrejtojnë nevojën

e tyre për pushtet. Këshilluesit e karrierës, psikologët ose personel tjetër i specializuar i shkollës mund t'i ofrojnë nxënësve aktivitete, të cilat rrisin vetëvlerësimin e tyre, suksesin akademik dhe aftësitë e krijimit të marrëdhënieve pozitive midis bashkënxënësve (Shellard, 2002). Autorët mund të dërgohen në një vend të veçantë ose atyre mund t'u jepet një detyrë e caktuar gjatë periudhave të pushimit. Kjo orvatje jo vetëm që i ndan autorët nga viktimat, por gjithashtu i ofron autorëve mundësinë të kryejnë detyra dobiprurëse (DDSHBA, 2004). Autorëve duhet t'u ofrohen seanca terapeutike për këshillim individual dhe për menaxhimin e stresit nga personeli i kualifikuar dhe i trajnuar i shkollës (Shellard, 2002; LREN, 2001; Fried dhe Fried, 1996).

Ndaj autorëve të akteve buliste, sikundërse dhe ndaj të gjithë nxënësve në shkollë sugjerohet të aplikohet disiplina pozitive. Disiplina pozitive synon ta drejtojë sjelljen e nxënësve duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të tyre emocionale dhe psikologjike. Ajo synon që t'i ndihmojë nxënësit të marrin përgjegjësi për marrjen e vendimeve të mira dhe të kuptojnë pse këto vendime ishin në interesin e tyre më të mirë. Disiplina pozitive i ndihmon nxënësit të mësojnë vetëdisiplinimin pa frikë. Ajo përfshin dhënien e përcaktimeve dhe rregullave të qarta se cilat sjellje janë të pranueshme në shkollë dhe jashtë saj dhe më pas dhënien e mbështetjes nxënësve, ndërkohë që ato mësojnë të veprojnë në përputhje me këto rregulla. Kur është e nevojshme, disiplina pozitive përmban dhe pasoja jo dhunuese për sjelljet buliste. Kur nxënësit kryejnë akte buliste ato nuk ndërkohën për sjelljet e tyre buliste, por mësuesit të cilët aplikojnë disiplinën pozitive përdorin pasoja të cilat zëvendësojnë eksperiencat poshtëruese si në rastet e ndërkohimeve me sjelljet e mëposhtme:

- Ato i mësojnë nxënësit e përfshirë në akte buliste të marrin në konsideratë pasojat e sjelljeve të tyre ndaj bashkënxënësve të tjerë;
- Ato bashkë me nxënësit e përfshirë në bulizëm mundohen të identifikojnë sjellje të tjera alternative dhe të preferuara dhe mundohen të kuptojnë pse sjelljet e preferuara janë pozitive apo jo;

- Mundohen të korigjojnë dhe të përmirësojnë sjelljet e tyre buliste, duke mos u shkaktuar më dëm bashkënxënësve.

Kuptimi dhe ndryshimi pozitiv i sjelljeve buliste arrihet nëpërmjet shkrimit të eseve të ndryshme me temë “Bulizmin” si dhe nëpërmjet organizimit të çdo aktiviteti i cili mund të mundësojë ndërgjegjësimin e nxënësve për të mos u përfshirë në akte buliste dhe të mos lejojnë kryerjen e tyre në të ardhmen. Disiplina pozitive nuk i shpërblen nxënësit për sjelljet e papërshtatshme; ajo i jep atyre një mundësi për t’u zhvilluar si individë duke i kuptuar gabimet e tyre dhe duke vlerësuar faktin se sjelljet e përshtatshme mund t’u sjellin atyre përvoja dhe mundësi pozitive. Disiplina pozitive është e fokusuar tek nxënësi dhe në qendër të saj është interesi më i mirë tek ai. Marrëdhënia dhe ndërveprimi midis mësuesit dhe nxënësit bazohet në dhembshuri dhe respekt të ndërsjelltë. Mësuesit i krijojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet me nxënësit duke u bazuar në njohuritë e tyre rreth nevojave të zhvillimit të fëmijës dhe reagojnë ndaj sjelljeve të ndryshme të nxënësve me qëllimin kryesor për t’i ndihmuar ato të mësojnë dhe të rriten të shëndetshëm psikologjikisht dhe emocionalisht. Kur nxënësit janë përfshirë apo vazhdojnë të përfshihen në sjellje buliste, ndryshimi i këtyre sjelljeve jo të përshtatshme në shkollë dhe jashtë saj tentohet të realizohet jo nëpërmjet përdorimit të dhunës nga ana e mësuesve, por nëpërmjet përforsimit pozitiv për sjellje pro sociale dhe kuptimit të pasojave për sjelljet e papërshtatshme. Aplikimi i disiplinës pozitive nga ana e mësuesve mundëson formimin e nxënësve të suksesshëm dhe të individëve të suksesshëm në të ardhmen. Nxënësve të cilët kanë përjetuar disiplinën pozitive u brendësohet dëshira për të zotëruar dhe shfaqur vetëdisiplinim. Pasojat e përdorimit të disiplinës pozitive janë të dukshme dhe ndikojnë dhe në formimin e personalitetit të nxënësve. Ato kanë qëllime të qarta, besojnë tek vetvetja, janë të vetëmotivuar, kanë vullnetin të punojnë fort për arritjen e qëllimeve të tyre, u besojnë gjykimeve të tyre personale, mendojnë për rrugë dhe mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve të tyre dhe janë këmbëngulës në realizimin e qëllimeve të tyre.

Drejtuesit e shkollës duhet të krijojnë rrjete për të mbështetur dhe mbrojtur viktimat e bulizmit. Viktimat e kanë të nevojshme ta dinë se ato nuk duhet të ndjehen fajtorë

për faktin se kanë rënë pre e keqtrajtimeve. Programet antibulizëm duhet të përmbajnë trajnime për forcimin e aftësive sociale të viktimave, si dhe seanca terapeutike individuale për t'i ndihmuar ato ta përballojnë ankthin apo depresionin. Aktivitetet mësimore të përbashkëta në klasë mund t'i ndihmojnë viktimat e akteve buliste të zbusin ndjesinë e izolimit social të viktimave (Shellard, 2002; LREN, 2001; Fried dhe Fried, 1996).

Programet të cilët i mësojnë nxënësve të njohin bulizmin dhe strategjitë për të ndërhyrë në situata bulizmi mund të kenë ndikim në reduktimin e incidenteve të bulizmit. P.sh. të ftuarit e një nxënësi i cili është duke qëndruar vetëm, të bashkohet në një lojë apo në një bashkëbisedim, e bën atë fëmijë më pak të shenjëstruar për të qenë objekt i bulizmit (Shellard, 2002). Garrity dhe të tjerë (1996) zbuluan se çelësi i suksesit të programeve antibulizëm është ndryshimi i balancës së pushtetit midis autorit dhe shumicës së heshtur të nxënësve. Shumica e heshtur e nxënësve duhet të jetë e aftë të ndërhyjë në favor të viktimave. Autorëve duhet t'u dilet përballë dhe t'u bëhet e qartë se sjellja e tyre nuk do të tolerohet.

Si përfundim stafi i shkollës duhet të ketë parasysh që përpjekjet dhe mbështetja e tyre nuk mbaron me identifikimin dhe disiplinimin e autorit. Viktimat mund të kenë nevojë për t'u përballuar me ankthin dhe depresionin dhe autorët mund të përfitojnë mjaft nga sesionet e menaxhimit të ankthit ose nga këshillimi individual. Duhet të identifikohen gjithashtu dhe burimet e shkollës apo të komunitetit për t'u ofruar ndihmë psikologjike autorëve, viktimave dhe familjeve të tyre (LREN, 2001; Fried dhe Fried, 1996).

➤ **Krijimi i një ambjenti të sigurt fizik:** Shkollat mund të rrisin sigurinë fizike dhe të reduktojnë bulizmin duke implementuar strategjitë e mëposhtme:

- *Rritja e mbikëqyrjes nga të rriturit në zonat ku ka tendencën të ndodhë bulizmi.* Stafi i programit duhet të identifikojë këto zona dhe të bashkëpunojë me stafin e shkollës për tu siguruar se ekziston një supervizim i duhur nga të rriturit në këto zona. Oborret, vend stacionet e autobuzit, korridoret dhe tualetet janë vende të izoluara dhe ato u ofrojnë

autorëve mundësi për të izoluar viktimat e tyre (Shellard dhe Turner, 2004; DDSHBA, 2004; Shellard, 2002; LREN, 2001);

- *Reduktimi i sasisë së kohës që nxënësit kalojnë në aktivitete ku mbikëqyrja është në nivelet minimale.* Duke marrë në konsideratë faktin që bulizmi ndodh më së shumti në kohën kur mbikëqyrja është minimale (në raste të tilla si: pushimet mes orëve, pushimi i madh dhe ndryshimi i klasave), reduktimi i sasisë së kohës në dispozicion të nxënësve mund të reduktojë dhe numrin e akteve të bulizmit. Alternimi i pushimeve mes orëve, pushimit të madh dhe ndryshimet të klasave pakëson numrin e autorëve dhe të viktimave, të cilët ndodhen bashkë në të njëjtën kohë, duke e bërë kështu dhe më të lehtë identifikimin e bulizmit (DDSHBA, 2004);
- *Ngritja e një sistemi raportimi konfidencial i lejon nxënësve të raportojnë aktet buliste dhe në një mënyrë të tillë mblidhen dhe detaje rreth incidenteve të bulizmit.* Nxënësit duhet të inkurajohen për të raportuar bulizmin dhe t'u kujtohet diferenca midis “llomotitjeve” dhe të dhënit ndihmë tjetrit (Shellard, 2002; Fried dhe Fried, 1996; Kreidler, 1996). Disa shkolla kanë ofruar një linjë telefonike ose “kutinë e bulizmit”, nëpërmjet të cilave nxënësit mund të raportojnë aktet buliste (DDSHBA, 2004);
- *Dokumentimi i të gjitha incidenteve të bulizmit në shkollë, duke përfshirë informacione të tilla si: kush u përfshinë, ku ndodhi, sa shpesh dhe çfarë strategjish u përdorën për të adresuar problemin.* Ky dokumentim mund të përdoret herë pas herë për të identifikuar ndonjë model të sjelljes buliste dhe cilat tipe ndërhyrjesh janë më efilase për t'i ndalur sjelljet buliste (DDSHBA, 2004; LREN, 2001; Kreidler, 1996).

➤ **Përfshirja dhe edukimi i prindërve:** Stafi i shkollës duhet të edukojë dhe të përfshijë dhe prindërit, në mënyrë që ato ta kuptojnë problemin e bulizmit, të njohin shenjat e tij dhe të ndërhyjnë në mënyrën më të përshtatshme. Kërkimet kanë treguar se programet antibulizëm janë shpesh më efektive kur prindërit kuptojnë

principet e tyre themelore dhe kur ato e dinë, që shkolla nuk do ta tolerojë bulizmin (DDSHBA, 2004). Prindërit duhet të përfshihen si në planifikimin, ashtu edhe në zbatimin e programit dhe ato duhet të edukohen rreth seriozitetit të problemit të bulizmit dhe rreth pasojave të dëmshme që mund të ketë ai mbi vetëvlerësimin dhe performancën akademike. Shumë prindër mendojnë se bulizmi është një sjellje kalimtare dhe nuk e marrin seriozisht atë (Shellard, 2002). Prindërit duhet të mësojnë të përforcojnë modelet e sjelljeve pozitive të fëmijëve të tyre dhe të modelojnë ndërveprime e duhura ndërpersonale. Psikologët shkollor, punonjësit social dhe këshilluesit mund t'i ndihmojnë prindërit të njohin sjelljet buliste, të cilat kërkojnë ndërhyrje dhe të mbështesin fëmijët, të cilët kanë tendencën të bien viktima të bulizmit (Cohn dhe Canter, 2003).

- **Kushtimi i vëmendjes ndaj orvatjeve parandaluese të bulizmit të cilat nuk janë efektive.** Programet nëpër shkolla kanë më shumë gjasa të jenë të suksesshëm, nëse stafi i shkollës nuk i sheh ato si barrë. Shkollat të cilat vazhdimisht nuk kanë qenë dakort për zbatimin e programeve antibulizëm, kanë përmendur mungesën e kohës, mungesën e mbështetjes dhe mungesën e trajnimeve të papërshtatshme si pengesat kryesore për zbatimin e një programi efektiv (LREN, 2001). Kërkimet kanë dalë në konkluzionin se reagimet e mëposhtme ndaj bulizmit shpesh nuk janë efektive në reduktimin e kryerjes së sjelljeve buliste:

- *Trajnimi i nxënësve për zgjidhjen e konflikteve dhe për ndërmjetësimin midis bashkënxënësve.* Zgjidhja e konflikteve nuk është zakonisht efektive në reduktimin e bulizmit, pasi bulizmi nuk është një konflikt midis bashkënxënësve me të njejtin status, por abuzim i vazhdueshëm i pushtetit. Ndërmjetësimi midis bashkënxënësve shpesh viktimizon më tej nxënësit, të cilët kanë pas rënë pre e akteve buliste (DDSHBA, 2004, Nansel dhe të tjerë, 2001);
- *Miratimi i politikave të “tolerancës zero”.* Këto politika mbështeten në masa përjashtuese (të tilla si pezullimi dhe përjashtimi), të cilat mund të kenë pasoja afatgjata negative. Ato nuk e zgjidhin problemin e autorit të akteve buliste, i cili në mënyrë tipike shpenzon më shumë kohë të

pambikëqyrur në shtëpi ose në komunitet nëse ai ose ajo pezullohet ose përjashtohet nga shkolla. Gjithashtu, kjo orvatje mund të ketë si pasojë nivel të lartë të pezullimeve nga shkolla, pa arritur në rradhë të parë të kuptohet si mund të modifikohet pozitivisht sjellja buliste (DDSHBA, 2004; Cohn dhe Canter, 2003);

Gjithashtu nuk është i sugjerueshëm aplikimi i ndërshkimeve nga ana e mësuesit apo nga të rriturit e tjerë ndaj nxënësve, të cilët kanë kryer apo vazhdojnë të kryejnë akte buliste. Dhuna shkakton dhunë ndaj dhe kur nxënësi pëson dhunë, veçanërisht nga të rriturit në shkollë është një nga faktorët kryesorë që një nxënës të fillojë të ushtrojë dhunë mbi bashkëmoshatarët e tij. Kur nxënësit pësojnë ndërshkime nga ana e mësuesve në shkollë apo nga ana e prindërve apo e personave të tjerë kujdestarë, ato kanë tendencën të kryejnë më shumë akte buliste ndaj bashkënxënësve pasi pësimi i ndërshkimit negativ u mëson nxënësve që dhuna është një mënyrë e pranueshme për t'u imponuar pikëpamjet apo mendimet e tyre bashkënxënësve më pak të fuqishëm apo të pushtetshëm. Ndërshkimi më shumë shkakton dëm se sa sukses. Ai nuk u mëson nxënësve çfarë ishte e gabuar në sjelljen e tyre. (Cohn dhe Canter, 2003);

- *Zbatimi i masave reaguese.* Masat reaguese, të tilla si prezenca e sigurisë së rritur në korridore ose instalimi i detektorëve metalikë ose kamerave të sigurisë, nuk kanë treguar se ato mund të sigurojnë rezultate pozitive të qarta dhe të prekshme (Cohn dhe Canter, 2003);
- *Ofrimi i trajnimeve të vetëvlerësimit për autorët.* Duke patur parasysh faktin, që kërkimet sugjerojnë se shumica e autorëve të akteve buliste nuk kanë mungesë të vetëvlerësimit, ofrimi i trajnimeve mbi vetëvlerësimin e autorëve mund të jetë një orvatje keqorientuese (DDSHBA, 2004);
- *Inkurajimi i viktimave thjesht t'u "kundërvihen" autorëve.* Pa mbështetjen e duhur ose pa përfshirjen e të rriturve, kjo strategji mund

të jetë e dëmshme dhe fizikisht e rrezikshëm për viktimat (DDSHBA, 2004).

2.16 Masat parandaluese dhe trajtimi i rasteve të bulizmit

Për parandalimin dhe trajtimin e bulizmit në botë janë ndërmarrë nisma të ndryshme, por në këtë studim do të merren në konsideratë vetëm nismat e ndërmarra në bashkinë Elbasan dhe në atë të Mynih –ut.

2.16.1 Masat parandaluese të ndërmarra në bashkinë e Elbasan -it

Fenomeni i bulizmit është një fenomen shumë pak i trajtuar në shkollat e bashkisë Elbasan. Duke qenë i tillë dhe masat parandaluese kundër bulizmit janë thuajse inekzistente. Në shkollat 9 vjeçare, përveç disa orëve edukative të organizuara nga OJF “Qendra e Integritit Social” në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave, me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve rreth fenomenit të bulizmit nuk është ndërmarrë asnjë nisëm tjetër për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të bulizmit. Në kuadër të disa nismave kombëtare kundër dhunës janë organizuar disa takime dhe me nxënës të shkollave nëntë – vjeçare, por asnjëra nga ato nuk ka patur në fokus të saj veçanërisht bulizmin. Bulizmi është trajtuar në këto takime ndërgjegjësuëse dhe sensibilizuese shumë shkurt dhe kryesisht vetëm si një ndër format e dhunës midis nxënësve. Ndër to mund të përmendim:

- Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit, pushtetin vendor dhe partnerë ndërkombëtarë si UNICEF, “ Save the Children “, si dhe me organizatat kombëtare të shoqërisë civile u realizua më 2015 Plan i Kombëtar i mobilizimit “Unë mbroj Fëmijët”, i cili kishte në kuadër sensibilizimin kundër dhunës, neglizhimit, abuzimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Në kuadër të këtij plani kombëtar u zhvilluan dhe aktivitete informimi dhe ndërgjegjësimi rreth fenomenit të bulizmit në shkolla. Ky Plan Kombëtar zgjati vetëm 3 muaj.
- Më 2016 Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe

Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me mbështetjen e UNICEF kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon rritjen e efikasitetit të ndërveprimit institucional në funksion të sigurisë online për fëmijët. Marrëveshja ka për qëllim rritjen dhe promovimin e sigurisë online të fëmijëve ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi, rreziqet dhe kërcënimet që vijnë nga përdorimi i internetit në Shqipëri. Në mënyrë indirekte fëmijët mbrohen dhe nga bulizmi kibernetik.

- Më 2016 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me CRCA, ALO 116, dhe UNICEF kanë organizuar takime me nxënësit e shkollave 9 -vjeçare në Bashkinë Elbasan, si dhe në shkolla të tjera të bashkive të tjera. Nxënësit në orët e hapura janë informuar dhe ndërgjegjësuar si të përdorin internetin, si mund të mbrohen për të garantuar përdorim të sigurt të internetit, mbi mënyrat e raportimit të rasteve të abuzimit online, për shërbimet e linjës së këshillimit për fëmijët ALO 116. Në takim morën pjesë dhe përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilit informuan nxënësit për aktivitet që po organizohen në kuadër të Planit të Mobilizimit. U përcollën mesazhe mbi format e dhunës, pasojat negative që ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve.
- **Linja e këshillimit telefonik ALO 116:** Kjo linjë u ofron mbështetje dhe këshillim pa pagesë dhe anonime të gjithë fëmijëve në Shqipëri. Nga ky shërbim përfitojnë dhe nxënësit e shkollave 9 – vjeçare të bashkisë Elbasan. Në raste të nevojshme për ndihmë të mëtejshme nxënësit referohen pranë NJMF –ve pranë bashkisë Elbasan ku menaxhohet në vazhdimësi rasti.

2.16.2 Masat parandaluese të ndërmarra në disa nga shtetet në Europë

Ndryshe nga në Shqipëri, në Gjermani janë ndërmarrë një sërë masash parandaluese kundër bulizmit. Gjithashtu janë ndërmarrë orvatje të ndryshme të trajtimit të fenomenit të bulizmit në shkolla.

Ndër masat kryesore të ndërmarra në bashkinë e Mynih –ut mund të përmenden:

- **Ministria e Arsimit dhe e Kulturës së Landit të Bajern –it**, në bashkëpunim me mësuesit dhe me stafin psiko – social e të gjitha shkollave të Landit të Bajern –it, filloi në vitin shkollor 2011/2012 projekti “Shkolla - vend jetese pa bulizëm”. Ky projekt u ofron këshillim shkollave rreth bulizmit dhe parandalimit të tij; trajnime dhe kualifikime të mëtejshme për mësuesit në lidhje me këtë fenomen, takime dhe këshillim për prindërit rreth bulizmit si dhe këshillim dhe trajtim të rasteve konkrete të bulizmit
- **Qendra e Informacionit për të Rinjtë**, ofron një herë në muaj, kryesisht të mërkurën e fundit të vitit, nga ora 14 - 17 këshillim pa pagesë dhe anonim nga me fokus kryesor bulizmin. Datat e zhvillimi të këshillimit janë të pasqyruara në faqen zyrtare të organizatës. Këshillimet nga specialistët e fushës bëhen individuale, por dhe në grup, ndaj janë të mirëpritur jo vetëm të rinjtë, por edhe prindërit, mësuesit apo dhe personat e tjerë kujdestarë. Gjithashtu nga kjo qendër ofrohen gjithashtu dhe seminare për fëmijët, mësuesit, prindërit dhe personat e tjerë të interesuar rreth bulizmit.
- **Universiteti “Ludwig-Maximilians” i Mynih –ut**, përkatësisht Qendra Kërkimore Shkencore pranë Fakultetit të Psikologjisë dhe Pedagogjisë ka ndërmarrë projekte dhe studime të shumta rreth bulizmit në 10 vitet e fundit. Rezultatet e këtyre projekteve ndihmojnë mjaft në njohjen më të mirë të fenomenit të bulizmit në këtë bashki dhe në marrjen e masave sa më të përshtashme dhe efektive për parandalimin dhe trajtimin e bulizmit në shkolla.
- **Qendra evangjelistike e këshillimit e Mynih –ut** ofron gjithashtu informacione psikologjike dhe këshillim veçanërisht për nxënësit, prindërit dhe mësuesit. Pjesë e kësaj qendre është dhe grupi antibulizëm, grup i përbërë nga nxënës dhe të rritur të cilët kanë përjetuar dikur bulizëm.
- **Këshillimi në internet** në bashkinë e Mynih –ut, si dhe në të gjitha bashkitë e Gjermanisë, ndaj nxënësve të përfshirë në bulizëm ofrohet nëpërmjet faqeve të ndryshme të internetit dhe forumeve të ndryshme online. Këto faqe apo forume kanë

në fokus të tyre dhe fenomenin e bulizmit dhe në to ofrohet ndihmë për të gjithë individët e interesuar në të gjithë Gjermaninë rreth bulizmit.

- **Këshillimi telefonik** është gjithashtu i mundshëm për nxënësit të cilët përfshihen në bulizëm. Telefonatat janë pa pagesë dhe anonime. Në to ofrohen këshillim telefonik dhe individual në lidhje me çështjet e bulizmit për fëmijët dhe të rinjtë.

Ndër masat kryesore të ndërmarra në Mbretërinë e Bashkuar mund të përmenden:

- **Java kombëtare anti - bulizëm**, e cila organizohet kryesisht në javën e tretë të muajit nëntor, nga data 12 deri në 16 nëntor dhe gjatë së cilës organizohen aktivitete të ndryshme social – kulturore me fokus kryesor ndërgjegjësimin e mbarë komunitetit rreth fenomenit të bulizmit.

Java anti – bulizëm organizohet nga Alianca Anti – Bulizëm në Angli, e cila përbëhet prej 140 organizata anëtare. Në Irlandën Veriore kjo javë koordinohet nga Forumi Anti – Bulizëm i Irlandës Veriore. Ky forum përbëhet prej 25 organizata anëtare nga sektori vullnetar dhe statutor.

Nëpërmjet pjesëve të ndryshme teatrale, filmave e shfaqeve apo dhe artit në rrugë synohet ndërgjegjësimi i mbarë komunitetit për të qenë pjesë aktive e zgjidhjes së fenomenit problematik të bulizmit. Konkurse teatrale, xhirime filmash me metrazh të shkurtër, shfaqje të ndryshme me tematikë kryesore bulizmin vazhdojnë të organizohen në shkolla gjatë gjithë vitit, në mënyrë që nxënësit dhe aktorët e tjerë në shkollë dhe në komunitet të jenë sa më të mirëinformuar dhe vigjilent ndaj akteve buliste, që ndodhin rreth tyre.

- **Aleanca Anti – Bulizëm** është një bashkëpunim organizatash dhe individësh të cilët kanë si qëllim të përbashkët të ndalojnë të gjitha format e bulizmit nëpërmjet fëmijëve dhe të rinjve. Kjo aleancë synon rritjen e ndërgjegjësimit ndaj bulizmit nëpërmjet fushatave dhe programeve të cilët ndihmojnë në zbutjen e bulizmit dhe sjellin një ndryshim afatgjatë në cilësinë e jetës së fëmijëve. Ajo operon në nivel kombëtar dhe lokal.

Aleanca mbështet procesin e të mësuarit dhe ndan eksperiencat ndërmjet anëtarëve të saj. Rrjeti i saj i bashkëpunimit në shkolla dhe kolegje vjen dhe rritet vazhdimisht. Të qenit pjesë e kësaj aleance është pa pagesë.

Çdo nëntor, Aleanca Anti – Bulizëm koordinon javën Anti – Bulizëm me qëllim që të ndriçojë sado pak në fenomenin e bulizmit dhe të inkurajojë të gjithë fëmijët, mësuesit dhe prindërit, që të marrin nisma kundër bulizmit gjatë vitit.

- **Organizata Kidscape**, e krijuar që prej vitit 1985, është organizata e parë bamirëse, e cila identifikon dhe trajton aktet buliste në shkolla dhe u ofron asistencë praktike fëmijëve dhe familjeve të përfshira në bulizëm.

Masat kryesore të ndërmarra në Itali

Në sistemin ligjor italian nuk ekziston një përkufizim ligjor për bulizmin. Për momentin nuk ekziston asnjë ligj specifik për ndalimin apo dënimin e bulizmit, por në legjislacionin ekzistues (Kushtetuta e Republikës së Italisë, pjesa e parë, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, Kodi Civil, Kodi Penal) thuajse ekziston një mekanizëm i plotë rregullues për të parandaluar bulizmin dhe për të siguruar mjetet e ndërkohës të sjelljeve buliste kriminale. Në aspektin rajonal, edhe pse në sistemin ligjor nuk ekzistojnë ligje kombëtare anti – bulizëm në vetvete, rajoni i Lacio – është i pari rajon, i cili ka miratuar dhe po adopton një projektligj për parandalimin dhe luftimin e çdo forme të bulizmit me qëllim ruajtjen e zhvillimit shoqëror, psikologjik dhe edukativ të fëmijëve. Autoriteti rajonal i bashkisë së Lacio –s ka miratuar ligjin rajonal nr. 2, datë 24 mars 2016, i cili përmban dispozita për të parandaluar dhe menaxhuar fenomenin e bulizmit. Ky ligj, i cili përbëhet nga 7 artikuj, inkurajon dhe mbështet në aspektin financiar zbatimin afatgjatë të shumë projekteve, të cilët kanë në fokus të tyre fenomenin e bulizmit. Bazuar në këtë ligj shumë institucione përkatëse u ofrojnë edhe ndihmë ligjore personave të përfshirë në bulizëm.

Në rang ndërkombëtar zbatohen programe të ndryshme anti – bulizëm. Ndër to më shumë i aplikueshëm është programi anti – bulizëm KiVa.

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

3.1 Metoda dhe plani i studimit

Ky kërkim shkencor ka në fokus të tij fenomenin e bulizmit, duke marrë në konsideratë aktet buliste të kryera vetëm ndërmjet nxënësve në shkolla. Metodatat shkencore të përdorura për të njohur dhe për të përshkruar sa më saktë fenomenin e bulizmit ishin metoda sasiore (të dhënat u mblodhën nëpërmjet anketimit) dhe metoda cilësore (të dhënat u mblodhën nëpërmjet fokus - grupit dhe nëpërmjet intervistave individuale me nxënës të përfshirë në bulizëm si në rolin e viktimës, ashtu dhe në atë të autorit).

Disa kërkues sugjerojnë, që në një studim të përdoret kombinim i metodave të ndryshme (Monsk etj., 2003; Pellegrini dhe Bartini, 2000). Kjo gjë jo vetëm që mundëson një analizë më të thellë të fenomenit të bulizmit.

Në këtë kërkim shkencor u aplikua metoda sasiore, me qëllim që të mund të siguroheshin të dhëna sa më të shumta dhe objektive për një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Nëpërmjet pyetësorëve, të cilët plotësohen nga kampionimi i një popullate të caktuar, sigurohen të dhëna, të cilat më pas mund të përpunohen statistikisht (Babbie, 1990; Fowler, 1988). Për t'iu përgjigjur në mënyrë sa më të saktë dhe sa më objektive pyetjeve kërkimore, si dhe për të testuar hipotezën e hedhur në kërkim, gjatë këtij kërkimi u realizuan një anketim, një fokus – grup, si dhe intervista individuale.

Fokus - grupi sipas Lederman (Thomas dhe të tjerë, 1995) është një teknikë e cila përmban përdorimin e intervistave të thelluara në grup. Pjesëmarrësit në fokus - grup janë individë, të cilët kanë një informacion apo një lidhje të caktuar me temën që do të trajtohet në grupin e fokusit. Të dhënat dhe informacionet që merren nga ndërveprimi social i grupit janë shpesh më të thella dhe më të pasura se ato që mund të merren nga intervistat individuale. Gjithsesi intervistat individuale janë më të dobishme, nëse duam të sigurojmë informacion më të detajuar dhe më të thellë rreth eksperiencave personale të individëve të përzgjedhur për t'u intervistuar rreth një teme të caktuar (Converse dhe Schuman, 1974). Ndaj dhe për të kuptuar më mirë arsyet dhe pasojat e bulizmit, intervistat individuale të personave të përfshirë në bulizëm mund të mundësojnë një kuptim më të thellë të fenomenit.

Anketimi

Anketimi, i cili u krye nëpërmjet pyetësorit antibulizëm të Olweus – it, u realizua duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Përcaktimi i popullatës teorike mbi të cilat u krye anketimi;
- Ndërtimi i kampinimit;
- Përkthimi dhe validimi i pyetësorit. Pyetësori u përkthye nga një përkthyes fillimisht nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe më pas nga një përkthyes tjetër nga gjuha shqipe në gjuhën angleze. Në të dy rastet përkthimi u krye nga dy përkthyes të licencuar. Gjithashtu në pyetësor u modifikuan dy variabla; përkatësisht në pyetjen e 40 të pyetësorit variablat ekzistues amerikan, amerikan indian, amerikan afrikan, amerikan latin dhe tjetër u zëvendësuan me popullsi e përgjithshme, rom dhe egjiptian. Një modifikim i tillë u krye që pyetësori të ishte sa më i përshtatshëm me kulturën dhe origjinën e nxënësve, që do të plotësonin pyetësorin.
- Realizimi i anketimit në terren. Për kryerjen e këtij anketimi u mor leja përkatëse nga Drejtoria Rajonale Arsimore (DAR) Elbasan, si dhe leja nga prindërit e nxënësve të anketuar, të cilëve iu sqaruan me hollësi çfarë është bulizmi, qëllimet, objektivat, përfitimet dhe mënyrën e kryerjes së anketimit në kuadër të këtij studimi. Gjithashtu ato u siguruan për anonimatën e fëmijëve të tyre dhe iu kërkua që të mos flisnin paraprakisht me fëmijët e tyre për këtë anketim, me qëllim që ato të mos ndikoheshin në përgjigjet e tyre nga prindërit e tyre. Gjithashtu dhe nxënësve të anketuar pasi u mor pëlqimi i tyre për të qenë i anketuar, iu dha informacioni i duhur për bulizmin, iu sqarua çdo paqartësi në lidhje me pyetjet dhe procedurën e plotësimit të pyetësorit si dhe u siguruan që të dhënat e tyre do të mbeten konfidenciale. Përpara kryerjes së pyetësorit secilit prej nxënësve të përfshirë në anketim iu mor me shkrim pëlqimi i informuar dhe u siguruan rreth anonimitetit dhe konfidencialitetit të të dhënave të tyre;

- Testimi pilot i pyetësorit për të evidentuar qartësinë, kuptueshmërinë dhe përshtatshërinë e tij. Testimi pilot i pyetësorit u realizua me nxënës nga e njëjta popullatë e studimit;
- Realizimi i anketimit. Nxënësve iu sqarua në detaje çdo hap i plotësimit të pyetësorit dhe për çdo paqartësi iu dha ndihma e nevojshme.
- Kohëzgjatja e anketimit ishte 2 orë mësimore, në mënyrë që nxënësit ta plotësonin atë në mënyrë të qetë dhe jo nën tryshninë e kohës;
- Seleksionimi i pyetësorëve të vlerësuar si të rregullt. Ndër 800 pyetësorë të plotësuar nga pjesëmarrësit në anketim 727 prej tyre ishin plotësuar saktë.
- Hapja e bazës së të dhënave;
- Futja e të dhënave në bazën e të dhënave;
- Analiza statistikore sipas parametrave të kërkuar nëpërmjet programit SPSS;
- Interpretimi i të dhënave.

3.2 Popullata e kërkimit shkencor

Popullata e këtij kërkimi shkencor janë nxënësit që frekuentojnë ciklin e mesëm të ulët, pra nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë të shkollave 9 vjeçare të Bashkisë Elbasan, nxënës të moshës nga rreth 12 – 15 vjeç; mosha mesatare e nxënësve 13.5 vjeç. Në studim u përfshirë shkollat nëntë vjeçare të Bashkisë Elbasan, sipas ndarjes së vjetër administrative territoriale përpara muajit qershor 2015.

Bazuar në listën e shkollave 9 vjeçare të marrë pranë DAR Elbasan, në Bashkinë e Elbasanit operojnë 25 shkolla 9 - vjeçare. Ndër to 21 janë shkolla publike dhe 4 janë shkolla private. Në studim u përjashtua vetëm shkolla 9 vjeçare speciale “Zëra Jete” duke patur parasysh specifikën e problemeve të shëndetit mendor që kanë nxënësit që frekuentojnë këtë shkollë.

Popullata e shkollave 9 – vjeçare përbëhet nga 4148 nxënës, ndër to 1951 janë vajza dhe 2197 janë djem. Në klasën e gjashtë e frekuentojnë shkollën 973 nxënës, ndër to 460 vajza dhe 513 djem; në klasën e shtatë 1016 nxënës, ndër to 481 vajza dhe 535 djem; në

klasën e tetë 977 nxënës, ndër to 450 vajza dhe 527 djem dhe në klasën e nëntë 1182 nxënës, ndër to 560 vajza dhe 622 djem.

Shkolla	Klasa VI			Klasa VII			Klasa VIII			Klasa IX		
Shkolla	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej
Arianiti	4	4	8	6	5	11	2	4	6	7	8	15
Imelda Lambertini	14	16	30	15	12	27	14	16	30	12	14	26
Green School	0	2	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rahma School	9	9	18	9	11	20	11	7	18	9	11	20
Fadil Gurmani	24	16	40	22	20	42	27	14	41	24	22	46
Adem Krasniqi	18	14	32	17	17	34	10	9	19	20	17	37
Ali Agjahu	30	25	55	32	29	61	41	30	71	38	33	71
Bardhyl Popa	20	20	40	27	24	51	30	21	51	39	40	79
Fejzulla Guranjaku	6	2	8	7	7	14	6	4	10	9	7	16
Hamit Mullisi	25	13	38	18	19	37	25	18	43	20	23	43
Sulë Domi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Jeronim De Rada	34	38	72	26	32	58	32	23	55	36	34	70
Jorgji Dilo	38	43	81	49	41	90	48	38	86	74	74	148
Luigj Gurakuqi	30	35	65	39	32	71	29	35	64	35	32	67
Naim Frashëri	44	45	89	71	49	120	40	37	77	53	49	102
Onufri	9	13	22	11	9	20	16	11	27	18	8	26
Ptoleme Xhuvani	20	18	38	16	24	40	25	18	43	27	21	48
Qamil Guranjaku	44	32	76	30	22	52	45	42	87	46	46	92
Qemal Haxhihasani 1	24	15	39	38	26	64	26	22	48	37	30	67
Qemal Haxhihasani 2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sulë Misiri	8	9	17	14	11	25	17	12	29	20	18	28

Xhaferr Hakani	23	23	46	16	20	36	15	24	39	24	18	42
Abdyl Paralloi	36	13	49	25	22	47	28	14	42	27	20	47
Sulë Harri	45	55	100	47	49	96	40	51	91	57	35	92
Total	513	460	973	535	481	1016	527	450	977	622	560	1182
Total Vajza	1951											
Total Djem	2197											
Total Nxënës	4148											

Tabela 4: Popullata e përgjithshme e marrë në studim, në Bashkinë e Elbasanit

Në studim u përzgjedhën shtatë shkolla dhe popullata e këtyre shkollave përbëhet prej 2103 nxënës në total, ndër to 991 janë vajza dhe 1112 janë djem. Në klasën e gjashtë e frekuentojnë shkollën 479 nxënës, ndër to 236 vajza dhe 243 djem; në klasën e shtatë 536 nxënës, ndër to 246 vajza dhe 290 djem; në klasën e tetë 482 nxënës, ndër to 226 vajza dhe 256 djem dhe në klasën e nëntë 606 nxënës, ndër to 283 vajza dhe 323 djem.

Shkolla	Klasa VI			Klasa VII			Klasa VIII			Klasa IX		
Shkolla	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej	Djem	Vajza	Gjithsej
Ali Agjahu	30	25	55	32	29	61	41	30	71	38	33	71
Bardhyl Popa	20	20	40	27	24	51	30	21	51	39	40	79
Jorgji Dilo	38	43	81	49	41	90	48	38	86	74	74	148
Luigj Gurakuqi	30	35	65	39	32	71	29	35	64	35	32	67
Naim Frashëri	44	45	89	71	49	120	40	37	77	53	49	102
Abdyl Paralloi	36	13	49	25	22	47	28	14	42	27	20	47
Sulë Harri	45	55	100	47	49	96	40	51	91	57	35	92
Total	243	236	479	290	246	536	256	226	482	323	283	606
Total Vajza	991											
Total Djem	1112											
Total Nxënës	2103											

Tabela 5: Popullata e shkollave të anketuara

3.3 Kampionimi

Kampionimi i këtij studimi nga pikëpamja statistikore u përcaktua duke marrë në konsideratë faktin që marxhi statistikor i kampionimit të mos jetë më i madh se $\pm 3.3\%$ dhe niveli i besueshmërisë të jetë 95%. Për të patur mundësi që të dhënat sasiore të ishin sa më të sakta dhe objektive kampionimi i studimit u përbë nga 800 nxënës. Nga 800 nxënës të cilët plotësuan pyetësorët përkatës, mbas kontrollimit të tyre, vetëm 727 nxënës i kishin plotësuar saktë ato. Në bazë të analizës statistikore të të dhënave sasiore u konstatua se nga këto 727 nxënës 318 (43.7%) janë vajza dhe 409 (56.5%) janë djem.

Në studim vetëm shkollat u përzgjedhën në mënyrë jorastësore. Kjo përzgjedhje u bë duke u bazuar në kriterin e madhësisë së shkollës, shtatë shkolla me numrin më të madh të nxënësve, duke patur parasysh faktin që fenomeni i bulizmit shfaqet më shumë dhe mund të studiohet dhe më mirë në shkollat me numër të madh nxënësish.

Kampionimi i këtij studimi është i shtresëzuar dhe rastësor. Gay (Gei) (1987) raporton se kampionimi rastësor është mjeti i vetëm dhe më i mirë për të siguruar një kampion përfaqësues të popullatës teorike të një kërkimi. Asnjë teknikë, madje as kampionimi rastësor nuk garanton një kampion plotësisht përfaqësues të popullatës teorike, por probabiliteti për të patur një kampion sa më shumë përfaqësues të popullatës teorike është më i madh nëpërmjet kampionimit të rastësishëm.

Gay gjithashtu pranon se kampionimi i shtresëzuar rastësor është i duhuri për të mundësuar krahasime propocionale dhe kuptimplote midis nën – grupeve në popullatën teorike. Leary (Lleri) (1995) sugjeron se kampionimi i shtresëzuar dhe rastësor në mënyrë tipike pasqyron karakteristikat e popullatës teorike në tërësi.

Stratifikimi (Shtresëzimi) u ndërmorr duke u bazuar në kriterin e shkollave me numër më të madh nxënësish dhe në kriterin e klasës. Si hap i parë nga popullata e studimit u stratifikuan në mënyrë jorastësore 7 shkollat me numër më të madh nxënësish dhe më pas popullata e këtyre shkollave u stratifikua në mënyrë deri diku propocionale jorastësore në çdo nivel klase. Në të shtatë shkollat e përzgjedhura u shpërndanë rreth 115 pyetësorë; mbas përcaktimit të pyetësorëve të plotësuar saktë u konstatua se ishin shpërndarë përkatësisht 173 pyetësorë në klasën e gjashtë, 198 pyetësorë në klasën e shtatë, 176

pyetësorë në klasën e tetë dhe 180 pyetësorë në klasën e nëntë. Në secilën prej shtatë shkollave përzgjedhja në secilën nivel klase u bë në mënyrë rastësore. Njërës prej klasave paralele të secilës nivel klase, pra nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë iu shpërndanë rreth 26 pyetësorë.

3.4 Instrumenti matës: Pyetësi Antibulizëm i Olweus - it dhe karakteristikat e tij

3.4.1 Informacione të përgjithshme

PABO - it është një pyetësor i standartizuar, i validuar dhe me përgjigje me shumë alternativa, i hartuar për të matur një numër aspektesh të problemeve të bulizmit në shkolla. PABO - it i cili përbëhet prej 40 pyetjesh (disa prej tyre kanë dhe nënpyetje) është i përshtatshëm për t'u plotësuar nga nxënësit nga klasa e tretë deri në atë të dymbëdhjetë. Nxënësit i përgjigjen pyetësorit në mënyrë anonime.

PABO - it është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë përfshihen pyetje rreth pësimit të akteve buliste (nga pyetja 4 deri në pyetjen 24) nga ana e të anketuarve, ndërsa në pjesën e dytë përfshihen pyetje rreth kryerjes së akteve buliste (nga pyetja 25 deri në pyetjen 40) nga ana e të anketuarve.

Pyetësi ka karakteristikat e mëposhtme:

- Ai u paraqet nxënësve një përcaktim të detajuar rreth bulizmit, në mënyrë që ato ta kuptojnë qartë fenomenin e bulizmit dhe t'u përgjigjen në mënyrën e duhur pyetjeve të pyetësorit;
- Shumica e pyetjeve i referohen një kohe specifike ose një periudhe referuese, e cila është “muajt e fundit” (pas pushimeve dimërore/verore). Kjo konsiderohet që është një kohëzgjatje e përshtatshme kohe për nxënësit, që t'i kujtojnë përvojat e tyre buliste;
- Alternativat e përgjigjeve janë hartuar në një mënyrë specifike duke përdorur shprehje të tilla si “2 ose 3 herë në muaj” dhe “ rreth 1 herë në javë “. Këto shprehje janë hartuar në mënyrë të tillë për të shmangur sa më shumë që të jetë e mundur periudhat dhe shprehjet subjektive si “Shpesh” dhe “Shumë shpesh”, të cilat mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga nxënësit;

- Krahas dy pyetjeve të përgjithshme rreth rënies pre e akteve buliste dhe kryerjes së akteve buliste (Pyetja 4 dhe 24), në pyetësor nxënësve u shtrohen dhe pyetje paralele rreth nëntë formave specifike të bulizmit, rreth të rënit pre e akteve buliste (Pyetjet 5 – 13) dhe rreth kryerjes së akteve buliste ndaj nxënësve të tjerë (Pyetjet 25 – 33);
- Pyetësi përmban disa pyetje rreth reagimeve të nxënësve dhe të rriturve të tjerë kundrejt bulizmit, e parë në këndvështrimin si e perceptojnë të anketuarit sjelljet dhe qëndrimet e mësuesve, të bashkënxënësve dhe prindërve kundrejt bulizmit;
- Pyetësi siguron informacione paraprake për zbatimin sa më efektiv të programit parandalues të bulizmit Olweus nëpër shkolla.

3.4.2 Dobitë e përdorimit të PABO – it

Anketimi i studentëve rreth bulizmit ofron një ndihmë të konsiderueshme në zbatimin e programit parandalues të bulizmit në shkolla duke:

- siguruar informacione të detajuara dhe të besueshme rreth sjelljeve dhe qëndrimeve buliste si dhe problemet e lidhura me to në ambjentin e shkollës. Gjithashtu ai shërben dhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe motivimin nga ana e stafit të shkollës, nxënësve dhe prindërve për t'u përfshirë më shumë në evidentimin, trajtimin dhe parandalimin e akteve buliste;
- siguruar informacione, të cilët janë mjaft të rëndësishëm për planifikimin e orvatjeve parandaluese të bulizmit, duke i vlerësuar këto orvatje dhe duke riorganizuar mbikëqyrjen në zona specifike në shkolla. Të dhënat sasiore gjithashtu sugjerojnë mënyrat se si bulizmi ndikon klimën e shkollës;
- siguruar një bazë të dhënash me anë të të cilave mund të matet progresi dhe ndryshimi në kohë.

3.4.3 Cilësitë psikometrike të pyetësorit

PABO - it i është nënshtruar testeve rigoroze psikometrike ndër vite për të siguruar që të dhënat e mbledhura nga ai të mund të përdoren për të kuptuar në mënyrë të saktë përhapjen e fenomenit të bulizmit dhe për të ndihmuar në hapat e mëtejshëm efektiv

të programit anti bulizëm në shkolla. Studimet e shumta, kur morën si njësi analize subjektet individuale, shumat dhe mesataret e grupeve të pyetjeve rreth të rënies pre e akteve buliste dhe të kryerit akte buliste, konstatuan se ato shfaqën një besueshmëri të konsistencës së brendshme të alfës së Cronbach – ut në nivelet nga 0.80 deri 0.95 (Pellegrini, 2001; Solberg dhe Olweus 2003; Olweus 2013) si dhe një besueshmëri të konsistencës së brendshme së vlefshmërisë së ndërtimit (Kyriakides, Kaloyirou dhe Lindsay, 2006; Solberg dhe Olweus, 2003) dhe vlefshmëri të kriterëve të lidhura, e cila ka arritur vlera nga 0.40 deri 0.60 (Olweus, 2010, 2012; Pellegrini 2001).

Bashkarisht këto matje dëshmojnë që rezultatet e përfituara nga pyetësi ilustrojnë saktësisht përhapjen e bulizmit në shkolla.

3.5 Fokus - grupi

Nëpërmjet anketimit, të realizuar nëpërmjet pyetësorit të Olweus – it, u synua kryesisht të matet sa i përhapur është fenomeni i bulizmit në ambjentet e shkollave dhe jashtë saj, cilat janë format dhe vendet ku kryhen më shpesh aktet buliste si dhe sa dhe kujt i raportohen aktet buliste. Në këtë anketim u përfshinë vetëm nxënësit, pasi ky pyetësor është hartuar për t'u plotësuar vetëm nga nxënësit.

Të gjithë partnerët në shkollë, duke përmendur këtu punonjësit arsimor të institucioneve arsimore, punonjësit e shërbimit psiko – social, prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit, bashkëpunojnë për zhvillimin e përvojave që ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë në zhvillimin e konceptit për veten, në ndërtimin e marrëdhënieve personale dhe ndërpersonale. Duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm që luajnë aktorët e lartpërmendur për të njohur, adresuar dhe përmbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm, në këtë studim u synuar të përfshihen dhe mendimet dhe perceptimet e tyre në lidhje me përhapjen dhe parandalimin e fenomenit të bulizmit në shkolla. Këto mendime dhe perceptime të tyre rreth përhapjes dhe parandalimit të bulizmit në shkolla u mbledhën nëpërmjet metodës së fokus - grupit.

Synimi kryesor i këtij fokus - grupi ishte vlerësimi i fenomenit të bulizmit, i perceptuar nga ana e pjesëmarrësve në fokus - grup dhe njëkohësisht dhe konsultimi i tyre

rreth strategjive evidentuese, ndërgjegjësuere, trajtuese dhe parandaluese të fenomenit të bulizmit në shkolla. Fokus - grupi u realizua gjithashtu dhe me qëllim për të mësuar se çfarë mendonin pjesëmarrësit e përfshirë në fokus - grup rreth bulizmit si dhe për të gjeneruar diskutim rreth këtij fenomeni, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, përvojave dhe ideve të tyre.

Tradicionalisht, metoda e fokus - grupit është “një mënyrë për të mbledhur të dhëna cilësore, të cilat – para së gjithash, në thelb – përfshijnë angazhimin e një grupi të vogël njerëzish në një diskutim joformal në grup me fokus rreth një teme apo çështje të caktuar, për të cilën të gjithë pjesëmarrësit në grupin e fokusit janë të interesuar” (Wilkinson, 2004). Kërkuesit në shkencat sociale në përgjithësi dhe veçanërisht kërkuesit, të cilët synojnë të mbledhin të dhëna cilësore, mbështeten tek grupet e fokusit për të mbledhur të dhëna nga shumë individë njëkohësisht. Fokus - grupet janë më pak kërcënuese për pjesëmarrësit në kërkim dhe ambjenti jofrikësues i fokus - grupit i ndihmon pjesëmarrësit të diskutojnë lirshëm dhe të shprehin perceptimet, idetë, opinionet dhe mendimet e tyre (Krueger dhe Casey, 2000); (Krueger, R. A., & Casey, M. A. (2000); (Focus groups: A practical guide for applied researchers (Botimi i tretë.). Thousand Oaks, CA: Sage).

3.5.1 Përbërja e fokus - grupit

Fokus - grupi karakterizohet nga parimi i homogjenitetit, por njëkohësisht edhe nga parimi i ndryshimit dhe dallueshmërisë së mjaftueshme midis pjesëmarrësve të fokus - grupit me qëllim që të mundësohet dhe shkëmbimi dhe diskutimi i mendimeve të ndryshme dhe të kundërta. Me parimin e homogjenitetit kuptohet se pjesëmarrësit e fokus – grupit kanë diçka të përbashkët, për të cilën ato janë të interesuar të diskutojnë dhe të shkëmbejnë informacione. Numri ideal i pjesëmarrësve në një fokus - grup është 8 deri në 12 pjesëmarrës.

Popullata e grupit të fokusit u përbë nga 12 pjesëmarrës.

- 4 mësues kujdestar
- 1 përfaqësues nga këshilli i prindërve
- 1 përfaqësues nga komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit
- 2 përfaqësues nga qeveria e nxënësve

- 1 përfaqësues nga njësia vendore arsimore
- 1 përfaqësues nga njësia bazë e qeverisjes vendore
- 2 psikologë shkollor

Arsyet pse u përzgjedhën në mënyrë të tillë pjesëmarrësit në fokus - grupit janë si më poshtë vijnë:

4 mësues kujdestarë: Duke marrë në konsideratë faktin që mësuesi kujdestar përkujdeset në mënyrë të veçantë të krijojë një atmosferë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi midis nxënësve, bashkëpunon ngushtë me psikologun dhe/ose punonjësin social dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me prindërit e nxënësve të klasës që ka në kujdestari, u përfshinë në grupin e fokusit katër mësues kujdestar të secilës klasë, pra një mësuesit kujdestar të klasës së gjashtë, të klasës së shtatë, të klasës së tetë dhe të klasës së nëntë.

2 përfaqësues nga këshilli i prindërve: U përzgjedhën kryetari dhe një anëtar i këshillit të prindërve pasi ato janë personat përgjegjës që të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve të institucionit arsimor. Prindërit janë personat të cilët duhen të kujdesen që fëmijët e tyre të ndjekin rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojnë rregullisht. Ato gjithashtu duhet të njoftojnë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijëve të tyre dhe të marrin pjesë në takimet për fëmijët e tyre dhe me prindërit e klasës si dhe të japin ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit. U përzgjedhën dy përfaqësues nga këshilli i prindërve të dy shkollave të ndryshme.

1 përfaqësues nga komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit: U përzgjedh kryetari i këtij komisioni pasi ai është personi përgjegjës për mbikëqyrjen në institucionin arsimor të kushteve të ruajtjes së shëndetit, higjenës, pastërtisë, mjedisit si dhe sigurisë së nxënësve në ambjentet shkollore. Ai është gjithashtu dhe personi përgjegjës për organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuere me nxënës, mësues, prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë në institucionin arsimor.

2 përfaqësues nga qeveria e nxënësve: U përzgjedhën kryetari dhe një anëtar i qeverisë së nxënësve duke marrë parasysh faktin që ato janë dy prej personave përgjegjës për kontribuimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës – nxënës dhe nxënës – mësues. Gjithashtu ato janë dy prej personave përgjegjës për të

mbrojtur dhe promovuar të drejtat e nxënësve si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e shkollës.

1 përfaqësues nga njësia vendore arsimore: U përzgjedh një nga personat përgjegjës të njësisë së shërbimit psiko-social, pasi ai është personi, i cili bashkëpunon me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve për të trajtuar çështje të abuzimit dhe mbrojtjes së fëmijëve; komunikon rregullisht me organizma qeveritare dhe joqeveritare për rastet e fëmijëve në rrezik dhe me vështirësi sociale dhe ekonomike si dhe njofton me shkrim organet përkatëse çdo fakt për abuzimin e nxënëve.

1 përfaqësues nga njësia bazë e qeverisjes vendore: Një përfaqësuese nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Elbasan, përkatësisht specialistja nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pasi kjo njësi është struktura e cila shërben si qendër informacioni ku fëmijët dhe familjet mund të informohen apo të referohen tek shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë. Ajo është gjithashtu struktura e cila raporton periodikisht në Agjensinë Shtetërore të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, të dhënat statistikore dhe informacion mbi situatën e mbrojtjes së fëmijëve.

2 psikologë shkollor: U përzgjedh psikologu i shkollës, pasi ai në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese. Gjithashtu ai është personi përgjegjës, i cili ndihmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj..

Mësuesit kujdestar, përfaqësuesit nga këshilli i prindërve, përfaqësuesit nga qeveria e nxënësve, përfaqësuesi nga komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit, si dhe dy psikologët shkollorë u përzgjedhën në mënyrë rastësore, përta i përket individëve, ndërkohë që u përzgjedhën në mënyrë jorastësore përta u përket përfaqësimit të shkollave përkatëse. Këto individë u përzgjedhën nga shkolla të ndryshme 9 vjeçare të bashkisë Elbasan, me qëllim që të shkëmbeheshin informacione dhe përvoja dhe nga shkolla të tjera të papërfshira në studim.

3.5.2 Proçedura e ndjekur në zhvillimin dhe analizën e grupit të fokusit

- Në mënyrë rastësore u përzgjedh një nga shkollat e përfshira në anketim si dhe vendi ku u realizua fokus - grupi. Fokus - grupi u zhvillua pasi u analizuan të dhënat

statistikore të siguruara nga anketimi i nxënësve në shkollat e përzgjedhura, nga ku u konstatua se fenomeni i bulizmit ishte i pranishëm në shkolla;

- U krijua fokus - grupi. Pjesëmarrësit në fokus - grup u përzgjedhën në mënyrë jorastësore, pasi për të marrë të dhëna sa më të vlefshme nga intervistat e pjesëmarrësve në grupet e fokusit, është e nevojshme që ato të kenë sa më shumë informacion rreth zhvillimit psiko – social të fëmijëve dhe të jenë sa më të përfshirë në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe nxënësve;
- Pjesëmarrësve të fokus - grupit iu bënë të qarta tematika e diskutimit, qëllimet, synimet, objektivat si dhe dobitë e këtij studimi shkencor;
- Pjesëmarrësve të fokus - grupit iu siguria se nuk do të identifikoheshin në analizën e të dhënave dhe se kontributet e tyre do të mbeteshin konfidenciale. Ato gjithashtu u informuan rreth mënyrës së botimit të rezultateve të studimit dhe u garantuan për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale. Pjesëmarrësve në fokus - grup iu mor me shkrim pëlqimi i informuar dhe u siguruan rreth anonimitetit dhe konfidencialitetit të të dhënave të tyre. Atyre iu kërkua të respektojnë natyrën konfidenciale të të gjithë informacionit të shkëmbyer brenda fokus - grupit;
- Krijimi i një ambjenti sa më komod dhe sa më të lirshëm, në mënyrë që pjesëmarrësit të ndjeheshin sa më të lirë në shprehjen hapur të mendimeve dhe ideve të tyre rreth temës së diskutuar. Fokus - grupi u zhvilluar në sallën e mbledhjeve të shkollës. Pjesëmarrësit u ulën në tavolinë në formë rrethore në mënyrë që secili të ndjehej i barabartë me tjetrin dhe të mund të kishin kontakt pamor me njëri – tjetrin gjatë diskutimit të temës;
- Diskutimi në fokus - grup u rregjistrua nëpërmjet diktosfonit dixhital dhe gjithashtu u mbajtën dhe shënime gjatë diskutimit nga ana e ndihmësit të moderatorit/ kërkuesit të grupit të fokusit;
- Diskutimi në fokus - grup zgjati rreth 1 orë e 30 minuta.
- Pas transkriptimit të diskutimit të pjesëmarrësve të fokus - grupit u realizua dhe kodimi i tyre. Mbasi u rilexuan disa herë transkriptimet e intervistave të realizuara, u përzgjedhën duke u shënuar frazat dhe fjalitë më domethënëse dhe më të vlefshme për t'i dhënë përgjigjeve pyetjeve kërkimore.

Për të mundësuar një analizë sa më të qartë u krijuan dhe kategoritë e mëposhtme:

- ❖ Masat e ndërmarra për trajtimin e bulizmit
- ❖ Evidentimi i nevojave

Secila nga këto kategori u bë më e qartë dhe nga disa nënkategori të tjera, si: referim nga mësuesi kujdestar tek psikologu, raportim të rasteve, diktutum me prindërit terapi individuale, veprimtari ekstrakurrikulare dhe trajnim i stafit pedagogjik dhe atij psiko – social, rritja e sigurisë në ambjentet e shkollës, programe parandalues afatgjatë, bashkëpunim me OJF.

3.5.3 Pyetjet kërkimore kryesore të shtruara në fokus - grup

Ky fokus - grup eksplorues përmban një kombinim pyetjesh eksploruese dhe konfirmuese. Fillimisht u parashtruan pyetje të hapura më përgjithësuese, duke vazhduar më tej me pyetje më specifike dhe kryesisht me shtrimin e pyetjeve të mbyllura.

Gjatë intervistave në grup pjesëmarrësve në fokus - grup iu shtruan pyetjet e mëposhtme:

- A janë ndërmarrë masa konkrete për të trajtuar dhe parandaluar fenomenin e bulizmit të shkollë? Nëse po, cilat janë ato?
- A duhen ndërmarrë masa të mëtejshme për ndërgjegjësimin, trajtimin dhe parandalimin e fenomenit të bulizmit në shkolla? Nëse po, cilat janë ato?

3.6. Intervistat individuale

Me qëllim për të konstatuar se cilat janë disa nga arsyet kryesore përse nxënësit përfshihen në bulizëm dhe pasojat e bulizmit tek nxënësit e përfshirë në të, si në rolin e viktimës, ashtu dhe në atë të autorit u realizuan 15 intervista individuale me nxënës të përfshirë në bulizëm.

3.6.1 Proçedura e ndjekur në zhvillimin dhe analizën e intervistave individuale

Në mënyrë jorastësore u përzgjedhën nxënësit të cilët do të intervistoheshin. Nxënësit u përzgjedhën në mënyrë të qëllimshme në bashkëpunim me psikologët dhe nxënësit e shkollave të përfshira në studim, bazuar në kriterin e të qenit i përfshirë në bulizëm.

- Në bashkëpunim dhe me psikologët dhe mësuesit u mor kontakt me prindërit e nxënësve që do të intervistoheshin dhe mbasi iu bë i qartë qëllimi i studimit dhe i intervistimit të fëmijëve të tyre, u mor pëlqimi dhe miratimi me shkrim që fëmija i tyre të intervistohej. Nga 35 nxënësit e përzgjedhur, vetëm prindërit e 22 nxënësve pranuan që fëmijët e tyre të intervistohen. Gjithashtu prindërit e nxënësve që do të intervistoheshin u siguruan në lidhje me konfidencialitetin dhe anonimitetin e të dhënave të mbledhura nga intervistat e kryera me fëmijët e tyre. Gjithashtu prindërit u siguruan që fëmijëve të tyre do t'u shmangej çdo lëndim psikologjik i mundshëm gjatë procesit të intervistimit.
- Më pas, përsëri në bashkëpunim me psikologët, mësuesit dhe prindërit përkatës, u krye një takim paraprak me nxënësit, prindërit e të cilëve kishin dhënë miratimin për intervistim. Atyre iu bënë të qarta tematika e intervistës, qëllimet, synimet, objektivat si dhe dobitë e këtij studimi shkencor. Ndër 22 nxënës, 17 nxënës pranuan të intervistohen. Gjithashtu dhe ato u garantuan në lidhje me konfidencialitetin dhe anonimitetin e të dhënave të marra gjatë intervistës dhe vetëm pasi u mor dhe miratimi me shkrim nga ana dhe e tyre për t'u intervistuar u vijua me procesin e intervistimit.
- Pyetjet e intervistës gjysëm të stukturuar u pilotuan nëpërmjet intervistimit të dy nxënësve, të cilët më pas nuk u përfshinë në grupin e nxënësve të intervistuar. Mbasi kaloi me sukses faza e pilotimit u realizua procesi i intervistimit.
- Intervistat e nxënësve u realizuan në ambjentet e zyrës së psikologut të shkollës dhe u regjistruan nëpërmjet diktofonit dixhital. Secila intervistë zgjati rreth 30 minuta.
- Pas transkriptimit të intervistave, u realizua dhe kodimi i tyre. Kodimi i tyre u krye duke përdorur shprehje, fjalë, dhe fraza. Kodimi u realizua në mënyrë manuale. Mbasi u rilexuan disa herë transkriptimet e intervistave të realizuara, u përzgjedhën duke u shënuar frazat dhe fjalitë më domethënëse dhe më të vlefshme për t'i dhënë përgjigjeve pyetjeve kërkimore.

Për të mundësuar një analizë sa më të qartë u krijuan dhe kategoritë e mëposhtme:

- ❖ Arsytet e përfshirjes në bulizëm
- ❖ Ndihma nga miqtë kur përfshihesh në bulizëm

Secila nga këto kategori u bë më e qartë dhe nga disa nënkategori të tjera, si: sjellja prosociale, model nga prindërit, statusi social – ekonomik, gjinia, origjina dhe vetëvlerësim i ulët, braktisje e shkollës, rritje e popullaritetit në shkollë, mospërfshirje në aktivitete sociale.

3.6.2 Pyetjet kërkimore kryesore të shtruara në intervistat individuale

U realizuan intervista gjysëm të strukturuar, gjatë të cilave u shtruan pyetje të specifikuar, por dhe pyetje të tjera të përgjithshme për të mundësuar që midis të nxënësve të intervistuar dhe intervistueses të mund të krijohej një komunikim sa më i lirshëm dhe më i besueshëm. Gjatë procesit të intervistimit pyetjet u organizuan bazuar në pyetjet kërkimore të studimit, përkatësisht:

- Cilat janë arsyt kryesore përse nxënësit përfshihen në bulizëm?
- A ndihmojnë miqtë në shkollë kur bie pre e akteve buliste?

3.6.3 Testimi i hipotezës

Testimi i hipotezës u realizua nëpërmjet analizave statistikore të të dhënave, përkatësisht nëpërmjet testimit të marrëdhënies midis dy variablave dhe njëkohësisht dhe nëpërmjet tabelave të kryqëzuara.

Testimi i marrëdhënieve midis variablit të pavarur dhe variablit të varur u realizua nëpërmjet koeficientit r të Pearsoni –it (Pierson -it).

Koeficienti i korrelacionit është një statistikë që bën matjen e forcës dhe drejtimit të marrëdhënies. Ai matet përmes formulës:

$$r = \frac{\sum_{i=1}^n ((x_i - \bar{x})(y_i - \bar{y}))}{\sqrt{\sum_{i=1}^n (x_i - \bar{x})^2 \sum_{i=1}^n (y_i - \bar{y})^2}}$$

ku x_1 dhe y_1 janë vlerat e variablit x dhe y , dhe $\bar{x}$ (me vizë lart) e $\bar{y}$ janë përkatësisht mesataret e variablave x dhe y . Rezultati i formulës është një vlerë midis -1 dhe $+1$.

- Një rezultat -1 (minus 1) tregon se midis dy variablave ka një marrëdhënie të përkryer negative – me fjalë të tjera, kur njëri prej variablave rritet, tjetri zvogëlohet.
- Një rezultat $+1$ (plus 1) tregon se midis dy variablave ka një marrëdhënie të përkryer pozitive: pra që me rritjen e një variabli, po ashtu rritet dhe tjetri.
- Një rezultat 0 (zero) tregon se midis dy variablave nuk ka asnjë lidhje statistikore – me fjalë të tjera, nuk ka ndonjë model të dukshëm në marrëdhënien midis dy variablave.

Sigurisht në realitet rezultati i llogaritjes rrallëherë është -1.0 ose $+1$. Afërsia e rezultatit -1 , 0 , $+1$, tregon forcën e marrëdhënies. (Matthews. B dhe Ross. L, 2010)

KAPITULLI IV: ANALIZA E TË DHËNAVE

4. 1 Përshkrimi i kampionimit

4.1.1 Shpërndarja e kampionimit duke u bazuar në gjininë, klasat që ndjekin nxënësit e anketuar dhe në origjinën e tyre.

Siç ilustron dhe në tabelën 6, 43.7% e nxënësve të anketuar janë vajza, përkatësisht 318 nxënës dhe 56.3% e nxënësve të anketuar janë djem, përkatësisht 409 nxënës.

	Numri i nxënësve	Përqindja
Vajza	318	43.7 %
Djem	409	56.3 %
Total	727	100 %

Tabela 6. Shpërndarja e kampionimit bazuar në gjininë e nxënësve të anketuar

Në tabelën 7 ilustron se 23.8% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 173 nxënës ndjekin klasën e 6 - të; 27.2% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 198 nxënës ndjekin klasën e 7 - të, 24.2% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 176 nxënës ndjekin klasën e 8 – të dhe 24.8% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 180 nxënës ndjekin klasën e 9 - të.

		Klasa				Total
		Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	
Vajza	Numri i nxënësve	77	89	77	75	318
	Përqindja	10.6 %	12.2 %	10.6 %	10.3 %	43.7 %
Djem	Numri i nxënësve	96	109	99	105	409
	Përqindja	13.2 %	15.0 %	13.6 %	14.4 %	56.3 %
Total	Numri i nxënësve	173	198	176	180	727
	Përqindja	23.8 %	27.2 %	24.2 %	24.8 %	100.0 %

Tabela 7. Shpërndarja e kampionimit bazuar në klasat që ndjekin nxënësit e anketuar

Në tabelën 8 ilustruhet se 97.5% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 708 nxënës vijnë nga popullsia e përgjithshme; 1.8% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 13 nxënës vijnë nga komuniteti Rom dhe 0.7% e nxënësve të anketuar, përkatësisht 6 nxënës vijnë nga komuniteti Egjiptian.

	Numri i nxënësve	Përqindja
Popullsia e përgjithshme	708	97.5 %
Komuniteti Rom	13	1.8 %
Komuniteti Egjiptian	6	0.7 %
Total	727	100.0 %

Tabela 8. Shpërndarja e kampionimit bazuar në origjinën e tyre

Analiza statistikore e të dhënave sasiore u realizua nëpërmjet tabelave të kryqëzuara dhe grafiqeve.

Rezultatet e të dhënave në këtë seksion japin informacione rreth përhapjes dhe formave të bulizmit në shkollat e marra në studim; ato informojnë gjithashtu drejt kujt dhe ku ndodhin aktet buliste.

Bulizmi është një sjellje agresive, e cila përsëritet herë pas here. Bazuar në sugjerimet e hartuesit të PABO – it, (M. Solberg dhe D. Olweus, 2003) nëse një nxënës pohon se ka rënë pre ose ka kryer akte buliste 1 ose 2 herë gjatë muajve të fundit, duke përzgjedhur alternativën “ka ndodhur 2 ose 3 herë”, atëherë ai klasifikohet si i jo i përfshirë në akte buliste si autor ose viktimë. Nxënësit të cilët pohojnë se kanë rënë pre ose kanë kryer akte buliste dhe që përzgjedhin alternativat “2 ose 3 herë në muaj”, “rreth rreth 1 herë në javë” dhe “disa herë në javë” klasifikohen si autorë ose viktima të akteve buliste.

4.2 Analiza statistikore e të dhënave sasiore: Përhapja e bulizmit

4.2.1 Përfshirja në bulizëm e nxënësve të anketuar

4.2.1.1 Përfshirja në bulizëm në rolin e viktimës duke marrë në konsideratë gjininë e nxënësve të anketuar

Duke marrë në konsideratë gjininë vihet re se nxënësit (djemtë) kanë rënë më shpesh pre e akteve buliste sesa nxënëset (vajzat). Dhe pse numri i nxënësve djem të përfshirë në anketim është më i madh, diferenca 3.3% (24 nxënës) midis tyre, lë të vërtetohet konstatimi i mësipërm.

		Sa shpesh keni rënë pre e akteve buliste muajt e fundit?				Total
		Nuk kam rënë pre e bulizmit	2 ose 3 herë në muaj	Rreth 1 herë në javë	Disa herë në javë	
Vajza	Numri i nxënësve	294	17	4	3	318
	Përqindja	40.4 %	2.3 %	0.6 %	0.4 %	43.7 %
Djem	Numri i nxënësve	361	33	10	5	409
	Përqindja	49.7 %	5.5 %	1.4 %	0.7 %	56.3 %
Total	Numri i nxënësve	655	50	14	8	727
	Përqindja	90.1 %	6.9 %	1.9 %	1.1 %	100.0 %

Tabela 9. Numri i nxënësve, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste

4.2.1.2 Përfshirja në bulizëm në rolin e autorit duke marrë në konsideratë gjininë e nxënësve të anketuar

Duke marrë në konsideratë gjininë vihet re se nxënësit (djemtë) kanë kryer më shpesh akte buliste sesa nxënëset (vajzat). Dhe pse numri i nxënësve djem të përfshirë në anketim është më i madh, diferenca 4.8% (34 nxënës) midis tyre, lë të vërtetohet konstatimi i mësipërm.

		Sa shpesh keni marrë pjesë në ushtrimin e akteve buliste ndaj nxënësve në shkollë në muajt e fundit?				Total
		Nuk kam qenë autor i akteve buliste në shkollë në muajt e fundit	2 ose 3 herë në muaj	Rreth 1 herë në javë	Disa herë në javë	
Vajza	Numri i nxënësve	280	26	9	3	318
	Përqindja	38.5 %	3.6 %	1.2 %	0.4 %	43.7 %
Djem	Numri i nxënësve	337	52	13	7	409
	Përqindja	46.4 %	7.2 %	1.8 %	1.0 %	56.3 %

Total	Numri i nxënësve	617	78	22	10	727
	Përqindja	84.8 %	10.7 %	3.0 %	1.4 %	100.0 %

Tabela 10. Numri i nxënësve, të cilët kanë kryer akte buliste

4.2.1.3 Përfshirja në bulizëm në rolin e viktimës duke marrë në konsideratë klasën që frekuentojnë nxënësit e anketuar

Siç ilustron dhe në tabelën 11 duke marrë në konsideratë klasën konstatohet se nxënësit e klasave të gjashta dhe të shtata bien më shpesh pre e akteve buliste sesa ato të klasave të teta dhe të nënta.

				Sa shpesh kenirënë pre e akteve buliste muajte fundit?					Total
				Nuk kam rënë pre e akteve buliste muajt e fundit	Ka ndodhur vetëm 1 ose 2 herë.	2 ose 3 herë në muaj.	Rreth 1 herë në javë.	Disa herë në javë.	
Gjinia Vajzë.	Klasa	Klasa 6	Numri i nxënësve	66		8	2	1	77
			Përqindja	20,8%		2,5%	,6%	,3%	24,2%
		Klasa 7	Numri i nxënësve	82	1	4		2	89
			Përqindja	25,8%	,3%	1,3%		,6%	28,0%
		Klasa 8	Numri i nxënësve	73		2	2		77
			Përqindja	23,0%		,6%	,6%		24,2%
		Klasa 9	Numri i nxënësve	72		3			75
			Përqindja	22,6%		,9%			23,6%
	Total		Numri i nxënësve	293	1	17	4	3	318
			Përqindja	92,1%	,3%	5,3%	1,3%	,9%	100,0%
Djalë.	Klasa	Klasa 6	Numri i nxënësve	85	2	6	2	1	96
			Përqindja	20,8%	,5%	1,5%	,5%	,2%	23,5%
		Klasa 7	Numri i nxënësve	82	5	16	2	4	109
			Përqindja	20,0%	1,2%	3,9%	,5%	1,0%	26,7%
		Klasa 8	Numri i nxënësve	89		6	4		99
			Përqindja	21,8%		1,5%	1,0%		24,2%
		Klasa 9	Numri i nxënësve	97	1	4	3		105
			Përqindja	23,7%	,2%	1,0%	,7%		25,7%
	Total		Numri i nxënësve	353	8	32	11	5	409
			Përqindja	86,3%	2,0%	7,8%	2,7%	1,2%	100,0%

Tabela 11: Numri dhe përqindja e nxënësve të rënë pre e akteve buliste muajt e fundit sipas klasave

4.2.1.4 Përfshirja në bulizëm në rolin e autorit duke marrë në konsideratë klasën që frekuentojnë nxënësit e anketuar

Siç ilustron dhe në tabelën 12, nëse marrim në konsideratë klasën, konstatohet se nxënësit e klasave të gjashta dhe të shtata kryejnë më shpesh akte buliste sesa ato të klasave të teta dhe të nënta.

				Sa shpesh keni marrë pjesë në ushtrimin e akteve buliste ndaj nxënësve në shkollë në muajet fundit?					Total
				Nuk kam kryer akte buliste në shkollë në muajet fundit	Kjo ka ndodhur vetëm 1 ose 2 herë.	2 ose 3 herë në muaj.	1 herë në javë.	Disa herë në javë.	
Gjinia Vajzë.	Klasa	Klasa 6	Numri i nxënësve	69		4	3	1	77
			Përqindja	21,7%		1,3%	,9%	,3%	24,2%
		Klasa 7	Numri i nxënësve	79	1	4	4	1	89
			Përqindja	24,8%	,3%	1,3%	1,3%	,3%	28,0%
		Klasa 8	Numri i nxënësve	72		4		1	77
			Përqindja	22,6%		1,3%		,3%	24,2%
	Total	Klasa 9	Numri i nxënësve	59		14	2		75
			Përqindja	18,6%		4,4%	,6%		23,6%
Djalë.	Klasa	Klasa 6	Numri i nxënësve	69		17	8	2	96
			Përqindja	16,9%		4,2%	2,0%	,5%	23,5%
		Klasa 7	Numri i nxënësve	90		15	2	2	109
			Përqindja	22,0%		3,7%	,5%	,5%	26,7%
		Klasa 8	Numri i nxënësve	86		11		2	99
			Përqindja	21,0%		2,7%		,5%	24,2%
	Total	Klasa 9	Numri i nxënësve	92		9	3	1	105
			Përqindja	22,5%		2,2%	,7%	,2%	25,7%
	Total		Numri i nxënësve	337		52	13	7	409
			Përqindja	82,4%		12,7%	3,2%	1,7%	100,0%

Tabela 12. Përqindja dhe numri i nxënësve të cilët kanë kryer në intervale të ndryshme kohore akte buliste duke marrë në konsideratë klasën që ato ndjekin

4.2.2 Ambjentet ku kanë ndodhur më shpesh aktet buliste, duke marrë në konsideratë dhe gjininë

Siç ilustron dhe në tabelën 13 vendet ku nxënësit bien pre e akteve buliste janë në rend zbritës si më poshtë vijojnë:

1. Në klasë, kur mësuesja nuk është prezente: 32.1% (26 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste në klasë, kur mësuesja nuk ishte prezente;
2. Në klasë, kur mësuesja është prezente: 23.5% (19 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste në klasë, kur mësuesja ishte prezente;
3. Nëpër shkollë: 17.3% (14 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste nëpër shkollë;
4. Në palestër, në dhomat e zhveshjes apo në tualetet e saj: 11.1% (9 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste në ambientet e palestrës;
5. Gjatë rrugës për në shkollë dhe nga shkolla: 8.6% (7 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste gjatë rrugës për në dhe nga shkolla;
6. Në lulishte dhe në fushën sportive: 7.4% (6 nxënës) raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste në këto ambiente.

		Sa shpesh keni marrë pjesë në ushtrimin e akteve buliste ndaj nxënësve në shkollë në muajt e fundit?						Total
		Në lulishte, në fushën sportive	Nëpër shkollë	Në klasë (mësuesja prezente)	Në klasë (mësuesja Jo prezente)	Në palestër	Gjatë rrugës për në shkollë	
Vajza	Numri i nxënësve	1	3	6	14		1	25
	Përqindja	1.2 %	3.7 %	7.4 %	17.3 %		1.2 %	30.9 %
Djem	Numri i nxënësve	5	11	13	12	9	6	56
	Përqindja	6.2 %	13.6 %	16.0 %	14.8 %	11.1 %	7.4 %	69.1 %
Total	Numri i nxënësve	6	14	19	26	9	7	81
	Përqindja	7.4 %	17.3 %	23.5 %	32.1 %	11.1 %	8.6 %	100.0 %

Tabela 13: Vendet, përqindja dhe numri i nxënësve të cilët kanë pësuar akte buliste duke marrë në konsideratë gjininë.

4.2.3 Mënyrat si kryhen më së shumti aktet buliste: në grup apo në mënyrë individuale, duke marrë në konsideratë dhe gjininë

Siç ilustruhet dhe në tabelën 14 nxënësit raportojnë se kanë rënë pre e akteve buliste më së shumti nga një grup nxënësish dhe shumë më rrallë aktet buliste kryhen në mënyrë individuale. Madhësia e grupeve të nxënësve të cilët ushtrojnë akte buliste është në rend zbritës si më poshtë vijon:

1. Nga një grup prej 2 – 3 nxënësish: 4.8% (35 nxënës) pohojnë se ato kanë rënë pre e akteve buliste nga një grup nxënësish prej 2 – 3 nxënësish;
2. Nga një grup prej 4 – 9 nxënësish: 4.1% (30 nxënës) pohojnë se ato kanë rënë pre e akteve buliste nga një grup nxënësish prej 4 – 9 vetash;
3. Kryesisht nga 1 nxënës: 1% (7 nxënës) pohojnë se ato kanë rënë pre e akteve buliste kryesisht nga një nxënës.

		Sa nxënës kanë kryer akte buliste mbi ju?				Total
		Nuk kam qenë autor i akteve buliste në shkollë në muajt e fundit	Kryesisht nga 1 nxënës	Nga një grup prej 2 – 3 nxënësish	Nga një grup prej 4 – 9 nxënësish	
Vajza	Numri i nxënësve	294	1	12	11	318
	Përqindja	40.4 %	0.1 %	1.7 %	1.5 %	43.7 %
Djem	Numri i nxënësve	361	6	23	19	409
	Përqindja	49.7 %	0.8 %	3.2 %	2.6 %	56.3 %
Total	Numri i nxënësve	655	7	35	30	727
	Përqindja	90.1 %	1.0 %	4.8 %	4.1 %	100.0 %

Tabela 14: Madhësia e grupeve të nxënësve, prej të cilëve nxënësit kanë rënë pre e akteve buliste

4.2.4 Format e bulizmit të kryera më së shumti në shkollë

Format e akteve buliste më shpesh të pësuar dhe të kryera nga nxënësit në shkollë.

Konstatohet që nxënësit më së shumti përfshihen në format e bulizmit verbal, fizik, kibernetik, të përhapjes së thashethemeve negative, të kërcënimeve dhe dëmtimit të pronës dhe më së pakti përfshihen në bulizëm seksual. Bulizmi më pak i përhapur është ai racor.

Vlen të theksohet fakti se nxënësit e përfshirë në bulizëm përjetojnë njëkohësisht forma të ndryshme të bulizmit dhe jo vetëm një tip bulizmi të veçantë.

- + *Bulizmi kibernetik* është forma më e përhapur, ndaj tij janë ekspozuar 128 nxënës; ndër to 50 nxënës kanë rënë pre e akteve buliste nëpërmjet mesazheve, telefonatave ose fotove dëmtuese në telefon apo internet dhe 78 nxënës i kanë kryer ato;
- + *Bulizmi fizik* është një formë gjithashtu e përhapur e bulizmit. 115 nxënës kanë pohuar se janë pjesëmarrës të bulizmit fizik; ndër to 41 nxënës kanë pësuar akte të bulizmit fizik dhe 74 nxënës i kanë kryer ato;
- + *Bulizmi nëpërmjet dëmtimit të pronës* është një formë e bulizmit gjatë të cilit pohojnë se janë përfshirë 114 nxënës; ndër to 37 kanë pësuar akte të këtij tipi bulizmi dhe 77 i kanë pësuar ato;
- + *Bulizmi nëpërmjet kërcënimit* është përjetuar nga 113 nxënës; ndër to 37 nxënës kanë rënë pre a kërcënimeve ose detyrimeve për të bërë diçka që nuk kanë dashur ta bëjnë dhe 76 nxënës i kanë kryer ato;
- + *Bulizmi nëpërmjet përhapjeve të fjalëve negative të pavërteta* është një formë bulizmi në të cilin janë përfshirë 108 nxënës, ndër to 37 nxënës e kanë pësuar këtë formë ndërkohë që 71 nxënës kanë treguar gënjeshtër keqdashëse dhe dëmtuese për viktimat e bulizmit;
- + *Bulizmi verbal* 86 nxënës janë pjesëmarrës të bulizmit verbal; ndër to 42 nxënës kanë pohuar se janë thirrur me emra keqdashës, kanë qenë objekt i talljeve dhe i ngamimeve verbale në mënyrë të dëmshme nga nxënësit e tjerë dhe 44 nxënës i kanë kryer ato;
- + *Bulizmi seksual* konstatohet se është një formë gjithashtu e përhapur e bulizmit. 84 nxënës janë përfshirë në të; ndër ta 35 nxënës janë ngacmuar me emra, komente ose gjeste me kuptime seksuale dhe 49 nxënës i kanë kryer këto akte;
- + *Bulizmi rracor* është forma më pak e përhapur e bulizmit. 26 nxënës janë përfshirë në këtë formë të bulizmit; ndër to 5 nxënës janë ngacmuar me emra ose komente keqdashëse për shkak të racës apo ngjyrës dhe 21 nxënës i kanë kryer këto akte.

4.2.4.1 Format e akteve buliste të kryera duke marrë në konsideratë klasën dhe gjininë

Nga sa ilustruhet dhe në tabelën 15 nxënësit në klasën e gjashtë kryejnë akte buliste në nivele mesatare dhe pikun ato e arrijnë në klasën e shtatë dhe më pas numri i akteve buliste zbutet deri diku në klasën e tetë dhe të nëntë.


Jeni djalë apo vajzë?				Formate bulizmit të kryera nga nxënësit							Total		
				Verbal	Përgjashtim	Fizik	Përhapje fjalësh negative	Dëmtim të pronës personale	Kërcënim	Rracor		Seksual	Kibernetik
Vajzë.	Klasa	Klasa 6	Numrii nxënësve	7	10		4	6	3		9	15	54
			Përqindja	3,6%	5,1%		2,0%	3,0%	1,5%		4,6%	7,6%	27,4%
		Klasa 7	Numrii nxënësve	4	10	4	9	5	9	2	6	12	61
			Përqindja	2,0%	5,1%	2,0%	4,6%	2,5%	4,6%	1,0%	3,0%	6,1%	31,0%
		Klasa 8	Numrii nxënësve	2	8	5	8	3	3	2	3	13	47
			Përqindja	1,0%	4,1%	2,5%	4,1%	1,5%	1,5%	1,0%	1,5%	6,6%	23,9%
		Klasa 9	Numrii nxënësve	4	4		8	5	3	2	3	6	35
			Përqindja	2,0%	2,0%		4,1%	2,5%	1,5%	1,0%	1,5%	3,0%	17,8%
	Total		Numrii nxënësve	17	32	9	29	19	18	6	21	46	197
			Përqindja	8,6%	16,2%	4,6%	14,7%	9,6%	9,1%	3,0%	10,7%	23,4%	100,0%
Djalë.	Klasa	Klasa 6	Numrii nxënësve	9	10	12	7	12	24		3	11	88
			Përqindja	2,5%	2,8%	3,4%	2,0%	3,4%	6,7%		,8%	3,1%	24,7%
		Klasa 7	Numrii nxënësve	9	9	25	11	15	19	4	4	8	104
			Përqindja	2,5%	2,5%	7,0%	3,1%	4,2%	5,3%	1,1%	1,1%	2,2%	29,2%
		Klasa 8	Numrii nxënësve	6	7	12	10	16	10	7	7	10	85
			Përqindja	1,7%	2,0%	3,4%	2,8%	4,5%	2,8%	2,0%	2,0%	2,8%	23,9%
		Klasa 9	Numrii nxënësve	3	5	16	14	15	5	4	14	3	79
			Përqindja	,8%	1,4%	4,5%	3,9%	4,2%	1,4%	1,1%	3,9%	,8%	22,2%
	Total		Numrii nxënësve	27	31	65	42	58	58	15	28	32	356
			Përqindja	7,6%	8,7%	18,3%	11,8%	16,3%	16,3%	4,2%	7,9%	9,0%	100,0%

Tabela 15: Numri dhe përqindja e nxënësve që kanë kryer forma të ndryshme bulizmi duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën

❖ Vajzat

Siç ilustruhet në tabelën 15 dhe në grafikun 1 numri i akteve buliste të kryera nga vajzat vjen në zbritje nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Vajzat kryejnë më së shumti akte


buliste në klasën e shtatë dhe këto akte pakësohen në klasën e gjashtë, të shtatë dhe më të pakta janë në klasën e nëntë. Gjithashtu konstatohet se vajzat preferojnë bulizmin verbal, kibernetik, bulizmin nëpërmjet përjashtimit dhe përhapjes së thashethemeve negative dhe më pak të përdorshme janë format e bulizmit fizik, dëmtim të pronës personale dhe kërcënim.



Grafiku 1: Numri i nxënësve (vajza) që kanë kryer forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë

❖ Djemtë

Siç ilustron në tabelën 15 dhe në grafikun 2 numri i akteve buliste të kryera nga djemtë është më i lartë në klasën e shtatë dhe vjen në zbritje në klasën e gjashtë, e tetë dhe në klasën e nëntë. Djemtë preferojnë më së shumti kryerjen e bulizmit fizik, dëmtim të pronës personale dhe kërcënim dhe më rrallë bulizmin verbal, kibernetik bulizmin nëpërmjet përjashtimit dhe përhapjes së thashethemeve negative.



Grafiku 2: Numri i nxënësve (djem) që kanë kryer forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë


Nga sa ilustrohet në tabelën 16 dhe në grafikun 3, 4 konstatohet se aktet buliste pësohen më shumë në klasën e shtatë dhe numri i tyre zbutet në klasat e gjashta, të teta dhe të nënta.

Jeni djalë apo vajzë?			Forma e bulizmit të pësuar nga nxënësit								Total	
			Verbal	Përrashtim	Fizik	Përrhapje fjalësh negative	Dëmtim të pronës personale	Kërcënim	Rracor	Seksual		Kibernetik
Vajzë.	Klasa 6	Numri i nxënësve	7	10		4	6	3		9	11	50
		Përqindja	4,1%	5,8%		2,3%	3,5%	1,8%		5,3%	6,4%	29,2%
	Klasa 7	Numri i nxënësve	4	10		9	5	9	2	6	7	52
		Përqindja	2,3%	5,8%		5,3%	2,9%	5,3%	1,2%	3,5%	4,1%	30,4%
	Klasa 8	Numri i nxënësve	2	8		8	3	3	2	3	9	38
		Përqindja	1,2%	4,7%		4,7%	1,8%	1,8%	1,2%	1,8%	5,3%	22,2%
Djalë.	Klasa 9	Numri i nxënësve	4	4		8	5	3	2	3	2	31
		Përqindja	2,3%	2,3%		4,7%	2,9%	1,8%	1,2%	1,8%	1,2%	18,1%
	Total	Numri i nxënësve	17	32		29	19	18	6	21	29	171
		Përqindja	9,9%	18,7%		17,0%	11,1%	10,5%	3,5%	12,3%	17,0%	100,0%
	Klasa 6	Numri i nxënësve	8	10	12	7	12	24		3	11	87
		Përqindja	2,3%	2,8%	3,4%	2,0%	3,4%	6,8%		,8%	3,1%	24,5%
Klasa 7	Numri i nxënësve	9	9	25	11	15	19	4	4	8	104	
	Përqindja	2,5%	2,5%	7,0%	3,1%	4,2%	5,4%	1,1%	1,1%	2,3%	29,3%	
Klasa 8	Numri i nxënësve	6	7	12	10	16	10	7	7	10	85	
	Përqindja	1,7%	2,0%	3,4%	2,8%	4,5%	2,8%	2,0%	2,0%	2,8%	23,9%	
Klasa 9	Numri i nxënësve	3	5	16	14	15	5	4	14	3	79	
	Përqindja	,8%	1,4%	4,5%	3,9%	4,2%	1,4%	1,1%	3,9%	,8%	22,3%	
Total	Numri i nxënësve	26	31	65	42	58	58	15	28	32	355	
	Përqindja	7,3%	8,7%	18,3%	11,8%	16,3%	16,3%	4,2%	7,9%	9,0%	100,0%	

Tabela 16: Numri dhe përqindja e nxënësve që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi duke marrë në konsideratë gjininë dhe klasën

❖ Vajzat


Siç ilustron në tabelën 16 dhe në grafikun 13 numri i akteve buliste të pësuar nga vajzat është më i lartë në klasën e shtatë dhe vjen në zbritje nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Gjithashtu konstatohet se vajzat pësojnë bulizëm nëpërmjet përrashtimit dhe përrhapjes së thashethemeve negative, kibernetik, seksual, dëmtim të pronës dhe më pak bulizëm nëpërmjet kërcënimit të kryerjes së gjërave që nuk dëshirohen të bëhen, seksual verbal dhe racor. Vajzat nuk raportojnë të kenë rënë pre e bulizmit fizik. Konstatohet një rritje e pësimit të bulizmit seksual, veçanërisht në klasën e gjashtë dhe të shtatë, moshë kjo që lidhet me fillimin e pubertetit.



Grafiku 3: Numri i nxënësve (vajza) që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë

❖ Djemtë

Siç ilustron në tabelën 16 dhe në grafikun 4 dhe numri i akteve buliste të pësuar nga djemtë është më i lartë në klasën e shtatë dhe vjen në zbritje në klasën e gjashtë, e tetë dhe në klasën e nëntë. Djemtë pësojnë më së shumti bulizëm fizik, dëmtim të pronës personale dhe kërcënim dhe më rrallë bulizëm kibernetik, bulizëm nëpërmjet përrjashtimit dhe përrhapjes së thashethemeve negative, verbal, seksual dhe racor.



Grafiku 4: Numri i nxënësve (djem) që kanë pësuar forma të ndryshme bulizmi në klasa të ndryshme duke marrë në konsideratë gjininë

4.3 Pyetja e tretë kërkimore: Cilat janë arsyet kryesore e përfshirjes së nxënësve në bulizëm?

Evidentimi i arsyeve kryesore të përfshirjes së nxënësve në bulizëm u mundësua nëpërmjet analizës cilësore të nxënësve të intervistuar.

Gjatë intervistave individuale u konstatua se arsyet pse nxënësit përfshihen në bulizëm janë të shumta. Ndër më kryesoret mund të përmenden statusi social – ekonomik, pamja fizike, nënvlerësimi i ulët që nxënësit kanë për veten, rezultatet në mësim dhe popullariteti në klasë apo në shkollë. Nxënësit përfshihen në bulizëm, si në rolin e autorit, ashtu dhe në atë të viktimës si për shkak të statusit si të lartë, ashtu dhe atij të ulët social – ekonomik. Pamja fizike është gjithashtu një një arsyet kryesore për përfshirjen në bulizëm. Nxënësit e perceptuar si të fuqishëm ose realisht të fuqishëm në rastet e mëposhtme shfaqen si autorë të bulizmit në shkollë, ndërkohë që nxënësit e perceptuar me pamje fizike jo shumë tërheqëse janë viktima të bulizmit. Viktima të bulizmit janë dhe nxënës të cilët kanë pamje të jashtme ekstravagande dhe moderne. Vlen të theksohet se nxënësit e lartpërmendur bien viktima të bulizmit, jo vetëm të ushtruar nga bashkënxënësit, por dhe nga ai i ushtruar kryesisht nga mësuesit. Rezultatet në shkollë gjithashtu ndikojnë në përfshirjen në bulizëm. Nxënësit të cilët mësojnë shumë në disa raste konsiderohen dhe si “ufo” dhe ndaj tyre ushtrohet bulizëm verbal; por në raste të tjera rezultatet pozitive në shkollë janë dhe shkak për të qenit autorë të akteve buliste ndaj nxënësve të tjerë. Gjithashtu dhe popullariteti në klasë apo në shkollë ndikon si në të qenit viktimë, ashtu dhe në të qenit autorë të akteve buliste.

4.3.1 Analiza cilësore e intervistave invididuale

Unë kam një shoqe mendjemadhe, të pasur dhe të mirë në mësim. Por nuk e duroj dot atë pikërisht për faktin se ajo është shumë e dashur nga shumica e nxënësve në klasë. Shpesh herë unë u them nxënësve të tjerë dhe gjëra negative dhe të pavërteta rreth saj. Bashkë me një shoqe tjetër timen ne publikojnë shpesh foto në facebook. Shpesh ne bëjnë foto të përbashkëta dhe me shoqen mendjemadhe, por në momentin që i publikojmë fotot, e presim enkas pjesën e fotografisë ku ndodhet ajo “mendjemadhja”. Në fotot që publikojmë

na bëjnë shumë miq “like”, vetëm mendjemadhja nuk na bën “like”. Unë e “eliminoj” atë nga fotot, pikërisht që ajo të mos më marrë vëmendjen dhe që t’ia prish humorin e ditës”. Vëmendjen më të madhe në klasë e marr unë dhe kështu të gjithë flasin për mua, dhe jo për “mendjemadhen”.

Nxënëse e klasës së nëntë

Në shkollë është një nxënës, i cili është djali i një drejtori. *Ai është një nxënës me rezultate mesatare, vishet bukur dhe në përgjithësi gjithmonë i qeras vajzat e klasës kur shkojmë në lokal.* Ai është një djalë i pëlqyer nga shumica e vajzave, për shkak të rrobave të shtrenjta dhe moderne që mban. Vajzat gjithmonë mundohen të tërheqin vëmendjen e tij, pasi ai është djali më trendi në klasë. Këtë nuk e duroj dot. Unë jam tërësisht i parëndësishëm për nxënësit e tjerë. *E gjithë vëmendja e nxënësve është tek ai dhe tek telefoni apo veshjet e tij të shtrenjta. Mua askush nuk më kushton vëmendje kur ai është në klasë.* Babai im është i papunë dhe nuk ka mundësi të më japë lekë. Dhe unë dua t’i qeras vajzat, dhe shpesh herë i marr lekë me dhunë të pasurit të klasës. Siç e sheh dhe ti, unë jam i gjatë dhe kam muskuj. Ai është i bukuri i klasës, ndërsa unë jam i fuqishmi i saj. E shaj gjithmonë në sy të të tjerëve duke dashur t’a turpëroj para të tjerëve dhe që unë të mos vazhdoj me këtë sjellje, ai detyrohet të më japë lekë. Kur djali i drejtorit më jep lekë, nuk e shaj më për pak kohë.

Nxënës i klasës së nëntë

Une me shoqet e mia ngacmojmë shpesh një vajzë të klasës tonë, e cila vjen nga një familje me të ardhura të ulëta ekonomike dhe që mëson shumë. Ndonjëherë e shajmë “pabukse”, për shkak se ajo vishet me rroba jo shumë të reja ndërsa ndonjëherë e quajmë “ufoja” e klasës. Mësueset e kanë shumë për zemër, pasi ajo është shumë e urtë dhe mëson gjithmonë. *Ajo është nxënësja model dhe ne të tjerat duhet të sillemi dhe të mësojmë si ajo.* Vërtet ne nuk mësojmë aq shumë sa ajo, por dhe ne jemi shumë të sjellshme. Vishemi gjithmonë sipas modës dhe kujdesemi shumë për pamjen tonë. *Megjithatë mësuesit në shkollë nuk na lavdërojnë apo nuk na mbajnë pranë, aq shumë sa atë. Gjithmonë kur prindërit e mi vijnë në mbledhje prindërisht, mësuesja kujdestare u thotë atyre se unë jam një nxënëse e mirë, por jo aq e mirë sa X. Më tej prindërit më kritikojnë dhe më bëjnë moral në shtëpi, duke më krahasuar gjithmonë me të.* Kjo më bën të ndjehem keq dhe ta

kem dhe më shumë inat atë. Disa nxënës e trajtojnë keq, ndërsa disa të tjerë mirë. Disa vajza të tjera e mbajnë për interes pranë; i japin disa nga rrobat e tyre që nuk i përdorin më, por në këmbim e imponojnë të bëjë detyrat e tyre të shkollës.

Nxënëse e klasës së tetë

Unë jam e shëndoshë dhe më kanë dalë dhe shumë puçra në fytyrë. Nxënësit në shkollë nuk më thërrasin në emër por më thërrasin gjithmonë “bufe”. Madje disa vajza më kanë thënë se *kishin merak të më takojnë për shkak të puçrave në fytyrë*. Kur dua të shkoj në festa bashkë me nxënësit e tjerë, ato nuk më pranojnë dhe më refuzojnë duke më thënë, *se unë nuk di as të kërcej dhe as të vishem me fustane të shkurtër dhe të ngushtë sipas modës*. Dhe në aktivitetet sportive që kryhen në shkollë, *nuk më pranojnë pasi më konsiderojnë si pengesë*. Ato më thonë, se jam aq e shëndoshë, sa nuk mundem të lëviz dot shpejt prej kileve të tepërta. Kjo ndodh shpesh herë në javë dhe më është mërëzitur dhe shkolla. Ndjem e refuzuar nga shoqet dhe vërtet që ndjej shumë stres në mëngjes kur mendoj se në shkollë do të përballem me nxënësit e tjerë.

Nxënëse e klasës së gjashtë

Unë jam nxënësi më i gjati dhe më i fuqishmi në shkollë. Unë jam bosi i shkollës dhe si i tillë të gjithë nxënësit në shkollë, veçanërisht ato qullacët, duhet të bëjnë atë që dëshiroj unë. Babai im thotë: “Bosi jep gjithmonë urdhra, apo jo”? Dhe babi në punë dhe në shtëpi kështu bën. Ai jep urdhra dhe të gjithë binden”. Unë jam nxënësi me rezultatet më të mira në shkollë. *Të tjerët janë shumë të paditur*. Shumica e shoqeve dhe shokëve të mi nuk mësojnë fare. Nuk kam çfarë të bisedoj me to. Aman janë shumë “budallenj” dhe “inorantë”. Përderisa unë jam nxënësi më i përgatitur dhe më i fuqishëm në klasë, normalisht që unë i detyroj të tjerët të bëjnë vazhdimisht atë që unë u them, edhe kur ato nuk e kanë shumë qejf diçka të tillë. Kur më hahet apo pihet ndonjë gjë, gjithmonë është dikush i gatshëm të zbatojë urdhrin tim, mjafton që t’i jap një bakshish të vogël.

Nxënës i klasës së nëntë

Unë mësoj shumë pasi dua të eci në jetë. Shpesh herë shoqet dhe shokët e klasës duan të lenë orët e mësimi dhe të shkojnë në ndonjë lokal, por unë nuk shkoj me to, sepse unë e di, që diçka e tillë nuk është e drejtë. Unë jam vërtet e interesuar të mësoj çdo lëndë sistematikisht, madje dhe ato lëndë të cilat nga ne nuk konsiderohen si lëndë kryesore. Nuk

i kushtoj shumë rëndësi veshjes në shkollë, mundohem të vi sa më praktike dhe interesi im kryesor në shkollë është veç të mësuarit. Por diçka e tillë më krijon probleme në marrëdhëniet me nxënësit e tjerë. Shpesh herë ato më thërrasin “Ufoja e shkollës” dhe kjo më lëndon veçanërisht kur më drejtohen në këtë mënyrë në prani të shoqeve të mija të lagjes. Tani dhe ato kanë filluar të më thërrasin në këtë mënyrë dhe jo me emrin tim real. Ato fillimisht më thonin me shaka “Ufo”, por tani e thonë shumë shpesh dhe kjo më lëndon, pasi tani më shumë tingëllon si tallje dhe jo si shaka e vogël.

Nxënëse e klasës së shtatë

Unë jam nga fshati dhe kam ardhur muajt e fundit në qytet. Prindërit janë përshtatur disi me jetën këtu, ndërsa gjyshja vazhdon të vishet ende si në fshat, me pantallona e fund sipër, me flokët gërshet. Kur shoqet më shohin me gjyshen dhe na tallin duke thënë “Ja, katunaret në qytet, kanë zbritur për të shitur qumësht ose vezë”. Unë mundohem të vishem bukur si nxënëset e tjera në shkollë, por shpesh herë prindërit nuk kanë mundësi ekonomike të më blejnë veshje të shtrenjta dhe moderne dhe ato dhe në shumë raste dhe nuk më lejojnë të vishem si nxënëset e tjera, pasi veshja e tyre prindërve të mi u duket shumë e ekzagjeruar dhe ekstravagante. Por shoqet më tallin shpesh dhe për shkak të mënyrës si unë flas; siç e shikon dhe ti unë flas ende si në fshat, me atë theks dhe shpesh herë nxënësit në klasë më imitojnë duke u tallur me mua.

Nxënëse e klasës së tetë

Siç mund ta shikoni dhe ju unë mbaj syze. Mami është e papunë dhe vetëm babi punon në ndërtim kur gjen punë. Ato mezi na ushqejnë mua dhe motrën time më të vogël. Prindërit më kanë blerë syze nga më të lirat, ato janë shumë të mëdhaja dhe nuk janë aspak të bukura. Nxënësit në klasë më tallin vazhdimisht në lidhje me veshjen time, e cila është shumë jashtë mode, por më shumë më tallin për syzet e mia. Kur unë pengohem apo kur nuk dalloj mirë diçka, ato më tallin duke më thënë: “Nuk shikon, sepse nuk të lënë kavanozat që ke në sy.” apo dhe “Dukesh si stërgjyshja ime me këtë veshje dhe me këto syze”. Nofka ime në shkollë është vajza me syze si kavanoz. Ndjem shpesh herë keq për këtë, pasi është shumë keq, kur nxënësit në klasë më tallin për shkak të veshjes së keqe dhe syzeve të shëmtuara.

Në këtë shkollë unë kam ardhur këtë vit. Jam *tip i mbyllur dhe i izoluar*. Nuk më pëlqen të kem shumë shoqëri. Kam vetëm një shok në klasë dhe me të luaj shumë në kompjuter. Jemi dhe pak të shëndoshë dhe nuk luajmë as futboll me çunat e klasës. Rrimë vetëm të dy. Shokët në klasë na ngacmojnë shpesh dhe ndonjëherë dhe na gjuajnë kur ne nuk i lemë orët e mësimit me to. Ne kemi vetëm njëri tjetrin dhe askush nuk na ndihmon kur na ngacmojnë djemtë e fortë të klasës. Madje ndonjëherë na tallin dhe vajzat e klasës. Ato bashkohen me djemtë e tjerë dhe na tallin shpesh kur qëndrojmë në klasë në pushimin e gjatë dhe luajmë në celular. Ndjehemi më të sigurt në klasë. Jashtë klasës na ngacmojnë më shumë djemtë e tjerë. Ato bëhen grup dhe na venë vazhdimisht në lojë. Nuk na ndihmon askush, pasi kemi shumë pak shokë në shkollë, ose më saktë nuk kemi asnjë shok tjetër.

Nxënës i klasës së shtatë

Mua më pëlqen të vishem bukur. Ndonjëherë dhe e ekzagjeroj me minifundet, xhinset e grisura dhe tualetin. Por modelet dhe fashionistet në instagram kështu vishen. Në përgjithësi djemtë në klasë dhe në shkollë më pëlqejnë shumë dhe duan të shoqërohen me mua. Vajzat në përgjithësi gjithashtu më pëlqejnë dhe më mbajnë për vajzën më trendi të klasës. Disa prej vajzave bëhen grup dhe më ngacmojnë. Ato më tallin duke më thënë, që jam tip shumë i lehtë dhe i hedhur. Ato shpesh herë më konsiderojnë një vajzë kopertinash, që e kam mendjen vetëm tek veshjet dhe askund tjetër. Më shumë mosmarrëveshje në shkollë kam me mësuesit. Ato më paraqykojnë vazhdimisht për shkak të veshjes time ekstavagande dhe moderne. Unë jam nxënëse e rregullt dhe sistematike në mësim. Nuk lë orët e mësimit dhe mësimin e ndjek me vëmendje. Rrallë herë vi pa përgatitur. E megjithatë disa prej mësuesëve vazhdimisht më vënë në lojë dhe shpesh herë më ofendojnë për shkak të buzëve të lyera me buzëkuq. Ndër shprehjet e tyre më të preferuara janë: “Buzëkuqja e klasës së nëntë A” apo dhe “Nxënësja e cila kujdeset më shumë për veshjen sesa për librat”. Shpesh herë më ironizojnë duke më thënë që, sikur të rrija mbi libra aq shumë sa rri para pasqyrës, do të isha një nxënëse e shkëlqyer. Dhe ky ironizim dhe tallje ndodh vërtet vazhdimisht dhe vetëm për shkak të veshjes sime, pasi në shkollë unë nuk krijoj asnjë

problem në lidhje me sjelljen me nxënësit e tjerë apo në lidhje me vijueshmërinë në mësim.

Nxënëse e klasës së nëntë

Njolla e madhe e kuqe që kam në fytyrë ka qenë gjithmonë një pengesë që unë të mos kem shoqëri me nxënësit e tjerë në klasë. Që në klasën e parë, nxënësit më shikonin çuditshëm. Shoqet dhe shokët në klasë thuajse nuk më afronin fare. Njolla e kuqe i mbante larg miqtë e mi. Ato nuk luanin me mua në pushim të gjatë dhe nuk më flisnin në pushimet e shkurtra. Kur unë u afrohesha, ato më largoheshin si të frikësuar prej meje. Jam ndjerë e braktisur dhe e mënjanuar thuajse gjithmonë nga nxënësit e tjerë në klasë për shkak të kësaj njolle të madhe në fytyrë. Edhe sot që jam në klasë të shtatë, përsëri nuk kam shoqëri. Por tashmë jam mësuar me këtë sjellje. E di që njolla ime i frikëson nxënësit. E vuaj këtë injorim dhe largim të vazhdueshëm të tyre, por nuk e ndryshoj dot.

Nxënëse e klasës së shtatë

Unë jam djalë i vetëm në shtëpi. Prindërit më kanë trajtuar shumë mirë dhe kanë patur kujdes maksimal ndaj meje. Më shumë kam ndejtur me mamin dhe vazhdoj të rri ende gjatë me të. Dalim edhe në lokal bashkë. Për këtë shokët në klasë më tallin vazhdimisht dhe më thërrasin “çun mami”. Me vajzat në klasë kam marrëdhënie të mira. Flas shpesh me ato për këngëtarët dhe për modën. Por djemve nuk u pëlqen fakti që unë rri shumë me vajzat dhe shpesh herë më tallin dhe më vënë në lojë duke më thënë “shoqja”.

Nxënës i klasës së tetë

Për fat të keq unë jam më shumë brune sesa vajzat e tjera në klasë. Unë në fakt nuk jam “dorë e zezë”, siç thonë nxënësit në klasë. Unë jam si të gjithë nxënësit e tjerë në klasë; jam e bardhë, por në dallim nga to jam shumë zeshkane. Veçanërisht një grup vajzash në klasë më shajnë dhe më ofendojnë shpesh për shkak të ngjyrës shumë zeshkane të lëkurës time. Ato, kur unë nuk jam dakort me idetë apo propozimet e tyre, më shajnë gjithmonë “jevgë”. Kështu nuk më thonë vetëm në klasë, por edhe kur shkojmë në ekskursion me shkollën. Edhe nxënësit e tjerë në shkollë mendojnë se unë jam vajzë me ngjyrë dhe nuk me afrojnë shumë. E kuptoj që ngjyra e lëkurës time është shumë më brune se e tyre, por a është kjo një arsye për të më bërë vazhdimisht objekt talljeje? Unë jam një nxënëse

mesatare dhe si tip jam e shoqërueshme. Nxënësit e tjerë më ngacmojnë vetëm për shkak se jam kaq shumë brune, pasi unë nuk u jap arsye tjetër për të më tallur.

Nxënëse e klasës së shtatë

Ne jemi tre shoqe të ngushta. Rrimë gjithmonë bashkë dhe jemi të treja më të mirat e klasës në mësim. Unë i dua shumë dy shoqet e mia, por dua dhe që të jem unë senatorja e klasës tonë. A. po ashtu dëshironte të ishte senatorja. Nxënësit e tjerë të klasës na donin shumë të dyjave dhe na qëndronin pranë si mua, ashtu dhe asaj. Por që të fitoja unë rolin e senatores së klasës, shpesh herë unë thoja ndonjë gënjeshtër të vockël për A. Në fakt A. edhe i shan ndonjëherë nxënësit e tjerë, kështu që unë nuk gënjej, thjesht nxjerr ndonjë gjë që më ka thënë A. për disa nxënës. E përse duhet të ishte A. senatore e klasës? Unë jam dhe më e zgjuar, dhe më e përgatitur në krahasim me të. Prindërit në shtëpi më thonë, që duhet të luftoj për të arritur atë që dua. Unë desha të bëhem senatore e klasës dhe shpesh herë e ngacmoj A. kur ajo bën si shumë e zgjuar dhe komanduese, duke i kujtuar se senatorja e klasës jam unë.

Nxënëse e klasës së shtatë

Zoti mua më ka dhuruar një pamje shumë të bukur. Jam e gjatë, e bukur dhe shumë tërheqëse. Përgjithësisht të gjithë djemtë në shkollë duan të shoqërohen dhe të rrinë pranë meje. Normalisht që unë nuk mund të shoqërohem me të gjithë ato dhe aq më tepër të krijoj lidhje me ndonjërin prej tyre. Vazhdimisht, kur unë i refuzoj meshkujt, ato përhapin thashetheme dhe komente negative për mua. Unë dua të kem shoqëri me djemtë në klasë, por absolutisht jo të krijoj një lidhje. Dhe vajzat në klasë, ngaqë u dukem shumë më e bukur se ato, i besojnë fjalët negative të djemve dhe fillojnë të flasin akoma dhe më keq. Vajzat në klasë ngaqë më kanë inat për faktin se u dukem më e bukur dhe më e pëlqyeshme nga djemte, shpesh herë përhapin thashetheme për mua, që të më pakësojnë vëmendjen që unë marr në klasë.

Nxënëse e klasës së nëntë

4.4 Pyetja e katërt kërkimore: A janë ndërmarrë masa konkrete për të trajtuar dhe parandaluar bulizmin në shkollë?

Konstatimi i masave konkrete të ndërmarra për të trajtuar dhe parandaluar bulizmit u realizua nëpërmjet analizës cilësore të intervistave të fokus - grupi, si dhe nëpërmjet analizës statistikore të të dhënave sasiore të marra nga pyetësorët. Në përgjithësi konstatohet se janë ndërmarrë pak masa konkrete, dhe ndër to më kryesoret janë raportimet e akteve buliste mësuesëve apo familjarëve të tjerë nga vetë nxënësit; por dhe në raste të këtyre raportimeve është ndërhyrë pak nga mësuesit apo prindërit. Gjithashtu ndër masat e përmendura mund të konstatohen supervizim i ambjenteve në shkolla, këshillime individuale apo në grup dhe takime sensibilizuese.

4.4.1 Analiza cilësore e intervistave në grupin e fokusit

Unë jam ndër personat e parë që trajtoj problematikat e ndryshme që kanë nxënësit në ambjentet e shkollës. Kryesisht në orët e kujdestarisë ka patur raste kur kam trajtuar probleme të dhunës midis nxënësve, por në dy orë në javë është e pamundur të trajtohen të gjitha problemet. Kam referuar rastet më të rënda në drejtori ose tek psikologu. Gjithashtu këto raste i kemi diskutuar dhe me prindërit. Ka nxënës të cilët ushtrojnë dhunë sistematike ndaj disa nxënësve, që vijnë kryesisht nga shtresat vulnerable të shoqërisë, por në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Shkollës janë marrë masat e duhura për parandalimin dhe trajtimin e situatave konfliktuale. Psikologu i shkollës ka patur një rol thelbësor në zgjidhjen e konflikteve midis nxënësve.

Mësuesja kujdestare e klasës së shtatë

Në raste të tilla jam munduar gjithmonë të komunikoj me nxënësit e përfshirë në bulizëm. Edhe pse jo gjithmonë kam hapësirën e nevojshme kohore në orët e kujdestarisë, jam munduar që gjithmonë të krijoj në klasë frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe mirëkuptimit midis bashkënxënësve dhe të zbus konfliktet e mundshme që mund të lindin midis tyre. Jam munduar t'i zbus situatat agresive në klasë, por mendoj se roli i psikologut do të ishte vendimtar në situata të tilla. Fatkeqësisht në shkollën tonë psikologu vjen vetëm 2 herë në javë, gjë që e bën të pamundur trajtimin e duhur të situatave kur nxënësit përfshihen në bulizëm.

Mësuesja kujdestare e klasës së nëntë

Si senatorët e klasave, edhe unë si kryetar i qeverisë së nxënësve jemi përpjekur shumë *t'i qëndrojmë pranë bashkënxënësve, të cilët janë viktimë apo autorë të bulizmit*. E kemi ngritur zërin tonë dhe tek takimet me bordin e shkollës, veçanërisht rreth marrjes së masave disiplinuese ndaj nxënësve të cilët ushtrojnë bulizëm, por me aq shumë problematika sa ka në shkollë, *realisht janë ndërmarrë shumë pak masa për të trajtuar në mënyrë efektive rastet e bulizmit*.

Kryetari i Qeverisë së Nxënësve

OJF – ja ku unë punoj, por dhe shumë OJF të tjera në bashkinë e Elbasanit kanë ofruar *trajnime të ndryshme me tematikë “ Dhuna midis bashkënxënësve në shkollë ”*. Gjithashtu me nxënës kemi kryer dhe *fushata sensibilizimi dhe takime informuese* rreth tematikës së lartpërmendur. Në raste të dhunë ekstreme ndaj fëmijës kemi ofruar dhe *terapi individuale apo dhe mbështetje në shtëpizat e mbrojtura*. Gjithashtu kemi kryer mjaft takime me nxënës për të *nxitur tek to kryerjen e sjelljeve prosociale, gjë që ndikon mjaft në zbutjen e fenomenit të bulizmit*. Por gjithsesi me aq sa unë kam njohuri, në bashkinë e Elbasanit asnjë OJF nuk ka zbatuar ndonjë projekt të mirëfilltë që të ketë qëllim kryesor trajtimin dhe parandalimin e fenomenit të bulizmit.

Përfaqësuesi i një OJF – je lokale

Kur më janë referuar raste të tilla nga mësuesit jam munduar t'i trajtoj ato me sa më shumë profesionalizëm. Por unë jam psikologe dhe në dy shkolla të tjera 9 – vjeçare dhe shpesh herë e kam të pamundur ta trajtoj rastin siç duhet. Gjithçka mbetet në kuadrin e *një interviste të thjeshtë duke mos patur mundësinë të ofroj siç duhet terapinë apo këshillimin individual*. Shpesh herë kam trajtuar me klasa të veçanta *terapi grupi me tematikë “Dhunën midis bashkënxënësve”*, por ende duhet bërë më shumë.

Psikologia e shkollës

Njësia psiko – sociale pranë DAR ka ofruar me nismën e saj *trajnime dhe takime këshilluese si me anëtarët e trupës pedagogjike, ashtu dhe me nxënës të shkollave rreth arsyeve, formave dhe pasojave të dhunës sistematike që ushtron dhe pëson një nxënës*. Gjithashtu dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë si Drejtorinë e Policisë dhe me OJF të

ndryshme, ne kemi qenë gjithmonë të pranishëm dhe aktiv në zbatimin e projekteve të ndryshme, qëllimi i të cilëve ka qenë reduktimi i dhunës në shkollë.

Përfaqësuese e njësisë psiko – sociale pranë DAR


Në cilësinë dhe të drejtorit të shkollës jam munduar t'ua bëj sa më të qartë nxënësve të shkollës si të drejtat, ashtu dhe detyrimet e tyre ndaj procesit mësimor, stafit pedagogjik por dhe ndaj njëri – tjetrit. Jam munduar gjithashtu t'u mundësoj nxënësve një mjedis dhe një klimë sa më miqësore në shkollë. Gjithashtu në veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare, bashkë me stafin pedagogjik jam përpjekur të trajtoj sa më shumë veprimtari me tematikë kundër dhunës në shkollë. Gjithashtu kam qenë gjithmonë i hapur ndaj bashkëpunimeve me OJF – të e ndryshme dhe me aktorët e tjerë të komunitetit për të redaktuar fenomenin e dhunës midis nxënësve në shkollë.

Përfaqësues nga komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në shkollë

4.4.2 Analiza statistikore e të dhënave sasiore.

➤ Shpeshtësia e raportimit të akteve buliste në shkollë.

Në grafikun 5 pasqyrohet se nga 727 nxënës të anketuar 655 nxënës (90.1%) nuk kanë rënë pre e akteve buliste dhe 72 (9.9%) prej tyre kanë rënë pre e akteve buliste. Ndërkohë që 47 nxënës (6.5 %) nuk u kanë treguar askujt rreth të rënies pre e akteve buliste, ndërkohë që 25 nxënës (3.4%) prej tyre u kanë treguar dikujt rreth të rënies pre e akteve buliste.




Grafiku 5: Raportimi i akteve buliste

Siç konstatohet dhe grafikun 6 më së shumti nxënësit u tregojnë shokëve dhe vëllait ose motrës rreth akteve buliste dhe më rrallë mësuesve ose prindërve.


Në aspektin gjinor duke u bazuar dhe në grafikun 7, vajzat janë ato të cilat i raportojnë më së shumti aktet buliste. Konstatohet se djemtë në krahasim me vajzat nuk u tregojnë personave të rritur rreth pësimit të akteve buliste, ato më së shumti u tregojnë bashkëmoshatarëve, ndërsa vajzat u tregojnë dhe të rriturve dhe bashkëmoshatarëve.

Në rend zbritës raportimi i pësimit të akteve buliste personave të lartpërmendur është si më poshtë vijon:



Grafiku 6: Personave të cilëve u tregojnë viktimat e bulizmit rreth tij

- ✚ Një shoku ose shokëve: 9 nxënës (36%); ndër to 3 vajza dhe 6 djem;
- ✚ Vëllait ose motrës: 7 nxënës (28%); ndër to 4 vajza dhe 3 djem;
- ✚ Prindërve ose personave kujdestarë: 5 nxënës (20%) dhe të pesta janë vajza;
- ✚ Mësuesit kujdestar: 4 nxënës (16%) dhe të katërta janë vajza.




Grafiku 7: Personave të cilëve u tregojnë viktimat e bulizmit rreth tij, duke marrë në konsideratë dhe gjininë

➤ **Përpjekjet e mësuesëve ose anëtarët e tjerë të stafit psiko - pedagogjik për të ndaluar vazhdimin e bulizmit.**

Nga grafiku 8 konstatohet se viktimat e bulizmit e perceptojnë në nivele shumë të ulta përpjekjen e mësuesve apo të stafit psiko - pedagogjik për të ndaluar vazhdimin e bulizmit mbi to.

- ✚ Shpesh: Vetëm 6 nxënës perceptojnë përpjekje të shpeshta;
- ✚ Herë pas here: 16 nxënës perceptojnë përpjekje të herëpashershme;
- ✚ Nganjëherë: 31 nxënës, çka përbën dhe shumicën, perceptojnë përpjekje në nivele të ulta; pra nganjëherë;
- ✚ Thuajse asnjëherë: 19 nxënës gjithashtu perceptojnë përpjekje thuajse inekzistente.




Grafiku 8: Përpjekjet e mësuesve ose anëtarëve të tjerë të stafit psiko - pedagogjik për të ndaluar vazhdimin e bulizmit mbi viktimat

Siç konstatohet dhe nga grafiku 9 vetëm 160 nxënës, mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi dhe deri diku shumë për të pakësuar bulizmin në klasat e tyre. Siç shihen dhe nga grafiqet mendimet pozitive në lidhje me veprimet disi dhe deri diku shumë i kanë nxënësit të cilët nuk janë as autorë, dhe as viktima të bulizmit. Viktimat dhe autorët e bulizmit mendojnë më së shumti se mësuesit kanë vepruar mjaft pak, pak ose aspak.

Ndër 727 nxënës të anketuar:

- ✚ 22 nxënës (3%) mendojnë se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë;
- ✚ 138 nxënës (19%) mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi;
- ✚ 376 nxënës (51.7%) mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- ✚ 191 nxënës (26.3%) mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.



Grafiku 9: Mendimet e nxënësve rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë

Siç pasqyrohet dhe në grafikun 10 ndër 110 nxënës autorë të bulizmit:

✚ 2 – 3 herë në muaj – ndër 78 nxënës:


- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë;
- 12 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi;
- 41 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 25 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.

✚ 1 herë në javë – ndër 22 nxënës

- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë;
- 3 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi;
- 10 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 9 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.

✚ Disa herë në javë – ndër 10 nxënës

- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë ose disi;
- 3 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 7 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak;



Grafiku 10: Mendimet e nxënësve autorë të bulizmit rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë

Në grafikun 11 konstatohet se ndër 72 nxënës viktimë të bulizmit:

✚ 2 – 3 herë në muaj – ndër 50 nxënës:


- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë;
- 8 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi;
- 24 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 18 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.

✚ 1 herë në javë – ndër 14 nxënës

- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë;
- 2 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar disi;
- 5 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 7 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.

✚ Disa herë në javë – ndër 8 nxënës

- Asnjë nxënës nuk mendon se mësuesit kanë vepruar deri diku shumë ose disi;
- 2 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar mjaft pak;
- 6 nxënës mendojnë se mësuesit kanë vepruar pak ose aspak.




Grafiku 11: Mendimet e nxënësve viktimë të bulizmit rreth shpeshhtësisë së veprimeve të mësuesve për të pakësuar bulizmin në klasë

➤ **Përpyjekjet e familjarëve për të ndaluar përfshirjen e fëmijëve të tyre në bulizëm**

Nga grafiku 12 konstatohet se në shumë pak raste prindërit e viktimave të bulizmit kanë kontaktuar me shkollën për t'i kërkuar të merren masa kundër bulizmit të pësuar nga fëmijët e tyre. Në rastin më të madh ato nuk e kanë kontaktuar asnjëherë ose e kanë kontaktuar vetëm një herë.

- ✚ Prindërit e kanë kontaktuar shkollë disa herë: 9 nxënës;
- ✚ Prindërit e kanë kontaktuar shkollën vetëm 1 herë: 19 nxënës;
- ✚ Prindërit nuk e kanë kontaktuar asnjëherë shkollën: 44 nxënës.




Grafiku 12: Shpeshtësia e kontakteve të prindërve me shkollën për t'i kërkuar marrjen e masave kundër bulizmit të pësuar nga fëmijët e tyre

Siç konstatohet dhe nga grafiku 13 në ndër 110 nxënës, të cilët kanë kryer akte buliste vetëm 40 autorëve u kanë folur familjarët rreth kryerjes së akteve buliste nga ana e tyre.

Ndër 110 autorë të bulizmit:

- ✚ Prindërit u kanë folur disa herë 13 nxënësve autorë të bulizmit;
- ✚ Prindërit u kanë folur vetëm një herë 27 nxënësve autorë të bulizmit;
- ✚ Prindërit nuk u kanë folur asnjëherë 70 nxënësve autorë të bulizmit.




Grafiku 13: Numri i nxënësve dhe shpeshtësia e bashkëbisedimeve të autorëve të bulizmit me të cilët familjarët kanë folur rreth akteve buliste të kryera prej tyre

Siç konstatohet dhe nga grafiku 14 në ndër 110 nxënës, të cilët kanë kryer akte buliste vetëm 27 autorëve u kanë folur mësuesit rreth kryerjes së akteve buliste nga ana e tyre.

Ndër 110 autorë të akteve buliste:

- + Mësuesit u kanë folur vetëm një herë 27 nxënësve (3.7%) autorë të bulizmit;
- + Prindërit nuk u kanë folur asnjëherë 83 nxënësve (11.4%) autorë të bulizmit.



Grafiku 14: Numri i nxënësve dhe shpeshësia e bashkëbisedimeve të autorë të bulizmit me të cilët mësuesit kanë folur rreth akteve buliste të kryera prej tyre

4.3 Hipoteza e studimit: Numrit të miqve që ka një nxënës në shkollë ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste.

Hipoteza u testua nëpërmjet analizës statistikore të të dhënave, përkatësisht nëpërmjet testimit të marrëdhënies midis dy variablave dhe njëkohësisht dhe nëpërmjet tabelave të kryqëzuara.

4.3.1 Testimi i hipotezës nëpërmjet koeficientit të Pearson -it

Testimi i marrëdhënieve midis variablit të pavarur: numri i miqve dhe variablit të varur: të rënit pre e akteve buliste u realizua nëpërmjet koeficientit r të Pearson –it (Piërsen - it).

HIPOTEZA 0: Numrit të miqve që ka një nxënës në shkollë nuk ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste.

HIPOTEZA ALTERNATIVE: Numrit të miqve që ka një nxënës në shkollë nuk ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste.

Siç shihet dhe nga tabela 19, ekziston një evidencë domethënëse për të hedhur poshtë hipotezën 0 dhe të dilet në përfundimin se ekziston një korrelacion negativ, edhe pse një korrelacion i dobët, midis numrit të miqve që mund të ketë një nxënës dhe mundësisë për të rënë pre e akteve buliste, gjë që dëshmohet nga koeficienti i korrelacionit të Pearson – it, përkatësisht -,254. Si rrjedhojë vërtetohet hipoteza alternative, që numri i miqve që mund të ketë një nxënës ndikon mbi mundësinë që ka ai nxënës për të rënë pre e akteve buliste. Duke u mbështetur në faktin që ky është një korrelacion negativ, dilet në përfundimin që sa më shumë miq të ketë një nxënës, aq më pak ekziston mundësia që ai të bie pre e akteve buliste apo dhe e anasjellta, d.m.th. sa më pak miq të ketë një nxënës, aq më shumë rritet mundësia që ai të bie pre e akteve buliste.

Correlations			
		Sa shokë të ngushtë keni në klasën tuaj?	Sa shpesh keni rënë pre e akteve buliste muajt e fundit?
Sa shokë të ngushtë keni në klasën tuaj?	Pearson Correlation	1,000	-,254**
	Sig. (2-tailed)	,	,000
	N	727	727
Sa shpesh keni rënë pre e akteve buliste muajt e fundit?	Pearson Correlation	-,254**	1,000
	Sig. (2-tailed)	,000	,
	N	727	727

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela 17: Shkalla e marrëdhënies statistikore midis numrit të miqve dhe mundësisë për të rënë pre e akteve buliste

4.3.2 Testimi i hipotezës nëpërmjet tabelave të kryqëzuara


Kjo hipotezë vërtetohet dhe nga analiza statistikore nëpërmjet tabelave të kryqëzuara të mëposhtme.

Miqtë e ngushtë që kanë nxënësit në shkollë duke marrë në konsideratë përfshirjen në aktet buliste dhe gjininë.

Siç ilustron në grafikun 15 konstatohet se në rend zbritës nxënësit kanë më së shumti numrin e mëposhtëm të miqve:

- 311 nxënës (42.8%) raportojnë se kanë 4 – 5 shokë të ngushtë;

- ✚ 280 nxënës (38.5%) raportojnë se kanë 2 – 3 shokë të ngushtë;
- ✚ 89 nxënës (2.2%) raportojnë se kanë 6 ose më shumë shokë të ngushtë;
- ✚ 46 nxënës (6.3%) raportojnë se kanë vetëm 1 shok të ngushtë në klasë;
- ✚ 1 nxënës (0.1 %) raporton se nuk ka asnjë shok.



Grafiku 15: Numri i shokëve të ngushtë që kanë nxënësit në shkollë, duke marrë në konsideratë gjininë

Ndër to 72 prej tyre kanë rënë pre e akteve buliste: 24 vajza dhe 48 djem.

655 prej tyre nuk kanë rënë pre e akteve buliste.

110 nxënës raportojnë se kanë kryer akte buliste: 38 vajza dhe 72 djem

617 nxënës raportojnë se nuk kanë kryer akte buliste.

➤ **Numri i miqve të ngushtë që kanë nxënësit, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste.**

Nga tabela 18 konstatohet që individët të cilët kanë pak shokë të ngushtë në klasë, kanë rënë më shpesh pre e akteve buliste.

- ✚ 2 - 3 shokë të ngushtë: 48 nxënës të cilët kanë rënë pre e akteve buliste raportojnë se kanë 2 - 3 shokë të ngushtë, ndër to 29 nxënës kanë rënë pre e akteve buliste 2 ose 3 herë në muaj, 13 nxënës rreth 1 herë në javë dhe 6 nxënës disa herë në javë;
- ✚ 4 -5 shokë të ngushtë: 13 nxënës të cilët kanë rënë pre e akteve buliste raportojnë se kanë 4 - 5 shokë të ngushtë, ndër to 12 nxënës kanë rënë pre e akteve buliste 2 ose 3 herë në muaj, 1 nxënës rreth 1 herë në javë;

- ✚ 1 shok të ngushtë: 10 nxënës të cilët kanë rënë pre e akteve buliste raportojnë se kanë 1 shok të ngushtë, ndër to 7 nxënës kanë rënë pre e akteve buliste 2 ose 3 herë në muaj, 1 nxënës rreth 1 herë në javë dhe 2 nxënës disa herë në javë;
- ✚ Asnjë shok të ngushtë: 1 nxënës i cili raporton se nuk ka asnjë shok të ngushtë ka rënë pre e akteve buliste 2 ose 3 herë në muaj;
- ✚ 6 ose më shumë shokë të ngushtë: Asnjë nga nxënësit të cilët kanë 6 ose më shumë shokë në klasë nuk ka rënë pre e akteve buliste.

Jeni gjalë apo vajzë?				Sa shpesh keni rënë pre e akteve buliste muajt e fundit?					Total
				Nuk kam rënë pre e akteve buliste muajt e fundit.	Ka ndodhur vetëm 1 ose 2 herë.	2 ose 3 herë në muaj.	Rreth 1 herë në javë.	Disa herë në javë.	
Vajzë	Sa shokët të ngushtë keni në klasën tuaj?	Unë kam 1 shok të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	19 6,0%		4 1,3%	1 ,3%	1 ,3%	25 7,9%
		Unë kam 2 - 3 shokë të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	103 32,4%	1 ,3%	10 3,1%	3 ,9%	2 ,6%	119 37,4%
		Unë kam 4 - 5 shokë të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	129 40,6%		3 ,9%			132 41,5%
		Unë kam 6 ose dhe më shumë shokë të ngushtë në shkollën	Numri i nxënësve Përqindja	42 13,2%					42 13,2%
		Total	Numri i nxënësve Përqindja	293 92,1%	1 ,3%	17 5,3%	4 1,3%	3 ,9%	318 100,0%
Djalë	Sa shokët të ngushtë keni në klasën tuaj?	Asnjë.	Numri i nxënësve Përqindja			1 ,2%			1 ,2%
		Unë kam 1 shok të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	15 3,7%	2 ,5%	3 ,7%		1 ,2%	21 5,1%
		Unë kam 2 - 3 shokë të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	125 30,6%	3 ,7%	19 4,6%	10 2,4%	4 1,0%	161 39,4%
		Unë kam 4 - 5 shokë të ngushtë në klasën time.	Numri i nxënësve Përqindja	166 40,6%	3 ,7%	9 2,2%	1 ,2%		179 43,8%
		Unë kam 6 ose dhe më shumë shokë të ngushtë në shkollën	Numri i nxënësve Përqindja	47 11,5%					47 11,5%
		Total	Numri i nxënësve Përqindja	353 86,3%	8 2,0%	32 7,8%	11 2,7%	5 1,2%	409 100,0%

Tabela 18: Numri i miqve të ngushtë që kanë nxënësit, të cilët kanë rënë pre e akteve buliste, duke marrë në konsideratë gjininë

4.3.3 Analiza cilësore e intervistave invididuale

Unë jam tip shumë i shoqërueshëm dhe kam shumë miq. *Miq të në klasë dhe në shkollë më ndihmojnë shumë.* Unë arrij t'i bind miqtë e mi në shkollë dhe në facebook (fejsbuk) që të mos i bëjnë like (lajk) fotove apo postimeve të mendjemadhes. Gjithashtu unë arrij t'i bind që ato të mos i afrohen asaj. Ajo nuk ka shumë miq dhe kështu që nxënësi me më shumë miq është më fitimtar.

Nxënëse e klasës së nëntë

Shumë nga miqtë e mi e kanë inat të pasurin e klasës. Përse duhet të jetë vetëm ai në qendër të vëmendjes? Në bashkohemi 4 – 5 nxënës dhe të gjithë së bashku e kërcënojmë të pasurin dhe i marrin të gjitha lekët që ka.

Nxënës i klasës së nëntë

Si unë, dhe shoqet e mia e kemi shumë inat “pabuksen” dhe “ufon” e klasës, ndaj dhe *gjithmonë e përkrahim njëra – tjetrën kur e ngacmojmë apo e tallim atë.* Edhe ato vajzat që i rrinë pranë asaj, nuk na kundërvihen ne. Ato thjesht e mbajnë pranë për interes dhe *nuk bëjnë asgjë kur ne e tallim atë.* Unë me shoqet e mia jemi një grup i fortë dhe kemi shumë shoqëri me nxënësit e tjerë, ndaj dhe askush nuk dëshiron të na dalë kundër.

Nxënëse e klasës së tetë

Unë kam pak shoqëri në shkollë, kur nxënësit e tjerë më shajnë apo tallin për shkak të peshës apo puçrave, *asnjë nga dy shoqet e mia nuk më mbron.* Përkundrazi ato qeshin me to dhe me talljet që ato më bëjnë mua.

Nxënëse e klasës së gjashtë

Sigurisht që kam shumë miq. Unë jam më i miri në klasë dhe të gjithë më binden. Kur nxënësit e tjerë janë të ngathët apo të papërgatitur, *sigurisht që unë i ngacmoj vazhdimisht ato dhe për këtë më mbështesin dhe shokët e tjerë.* Bosi gjithmonë mbështetet nga të tjerët, apo jo?

Nxënës i klasës së nëntë

Duke qenë se jam nxënëse që mësoj, kam dhe shokë në klasë. Të qenit nxënëse me rezultate të mira, të ndihmon të kesh dhe shoqëri në shkollë. *Por edhe pse kam shoqëri në klasë, ka dhe nxënës, veçanërisht ato që nuk mësojnë, që më ngacmojnë shumë. Nxënësit që më ngacmojnë janë nxënës problematikë në shkollë, dhe shpesh herë shoqet e mia, për t'i*

shmangur telashet me to, nuk më mbrojnë. Ato shpesh herë kanë dhe qejf kur bëjnë shaka me mua rreth mënyrës se si më ngacmojnë nxënësit problematik në shkollë.

Nxënëse e klasës së shtatë

Jam e re në këtë shkollë dhe në këtë qytet dhe nuk kam shumë miq as në lagje, dhe as në shkollë. Shoqet në lagje dhe nxënësit në shkollë tallen vazhdimisht me mua dhe askush nuk më qëndron pranë. Kjo më shkakton frikë sepse e di, që shoqet në lagje dhe nxënësit në shkollë do vazhdojnë të më tallin dhe asnjë nuk do më ndihmojë.

Nxënëse e klasës së tetë

Unë nuk kam shumë lekë dhe nuk kam mundësi të shoqërohem me shoqet e klasës. Ato dalin dhe blejnë gjëra të mira në dyqan. Unë rri e veçuar dhe kam vetëm 2 shoqe me të cilat rri më shumë. Dhe ato janë vajza, që nuk kanë lekë dhe nuk kanë shoqëri. Kur nxënësit e tjerë më ngacmojnë, unë nuk kundërshtoj. Shoqet nuk përzihen. Unë e pranoj kur më shajnë për shkak të syve, pasi e di, që nëse do të kundërshtoj, askush nuk do të jetë pranë meje që të më mbrojë.

Nxënëse e klasës së gjashtë

Nuk kam miq në klasë. Kam vetëm një shok të ngushtë. Jemi pak të izoluar nga pjesa e tjetër e klasës dhe rrimë gjithmonë bashkë, ndaj kur më ngacmojnë dhe më ndonjëherë dhe më gjuajnë, nuk na ndihmon njëri në klasë. Ne nuk jemi spiunë, që të ankohemi tek mësuesit. Për këtë arsye çunat e klasës na poshtërojnë pa asnjë lloj problemi.

Nxënës i klasës së shtatë

Kam shumë shokë dhe shoqe në klasë dhe në shkollë. Kur më ngacmojnë, në përgjithësi miqtë më ndihmojnë të gjithë. Por problemin më të madh e kam me mësuesit dhe kur më tallin ato nxënësit e tjerë nuk i kundërshtojnë ato dhe nuk më qëndrojnë shumë pranë, pasi kanë dhe hallin e notës

Nxënëse e klasës së nëntë

Miq? Unë në klasë nuk kam thuajse asnjë shoqe. Të gjitha më përbuzin për shkak të njollës së kuqe. Madje disa nxënës ndonjëherë dhe më tallin. Askush nuk më mbron mua. Disa djem më thonë madje dhe që erdhi “mostra” e klasës. Të tjerët qeshin me mua dhe askush nuk më rri pranë. Mësuesit më rrinë pranë, por nxënësit e tjerë jo. Nuk kam shoqe

apo shok të ngushtë, vetëm një vajzë me të cilën jam në bankë dhe që e kam në lagje, por as ajo nuk më ndihmon kur nxënësit e tjerë më ngacmojnë. *Nxënësit më tallin vazhdimisht, pasi e dinë që mua nuk ka kush të më ndihmojë.*

Nxënëse e klasës së shtatë

Unë kam shumë shoqe. Shokë nuk kam dhe aq. Kur më ngacmojnë çunat në klasë, vajzat më mbrojnë dhe i largojnë ato. Edhe pse çunat më ngacmojnë shpesh për faktin se i kreh flokët me model të vecantë apo sepse kam një zë të hollë sesa ato, vajzat më mbrojnë dhe deri diku ndjehem i mbrojtur prej tyre.

Nxënës i klasës së tetë

Kam ardhur këtë vit në këtë shkollë dhe nuk kam shumë shoqe. Ndryshuam shtëpi dhe unë isha e detyruar të ndryshoja dhe shkollë. Kam vetëm një shoqe, të cilën e kam dhe në pallat. Ajo nuk e ka problem faktin që unë jam kaq brune, pasi e njeh familjen time dhe e di që nuk jemi me ngjyrë. Ajo mundohet t'i bindë nxënësit në klasë që unë jam si ato, por vetëm ne të dyja nuk mund të ndryshojmë opinionin e tyre. Ajo më qëndron pranë kur nxënësit e tjerë më shajnë, por nuk i ndalon dot ato të më tallin apo të më shajnë.

Nxënëse e klasës së shtatë

Ne të dyja kemi shumë shoqe dhe shokë; madje dhe vetë jemi shoqe. Kur unë u tregoj nxënësve të tjerë çfarë thotë A për to, ato më duan dhe më shumë mua dhe largohen prej A. Unë nuk flas keq për nxënësit e tjerë dhe ato më mbështesin dhe përkrahin shumë më tepër sasa A. Ajo ka shoqëri në klasë, por nga disa nxënës e kam ndarë unë, pasi i kam treguar gjërat e këqija që A ka thënë për to. Kështu që unë kam më shumë miq, ajo ka më pak; unë u zgjodha senatore, ajo jo.

Nxënëse e klasës së shtatë

Shokë nuk kam shumë. Edhe me ato shokë që rri, nuk kam miqësi, pasi ato më afrohen më së shumti për faktin se jam e bukur dhe kanë synim të tjera më tej. Shoqe kam më pak. Vajzat më shikojnë si konkurente dhe përherë mundohen të më ngacmojnë dhe të tallen me mua. Nxënësit e tjeë i besojnë lehtësisht thashethemet që përhapin për mua, ndaj

dhe nuk mund të mbështetem tek to. Shpesh herë ndjehem e vetmuar, pai jam e bindur që askush nuk do të më ndihmojë, kur nxënësit të vazhdojnë të tallen me mua.

Nxënëse e klasës së nëntë

KAPITULLI V: GJETJET DHE KONKUZIONET

➤ Prevalenca e bulizmit

Siç pasqyrohet dhe në analizën statistikore, konstatohet se fenomeni i bulizmit është një fenomen relativisht i përhapur dhe në shkollat nëntëvjeçare të Bashkisë Elbasan.

Ndër 727 nxënës të anketuar 9.9% e tyre, (72 nxënës) pohojnë të kenë pësuar akte buliste, ndërkohë që 15.2 % e tyre (110 nxënës) pohojnë se kanë kryer vetë akte buliste.

Konstatohet se nxënësit djem janë më shpesh të përfshirë në akte buliste sesa vajzat, si në rolin e viktimës, ashtu dhe në rolin e autorit të akteve buliste. 16.6% e nxënësve të përfshirë në akte buliste janë djem (120 nxënës) dhe 8.5% janë vajza (62 nxënëse).

Gjithashtu konstatohet se nxënësit janë përfshirë më shpesh në bulizëm në klasat e gjashta dhe të shtata, kryesisht në rolin e viktimës. Në klasat e teta dhe të nënta shihet se fenomeni i bulizmit fillon të zbutet. Në klasën e gjashtë kanë pësuar akte buliste 4.6% e nxënësve të anketuar. Në klasën e shtatë 4.7%, në të klasën e tetë vërehet një zbritje; 1.4% e nxënësve të anketuar kanë pësuar akte buliste dhe në klasën e nëntë kanë pësuar akte buliste 1.6% e nxënësve të anketuar.

Në rolin e autorit të akteve buliste vihet re se nxënësit përfshihen më së shumti përsëri në klasat e gjashta dhe të shtata, por ndryshe nga eksperiencat viktimizuese, tek eksperiencat si autor i bulizmit vihet re se, përpos zbritjes në klasën e tetë, aktet buliste intensifikohen sërish në klasën e nëntë. Në klasën e gjashtë kanë kryer akte buliste 4.8% e nxënësve të anketuar; në klasën e shtatë 3.8%, në klasën e tetë 2.5% dhe në klasën e nëntë 4% të nxënësve të anketuar.

Ky konstatim është i vlefshëm si për nxënësit djem, ashtu dhe për ato vajza.

Aktet buliste janë kryer më së shumti në grup. Bazuar në pohimet e nxënësve të anketuar 10.1% e nxënësve kanë pësuar akte buliste nga një grup prej 2 – 3 nxënësish ose 4 – 9 nxënësish. Vetëm 1% e nxënësve viktimë të bulizmit i kanë pësuar aktet buliste kryesisht nga 1 nxënës. Kryesisht aktet buliste kryhen më së shumti nga një grup djemsh ose dhe nga një djalë. 4.5% e nxënësve viktimë të bulizmit kanë pësuar akte buliste nga disa djem dhe 3% nga një djalë. Vajzat kryejnë më rrallë akte buliste. 1.7% e nxënësve viktimë të bulizmit pohojnë se kanë pësuar bulizëm nga disa vajza. Vihet re gjithashtu se

më së shumti djemtë pësojnë më shumë akte buliste nga djemtë, ndërsa vajzat më së shumti prej vajzave dhe vajzave dhe djemve.

Aktet buliste pësohen kryesisht në të gjitha ambjentet e shkollës, por më së shumti ato pësohen në klasë; 55.6% e akteve buliste raportohen se janë pësuar pikërisht në klasë (32.1% kur mësuesja nuk është prezente dhe 23.5% kur mësuesja është prezente në klasë). 17.3% e nxënësve pohojnë se i kanë pësuar aktet buliste nëpër shkallë; 11.1% në ambjentet e palestrës; 8.6% gjatë rrugës për në shkollë dhe 7.4% në lulishte apo në fushën sportive.

Format e bulizmit janë të ndryshme dhe vihet re që nxënësit kryesisht nuk përdorin vetëm një formë të caktuar të bulizmit por disa prej tyre njëkohësisht. Ndër format e bulizmit më shpesh të përdorura nga nxënësit konstatohet se janë: bulizmi kibernetik (6.9% e nxënësve kanë pësuar bulizëm kibernetik dhe 10.7% e kanë kryer atë), fizik (5.6% e nxënësve kanë pësuar bulizëm fizik dhe 10.2% e kanë kryer atë), bulizmi nëpërmjet dëmtimit të pronës (5.1% e nxënësve kanë pësuar bulizëm nëpërmjet dëmtimit të pronës dhe 10.6% e kanë kryer atë), dhe bulizmi nëpërmjet kërcënimit (5.1% e nxënësve kanë pësuar bulizëm nëpërmjet dëmtimit të pronës dhe 10.5% e kanë kryer atë). Bulizmi nëpërmjet përhapjes së fjalëve negative dhe të pavërteta (5.1% e nxënësve kanë pësuar bulizëm nëpërmjet përhapjes së fjalëve negative dhe të pavërteta dhe 9.8% e kanë kryer atë) dhe atij verbal (5.7% e nxënësve kanë pësuar bulizëm verbal dhe 6% e kanë kryer atë) janë gjithashtu forma shpesh të përdorura nga nxënësit. Nxënësit përfshihen më rrallë në bulizëm seksual (4.8% e nxënësve kanë pësuar bulizëm seksual dhe 6.7% e kanë kryer atë) dhe rracor (0.7% e nxënësve kanë pësuar bulizëm rracor dhe 2.9% e kanë kryer atë). Duke marrë në konsideratë gjininë konstatohet se vajzat përfshihen më së shumti në bulizëm verbal, në bulizëm nëpërmjet përjashtimit dhe përhapjes së thashethemeve dhe seksual ndësa djemtë përfshihen më së shumti në bulizëm fizik, në bulizëm nëpërmjet kërcënimit dhe dëmtimit të pronës. Të dyja gjinitë përfshihen mjaft në bulizëm kibernetik.

➤ **Arsyet pse nxënësit përfshihen në bulizëm**

Nga analiza e intervistave individuale konstatohet se ekzistojnë disa arsye pse nxënësit përfshihen në bulizëm, si në rolin e autorit, ashtu dhe në atë të viktimës. Nxënësit kryejnë akte buliste kryesisht për shkak të sjelljeve agresive të mësuara në familje apo në rrethin shoqëror; për shkak të vëmendjes së munguar në shoqëri, vëmendje e cila synohet të

fitohet nëpërmjet kryerjes së akteve buliste. Shumë nxënës bien pre e akteve buliste për shkak të pamjes së tyre fizike, statusit social – ekonomik, sjelljeve prosociale, rezultateve në mësim, popullaritetit në rrethin e bashkënxënësve si dhe për shkak të origjinës.

➤ **Masat e ndërmarra për trajtimin dhe parandalimin e bulizmit**

